REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Shkodër, më 22.12.2023

Nr. 4193 prot.

**V E N D I M**

Nr. 299, datë 22. 12 .2023

**"Për miratimin e raportit të cilësisë së brendshme për vitin akademik 2022-2023"**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Neni 38, pika 1, germa j; Statutin e USH-së Neni 17, pika 6, germa h, Neni 24, pika, 2, Senati Akademik, pasi mori në shqyrtim Raportin e cilësisë së brendshme për vitin akademik 2022-2023, në mbledhjen e tij të datës 22.12.2023

**Vendosi:**

1. Të miratojë Raportin e cilësisë së brendshme për vitin akademik 2022-2023 (materiali bashkangjitur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**
**Prof. Dr. Rajmonda KËÇIRA**

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

# RAPORTI I VETËVLERËSIMIT
# 2022-2023

Dhjetor 14. 12. 2023

**Përmbajtje**


1. Hyrje f. 5
2. Qëllimi i raportit f. 5
3. Përmbledhje e rekomandimeve kryesore f. 6
4. Fushat e vlerësimit f. 9
4.1. Veprimtaria e ZSC f. 11
5. Stafi akademik dhe kërkimi shkencor f. 15
5.1. Kualifikimi i stafit f. 24
5.2. Struktura organizative e USH f. 25
6. Të dhënat e Njësive kryesore bazuar në RVB-të përkatëse f. 26
6.1. Fakulteti i Shkencave të Natyrës f. 26
6.2. Fakulteti i Shkencave të Edukimit f. 29
6.3. Fakulteti i Drejtësisë f. 32
6.4. Fakulteti Ekonomik f. 34
6.5. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja f. 36
6.6. Fakultcti i Shkencave Shoqërore f. 38
7. Përmbledhje e analizave sipas RVB-ve të fakulteteve f. 41
8. Përfundime mbi përmbushjen e standardave f. 88
9. Analizë sasiore dhe narrative e pyetësorit me pedagogë f. 90
10. Analizë e pyetësorit lidhur me *Programin e Studimit* f. 101
11. Fokus – Grupe me studentë f. 142
12. Analiza SWOT f. 143
13. Përmbledhje dhe Rekomandime f. 150
14. Lista e evidencave

| | |
|---|---|
| Tabelë 1. Mbulimi i programeve të studimit me PAE | f. 6 |
| Tabelë 2. Fushat e Vlerësimit | f. 8 |
| Tabela 2.1. Veprimtaria e ZSC | f. 12 |
| Tabelë 3. Skeda informuese e Universitetit "Luigj Gurakuqi" | f. 13 |
| Tabelë 4. Ciklet e studimit | f. 14 |
| Tabelë 5. Kualifikimi i stafit | f. 15 |
| Tabelë 5.1. Projektet të aplikuara për financim | f. 18 |
| Tabelë 6. Mobilitetet | f. 25 |
| Tabelë 7: Organigrama e USH-së | f. 26 |
| Tabelë 8. Skedë informuese e FSHN-së | f. 28 |
| Tabelë 9: Skedë informuese e programeve të FSHN-së | f. 29 |
| Tabelë 10. Skedë informuese e FSHE-së | f. 30 |
| Tabelë 11. Skedë informuese të programeve të studimit FSHE | f. 31 |
| Tabelë 12. Skedë informuese e FD | f. 32 |
| Tabelë 13. Skedë informuese për programet e studimit që ofron FD | f. 33 |
| Tabela 14. Skeda informuese për FE | f. 35 |
| Tabelë 15. Skeda informuese për programet e studimit që ofron FE | f. 36 |
| Tabelë 16. Skedë informuese për FGJH | f. 37 |
| Tabelë 17. Skedë informuese për programet e studimit që ofron FGJH-ja | f. 38 |
| Tabelë 18. Skedë informuese për FSHSH-në | f. 40 |
| Tabelë 19. Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHSH | f. 41 |
| Tabelë 20. Përshkrimi i pyetësorit | f. 90 |
| Tabela 21. Fokus - Grupe | f. 142 |
| Tabela 22. Tabela SWOT | f. 148 |
| Tabela 23. Përmbledhje e të dhënave SWOT | f. 150 |

Shkurtime

| | |
|---|---|
| **ASCAL** | Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të Lartë |
| **GVB** | Grupi i Vlerësimit të Brendshëm |
| **LAL** | Ligji i Arsimit të Lartë |
| **MAS** | Ministria e Arsimit dhe Sportit |
| **NJSBC** | Njësia e Sigurimit t[ Brendshëm të Cilësisë |
| **USH** | Universiteti i Shkodrës |
| **BUSH** | Biblioteka e Universitetit të Shkodrës |
| **AMS** | ASCAL Managment System |
| **FSHSH** | Fakulteti i Shkencave Shoqërore |
| **FSHN** | Fakulteti i Shkencave të Natyrës |
| **FE** | Fakulteti Ekonomik |
| **FD** | Sfakulteti i Drejtësisë |
| **FSHE** | Fakulteti i Shkencave të Edukimit |
| **FGJH** | Fakulteti i Gjuhëve të Huaja |
| **GVJ** | Grupet e Vlerësuesve të Jashtëm |
| **RVB** | Raport i Vlerësimit të Brendshëm |
| **PAE** | Personel Akademik Efektiv |

## 1. Hyrje

Gjatë vitit 2022 - 2023, ZSC ka synuar mbështjetjen e procesit të akreditimit për 10 programe studimi si dhe përfshirjen në sa më shumë hallka për sigurimin e cilësisë së institucionit, duke iu përmbajtur një procesi të vazhdueshëm monitorimi, vlerësimi, garantimi, ruajtjeje, zhvillimi dhe përmirësimi të cilësisë të veprimtarive të universitetit "Luigj Gurakuqi". USH harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, kodin e cilësisë dhe praktikat më të mira bashkëkohore.

**Synimi**

ZSC synon zhvillimin dhe ruajtjen e cilësisë në nivel institucioni dhe programi studimi që reflektohet në përmbushjen e standardave të sigurimit të cilësisë që zbatohen në USH, në përputhje me Kodin e Cilësisë.

*Zyra e Sigurimit të Cilësisë* mban komunikimin me ASCAL lidhur me akreditimin e programeve dhe institucionit, lidhet me njësitë bazë dhe kryesore për përmbushjen e rekomandimeve të dala nga raportet e VB dhe VJ, përditëson të dhëna mbi stafin dhe studentët.

## 2. Qëllimi i raportit

Qëllimi i këtij raporti është që të sigurojë një vlerësim korrekt, të bazuar në tregues realë dhe të matshëm të nivelit të arritjes së standardeve dhe garantimit të cilësisë së Institucionit dhe programeve të studimit. Përmes shqyrtimit të detajuar të RVB-ve të fakulteteve, dokumenteve institucionalë, Evidencëve, rekomandimeve të vlerësuesve të jashtëm, pyetësorëve të pedagogëve dhe studentëve, fokus grupeve me pedagogë, studentë, ALUMNI dhe administratë, me metodën e hulumtimit, kemi synuar të identifikojmë gjetjet kryesore.

Gjetjet kryesore të këtij raporti përfshijnë të gjitha standardet e vlerësimit, të cilat shërbejnë si bazë për veprimet e mundshme që mund të ndërmerren për të përmirësuar dhe adresuar për zgjidhje *çështjet e identifikuara* dhe *zhvillimin e fushave të caktuara*, duke siguruar kështu një bazë për diskutim dhe veprim efektiv në rritjen e cilësisë së institucionit.

## 3. Përmbledhje e rekomandimeve kryesore

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 17.09.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", i ndryshuar, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, "Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë", Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, "Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit", dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 "Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit", në mbledhjen e tij të datës 24.01.2020, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, me **Vendim Nr. 03, datë 24.01.2020 vendosi për Akreditimin Institucional të Universitetit "Luigj Gurakuqi", me kohëzgjatje për 4 (katër) vite deri më 23/01/2024** me 5 rekomandime për t'u përmbushur nga USH-ja.

**Rekomandimet janë:**

**1. Institucioni, të sigurojë një rrjedhje më të mirë të informacionit nga nivelet e sipërme të menaxhimit tek ato të ulëta, dhe anasjelltas.**

Në kuadër të këtij rekomandimi, USH-ja ka marrë masat e duhura për pajisjen me një e-mail zyrtar nga platforma Microsoft office 365 (@unishk.edu.al) të stafit administrativ, stafit akademik me kohë të plotë dhe atë me kohë të pjesshme si dhe ka krijuar grupet e: dekanet@unishk.edu.al,

shefat.departamente@unishk.edu.al, pedagoetebrendshem@unishk.edu.al etj. Institucioni ka siguruar kështu rrjedhje të informacionit nga lart-poshtë dhe anasjelltas në kohë reale.

**2. Institucioni, të mundësojë autonominë financiare në nivelin e njësive bazë.**

Mbështetur në Udhëzimin Nr. 27 dt. 29.12.2017, citohet: Struktura administrative në nivel njësie bazë të konsiderohen:

a. Administratori i njësisë bazë, (në rastet me mbi 21 personel akademik në nivel njësie baze me kohë të plotë),

ky rekomandim nuk përmbushet pasi njësitë bazë në IAL "Luigj Gurakuqi", nuk kanë mbi 21 personel akademik.

**3. Institucioni, të sigurojë mbulimin e ngarkesës mësimore në programet e studimit të ciklit të parë nga staf akademik efektiv në masën të paktën 70%.**

Bazuar në të dhënat e çdo program studimit kemi këtë masë mbulimi sipas fakulteteve 70%:

| **Fakulteti** | **Programi i studimit** | **Mbulimi** |
|---|---|---|
| **Fakulteti i Shkencave të Natyrës** | BA në Infermieri të Përgjithshme | 51.1% |
| | BA në Fizioterapi | 60.6% |
| | BA në Biologji - Kimi | 77.6% |
| | BA në Mami | 49.9% |
| | BA në Fizikë | 100% |
| | BA në Matematikë | 73% |
| | BA në Informatikë | 75% |
| **Fakulteti i Drejtësisë** | Programi i integruar "Master i shkencave në drejtësi". | 100% |
| | Programi "Master në të Drejtën Kushtetuese-Administrative", | 86% |
| | Programi "Master në të Drejtën Civile | 90% |
| **Fakulteti i Shkencave të Edukimit** | BA në Punë Sociale | 63.50% |
| | BA në Psikologji | 70.30% |
| | BA në Mësuesi për Arsimin Fillor | 90.80% |
| | BA në Mësuesi për Arsimin Parashkollor | 73.70% |

| | | |
|---|---|---|
| | BA në Pikturë dhe Grafikë | 72.00% |
| | BA në Pedagogji Muzikore | 80.00% |
| | BA në Edukim Fizik dhe Sporte | 83.85% |
| **Fakulteti i Gjuhëve të huaja** | BA Gjuhë Angleze | 79.8% |
| | BA Gjuhë Gjermane | 96.6% |
| | Ba Gjuhë Frënge | 70.8% |
| | Ba Gjuhë Italiane | 82.4% |
| **Fakulteti i Shkencave Shoqërore** | BA në Gjuhë shqipe dhe Letërsi | 100% |
| | BA në Gazetari dhe Komunikim | 98% |
| | BA në Histori | 100% |
| | BA në Gjeografi | 88% |
| | Programi studimi me karakter profesional "Udhërrëfyes Turistik dhe Menaxhuese i Itinerareve Turistike për Rajonin Verior. | 55% |
| **Fakulteti Ekonomik** | Bachelor në Financë - Kontabilitet | 72% |
| | Bachelor në Turizëm | 74.57% |
| | Bachelor në Administrim – Biznes | 79.38% |
| | | |

**Tabelë 1. Mbulimi i programeve të studimit me PAE.**

**4. Institucioni, të gjejë mënyra më efektive për shpërndarjen e buxhetit për kërkim Shkencor.**

Me Vendim të Senatit Akademik Nr. 301, datë 04.10.2021, është vendosur që të shpërndahet shuma e parashikuar në buxhet te zëri për: *Shpenzime për pjesëmarrjen në konferenca* (kërkim shkencor), në mënyrë të barabartë për çdo njësi kryesore për vitin akademik 2020-2021, **(Evidencë 4.3.1)**. Nga kjo datë 04.10.2021 e më pas pedagogët rimbursohen periodikisht për botimet në revista shkencore dhe pjesëmarrjet në konferenca të EU/OECD, në masën 100%.

Rekomandimi i ASCAL është përmbushur plotësisht.

**5. Institucioni, të riorganizojë ambientet ekzistuese të stafit akademik, në mënyrë që të rriten standardet teknike për hapësirat e punës dhe gjithashtu të sigurojë dritën natyrale.**

Edhe për këtë rekomandim, institucioni ka bërë riorganizimin e disa zyrave në ato fakultete ku ka pasur hapësira për të bërë lëvizje të tilla, si p.sh., për Departamentin e *Edukimi Fizik dhe Sportet* dhe për Departamentin e *Lëndëve Paraklinike*.

**4. Fushat e vlerësimit**: Fushat e vlerësimit ku është mbështetë raporti përfshijnë disa dimensione kyçe si:




**Tabelë 2. Fushat e Vlerësimit**

*Menaxhimi Institucional*: Vetëvlerësimi i aftësisë së drejtuesve dhe stafit për të menaxhuar me cilësi burimet dhe veprimtaritë e institucionit.

*Autonomia dhe Sigurimi i cilësisë*: Vetëvlerësimi i shkallës së autonomisë së fakulteteve dhe institucionit, në krijimin e politikave, programeve dhe vendimeve të tjera të rëndësishme.

*Partneritetet dhe lidhjet*: Vetëvlerësimi i marrëdhënieve me komunitetin lokal, institucionet apo palët e treta, si dhe roli i partnerëve në përmirësimin e cilësisë së arsimit.

*Cilësia e Programeve të Studimit*: Vetëvlerësimi i përputhshmërisë së programeve të studimit me standardet akademike dhe nevojat e tregut të punës.

*Metodat e Mësimdhënies dhe Vlerësimi*: Vetëvlerësimi i metodave mësimore, si dhe mënyrën e vlerësimit të studentëve.

*Produktiviteti Shkencor dhe Artistik*: Vlerësimi i publikimeve shkencore, aktiviteteve artistike,

përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie dhe hulumtimi shkencor.

*Rekrutimi dhe Mbështetja e Studentëve*: Vetëvlerësimi i procesit të rekrutimit dhe mënyrës se si institucioni ofron mbështetje për studentët, duke përfshirë ndihmën financiare dhe këshillimin akademik.

Rezultatet e vetëvlerësimit të brendshëm janë tregues të përmirësimit të përgjithshëm të cilësisë së institucionit dhe të përgatitjes së studentëve për sfidat e tregut të punës dhe shoqërisë në tërësi. Rezultatet e çdo fushe mund të përdoren si të dhëna për matjen e cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve ndaj komunitetit. (**Evidencë 8.1**. Aktivitete të pasqyruara në faqen zyrtare).

*Dokumentacioni ku jemi mbështetur*

Ligj nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe *Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë* në Republikën e Shqipërisë, *Manuali i Cilësisë së Universitetit* (2021), *Kodi i Cilësisë* (2021), *Standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve, Udhëzimet e MAS. Strategjitë sektoriale në USH*, (**Evidencë 1.8**).

Dokumente të veprimtarisë institucionale të Universitetit "Luigj Gurakuqi", më konkretisht: *Statuti i USH*-së, *Rregullore e administratës së USH*-së, *Rregulloret e fakulteteve*, *Rregullore e studimeve*, *Rregulloret e Programeve të studimit*, *Rregullore e transferimeve*, *Planet mësimore*, *Formularët e ngarkesës vjetore të stafit*.

Universiteti ndjek me rigorozitet parimet e miratuara nga ASCAL ( **Evidencë 1**. Kodi i Cilësisë, Vendim Nr. 824, datë 24.12.2021 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë).

- Vlerësimi i Cilësisë duhet të karakterizohet nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit;
- Zhvillimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC) në Njësitë e IAL;
- Të realizojë *Vlerësimin e Brendshëm* me synimin që të krijohet një paraqitje e qartë dhe transparente e Njësisë nën vlerësim, për të ndërtuar politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj dhe të shërbejë si bazë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të institucionit e programeve;
- Të bëjë publik informacionin me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për gjendjen e njësisë, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj.;

Të shërbejë në fund të fundit për kultivimin e Kulturës së Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë si pjesë e tyre e brendshme dhe e qëndrueshme;

Vlerësimi të bëhet i mbështetur në dokumente, procedura, anketime, takime me palët e interesuara etj.

## 4.1. Mbi veprimtarinë e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Në mbështetje të detyrave të *Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë*, janë realizuar veprimtari dhe aktivitete të cilat përmbushin qëllimet për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve arsimore dhe administrative.

Të dhënat e tabelës identifikojnë rezultatet e arritura në përdorimin e standardeve të cilësisë për të:

- Monitoruar cilësinë e shërbimeve dhe për të adresuar probleme përmes RVB-ve; RVJ-ve, pyetësorëve dhe fokus-grupeve;
- Zhvillimi dhe vënia në jetë e strategjive që përmirësojnë cilësinë e proceseve të ndryshme brenda universitetit.
- Konsultime me grupe interesi dhe trajnime për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe proceseve të tyre.
- Komunikime me stafin akademik, studentë, *ALUMN* dhe administratë për të siguruar informacionin e nevojshëm mbi çështjet e cilësisë dhe krijimin e mundësive për të marrë përshtypje dhe sugjerime për përmirësime.

Tabela 2. 1. Mbi veprimtarinë e ZSC

| Nr. | Aktiviteti / Veprimtaria | Grupi Vlerësimit të Brendshëm / Përbërja | Periudha Kohore | Rezultati / Produkti |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Mbështetje e 10 programeve në akreditim dhe menaxhimi i dokumentacionit me ASCAL për to. | Prof. As. Dr. Angjelina Shllaku, Dr. Ermira Ymeraj, Ma. Olta Smajli | Janar 2023- Dhjetor 2023 | Raportet e Vlerësimit të Jashtëm për 6 programe. |
| 2 | Menaxhimi i pyetësorëve për Lëndën, Modulin dhe Pedagogun për të gjithë studentët e USH. | Prof. As. Dr. Angjelina Shllaku, Dr. Ermira Ymeraj, Ma. Olta Smajli | Shkurt 2023- Shtator 2023 | Analizë e përgjigjeve të studentëve e ndarë sipas fakulteteve. |
| 3 | Menaxhimi i pyetësorëve për Programin e Studimi,t për të gjithë studentët që u diplomuan në USH në tre sezone 2023. CleanScore. | Prof. As. Dr. Angjelina Shllaku, Dr. Ermira Ymeraj, Ma. Olta Smajli | Prill 2023- Nëntor 2023 | Analizë e përgjigjeve të studentëve e ndarë sipas fakulteteve. |
| 4 | Fokus - grupe me studentët e programeve që kaluan në procesin e akreditimit. | Prof. As. Dr. Angjelina Shllaku, Dr. Ermira Ymeraj, Ma. Olta Smajli | Maj 2023 | Proces- verbale të fokus-grupeve me studentë. |
| 5 | Pyetësori për pedagogun. Formular vlerësimi nga personeli akademik. | Prof. As. Dr. Angjelina Shllaku, Dr. Ermira Ymeraj, Ma. Olta Smajli | Korrik 2023- Tetor 2023 | Analizë e përgjigjeve të pedagogëve. |
| 6 | Fokus - grupe me studentët, stafin akademik, stafin administrativ dhe ALUMN-in, për secilin fakultet që nuk kanë kaluar procesin e akreditimit në dy programe. | Prof. As. Dr. Angjelina Shllaku, Dr. Ermira Ymeraj, Ma. Olta Smajli | Nëntor 2023- Dhjetor 2023 | Proces- verbale të fokus-grupeve. |
| 7 | Bashkëpunim me Komisionin e Sigurimit të Cilësisë për hartimin e Manualit të Performancës së Pedagogut. | KSGC | Shkurt 2023- Qershor 2023 | Manuali i Performancës së Pedagogut. |
| 8 | Konsultim me ekspertët e sistemit të Bolonjës në kuadër të projektit "Bolognia Hub Peer Support II". | NJSBC | 7.09.2023- 09.09.2023 | Vënia në zbatim e disa prej sugjerimeve të trajnerëve. |
| 9 | Konsulta të veçanta mbi mënyrën e përditësimit të syllabuseve me disa departamente. | Prof. As. Dr. Angjelina Shllaku, Dr. Ermira Ymeraj, Olta Smajli | Dhjetor 2023 | Evidentimi i problemeve |
| 10 | Aplikimi për Akreditim Institucional dhe mbështetja e GVB-së. | Dr. Ermira Ymeraj, Olta Smajli | 6 Tetor 2023 | Plan veprimi për hapat që do ndërmerren për akreditimin institucional. |

**Skedë informuese e Universitetit "Luigj Gurakuqi"**

| EMRI I INSTITUCIONIT | UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" |
|---|---|
| Adresa: | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Rektorati *Sheshi 2 Prilli*, Shkodër, Albania.<br>P.O.BOX 4001 |
| Kontakt: | Email-info@unishk.edu.al<br>Telefon: +355 (22) 800 651<br>Website: www.unishk.edu.al |
| Rektor | Prof. dr. Rajmonda Këçira<br>e-mail: rajmonda.kecira @unishk.edu.al |
| Licencuar: | VKM Nr. 150, datë 18.04.1957 si *Institut i Lartë Pedagogjik* |
| Statusi ligjor aktual: | VKM Nr.124, datë 28.05.1991 si Universitet "Luigj Gurakuqi" |
| Akredituar: | Vendim i ASCAL, Nr.70, datë 21.09.2017<br>Vendim i ASCAL Nr. 03, datë 24.01.2020 |
| Fakultetet | Fakulteti i Shkencave të Natyrës<br>Fakulteti i Shkencave të Edukimit<br>Fakulteti i Drejtësisë<br>Fakulteti i Shkencave Shoqërore<br>Fakulteti i Gjuhëve të Huaja<br>Fakulteti Ekonomik |
| Ciklet e studimit | Bachelor<br>Master → Profesional,<br>→ i Shkencave<br>Doktoraturë |

**Tabelë 3: Skeda informuese e Universitetit "Luigj Gurakuqi"**

Universiteti i Shkodrës është i organizuar në 6 fakultete dhe 22 departamente dhe ofron 3 cikle studimi. USH-ja është ndër universitetet më të mëdha në vend, në të cilin studiojnë studentë nga rrethe të ndryshme të vendit, kryesisht nga Veriu i Shqipërisë, por edhe nga trevat shqiptare, si nga Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia. (**Evidencë 5.3.1**).

Studimet në USH janë të organizuara në cikle, në përmbushje të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Deklaratës së Bolonjës. Ai ofron 30 programe të ciklit të parë (me 180 ECTS), 3 programe

profesionale (2 me 120 ECTS dhe 1 me 60 ECTS); 22 programe të ciklit të dytë Master Profesional (18 me 120 ECTS dhe 4 me 60 ECTS), 14 programe Master i Shkencave (me 120 ECTS); 1 program studimi të integruar (me 300 ECTS), 1 program studimi formim i vazhduar në fushën e Psikopegadogjisë (35 ECTS) dhe 2 programe të ciklit të tretë Doktoraturë.




**Tabelë 4: Ciklet e studimit**

## 5. Stafi akademik dhe kërkimi shkencor

Universiteti ka 199 pedagogë me kohë të plotë. 75.2% e stafit akademik është i kualifikuar me tituj akademikë dhe grada Shkencore *Prof. Dr; Prof.As.Dr; Dr* dhe *Docent*, 24.6% prej tyre janë me Master Shkencor.




**Tabelë 5: Kualifikimi i stafit**




16 Doktor i Shkencave
7 Prof. As. Dr
Fakulteti Ekonomik 30 pedagogë
3 Prof. Dr
4 Master Shkencor


7 Doktor i Shkencave
Fakulteti i Drejtësisë 18 Pedagogë
6 Prof. As. Dr
5 Master Shkencor


10 Doktor i Shkencave
6 Prof. As. Dr
Fakulteti i gjuhëve të huaja
24 pedagogë
1 Prof. Dr
7 Master Shkencor


22 Doktor i Shkencave
9 Prof. As. Dr
Fakulteti i Shkencave Shoqërore 41 pedagogë
7 Prof. Dr
1 Master Shkencor
2 Docent




Personeli akademik promovon vazhdimisht kërkimin e tij shkencor në aktivitete shkencore rajonale, kombëtare, mbarëkombëtare dhe ndërkombëtare (**Evidencë 5.8.5**, Konferencë e programit të Gjuhës Frënge me AUF). Ai ka formuar tashmë një bibliografi të pasur botimesh në revista të rëndësishme shkencore. (**Evidencë 5.7.3** )

| **Projekte të aplikuara për financim** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Emër Mbiemër (Koordinator)** | **Fakulteti** | **Titulli i Projektit** | **Intitucioni Financues/Bashkëpunues** |
| **1** | Dr. Visar Dizdari | Fakulteti i Shkencave të Edukimit | "Forcimi i kapaciteteve të studentëve të shkencave sociale dhe profesionistëve të shërbimeve sociale". | Projekt i zbatuar nga FSHS - UT, në partneritet me FSHE - USH dhe FSHE - UEL, dhe programin "Leave No One Behind", UNDP Albania. Numri i projektit 00126393. |
| **2** | Prof. as. dr. Florian Mandija | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | Vlerësimi i ndikimeve të ndërsjellta ndërmjet ndryshimeve klimaterike dhe ndotjes së ajrit, mbi territorin e Shqipërisë-MJEDISI | Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inivacionit. Thirrja PKKZH |
| **3** | Dr. Aurora Dibra | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | Për një menaxhim dhe digjitalizim mbi baza shkencore të biodiversitetit në Qarkun e Shkodrës. | Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inivacioni. Thirrja PKKZH |
| **4** | Dr. Julia Preka | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | Laboratori i Analizave të Ushqimeve | Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inivacioni. Thirrja PIKSH |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5 | Dr. Lulzime Dhora | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | Laboratori Klinik-Biokimik | Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inivacioni. Thirrja PIKSH |
| 6 | Dr. Lulzime Dhora | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | Përcaktimi i parametrave fiziologjikë të disa peshqve të tregut në Liqenin e Shkodrës | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 7 | Dr.Nevila Bushati | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | Përcaktimi i parametrave fiziko-kimikë, biologjikë dhe mikrobiologjikë i ujërave të Lumit Buna | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" |
| 8 | Prof.as.dr. Marash Rakaj | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri | Rrjeti NATURA 2000 & GreenAl: |
| 9 | Prof.as.dr. Marash Rakaj | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | Projekt i AARHUS | Prespa Ohrid Nature Trust (PONT), Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" |
| 10 | Departamenti i Biologji-Kimisë | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | Innovative Models for Freshëater Management in the Adriatic and Ionian Region | Programi Interreg IPA ADRION i Bashkimit Europian |
| 11 | Departamenti i Biologji-Kimisë | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | Strengthening Cooperation to support the development of trans-boundary marine protected areas in the Adriatic-Ionian Region | Programi Interreg IPA ADRION i Bashkimit Europian |
| 12 | Departamenti i Biologji-Kimisë | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | Strengthen the conservation measures of the ëetLAnd KEy priority habitatS | Programi Interreg IPA South Adriatic i Bashkimit Europian |
| 13 | Departamenti i Biologji-Kimisë | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | Education for Energy Efficiency (EFEE) | Programi Interreg IPA South Adriatic i Bashkimit Europian |
| 14 | Departamenti i Biologji-Kimisë | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | South Adriatic Metaland | Programi Interreg IPA South Adriatic i Bashkimit Europian |
| 15 | Dr. Edra Fresku | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | Laboratori i Elektromagnetizmit | Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inivacioni. Thirrja PIKSH |
| 16 | Dr. Vilma Piroli | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | Evidentimi i folezimit, kapjes në mjetet e peshkimit dhe gjetjeve në breg të breshkës kokëmadhe (Caretta caretta) përgjatë vijës bregdetare midis grykëderdhjeve të lumenjve Drin dhe Buna (FOLEZIMI) | Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inivacioni. Thirrja PKKZH |
| 17 | Departamenti i Informatikës | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | Connecting borders by boosting skilled ëorkforce and removing disparities | Programi Ndërkufitar IPA Shqipëri-Mali I Zi i Bashkimit Europian |
| 18 | Dr.Julian Kraja | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | Strengthening Healthcare Research Capacity of the Academic Staff, Doctoral and Master Students, and Nurse. 2023 | Albanian American Development Foundation (AADF) & IIE &Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" |
| 19 | Prof. dr. Artan HAXHI | Fakulteti i Shkencave Shoqërore | Leksiku historik i shqipes | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 20 | Prof. dr. Artan HAXHI | Fakulteti i Shkencave Shoqërore | Gramatika e shqipes në shek. XIX | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" |
| 21 | Dr. Ermira ALIJA | Fakulteti i Shkencave Shoqërore | Kontribut me vlerë në fushë të albanologjisë "Kolë Thaçi" | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" |
| 22 | Dr. Anisa Kosteri | Fakulteti i Shkencave Shoqërore | Tekst universitar: Kulturë gjuhe dhe Shkrim akademik, 2023-2024. | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 23 | Prof.as.dr. Rrezarta Draçini | Fakulteti i Shkencave Shoqërore | Dypopuj një kulturë. Arritje dhe propozime. | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" |
| 24 | Prof. dr. Nertila Ljarja | Fakulteti i Shkencave Shoqërore | Edukimi është çelësi i zhvillimit | Ministraia e Arsimit dhe Sportit. Thirrja për ndërkombëtarizimin |
| 25 | Prof. Dr. Blerta Dragusha | Fakulteti Ekonomik | Hapja e masterit shkencor ne menaxhim shendetesor", ne kuader te projektit READ, financuar nga AADF | AADF & IIE & Universiteti i Shkodres "Luigj Gurakuqi' |
| 26 | Dr Kleida Heta | Fakulteti Ekonomik | "REUNITED – Real Estate and University Toëard Expert Diaspora" | AADF & IIE & Universiteti i Shkodres "Luigj Gurakuqi' |
| 27 | Elvisa Drishti, PhD | Fakulteti Ekonomik | Fairëork Albania "Kushtet e punës së punëtorëve të platformës në Shqipëri" | GIZ - Gjermani/Oxford Internet Institute/Universiteti i Oksfordit |
| 28 | Elvisa Drishti, PhD | Fakulteti Ekonomik | Open Ëestern Balkan Collaboratory on Online Platform ëork: Serbia, Albania, and Bosnia & Herzegovina' | Institute of Public Policy - Serbi; Qendra e Studimeve "Zora" - Bosnjë-Herzegovinë |
| 29 | Alba Berberi | Fakulteti Ekonomik | SCiDEV "Debati rinor për modelin e zhvillimit social dhe ekonomik të Shqipërisë" | Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inivacioni. Thirrja PKKZH |
| 30 | Dr. Alkida Hasaj | Fakulteti Ekonomik | Projekti 'The ËOË Albania 2023 – Ëindoë On the Ëorld project: Internationalization and tourism product development & marketing of Shkodra region' | Universitetet HOËEST dhe HOGENT ne Gent, Belgjike |
| 31 | Prof. As. Dr. Suzana Golemi | Fakulteti i Gjuhëve të Huaja | ELISA: Inclusive Sustainable Literary Intineraris the South Adriatic) | UE/Free Mediterranean, University "Giuseppe, Degennaro"/Regione Puglia Dipartimento Turismo, Economia Della Cultura, Valorizzazione Del Territorio, University of Montenegro, University of Tirana |
| 32 | Departamenti Romanistikës | Fakulteti i Gjuhëve të Huaja | Bibliotekë Digjitale e dëshmive të udhëtarëve të huaj përmes lundrimit | Universiteti i Shkodres "Luigj Gurakuqi' |
| 33 | Dalila Karakaçi | Fakulteti i Gjuhëve të Huaja | Communicative and Brain-Based Learning through Literature: Pre-service Teacher Training | AADF & IIE & Universiteti i Shkodres "Luigj Gurakuqi' |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 34 | Prof. As. Dr. Angjelina Shllaku | Fakulteti i Gjuhëve të Huaja | " Veshtrim ne trashegimine shqiptare permes gjurmimeve dhe perkthimeve studentore". | |
| 35 | Departamenti i Gjuhës Angleze | Fakulteti i Gjuhëve të Huaja | "Eksplorim Gjuhësor në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut mbi 'Përdorimin e gjuhës angleze në kontekstin Shqiptar' - Mbledhje dhe dokumentim i anglicizmave, fjalëve të urta, shprehjeve, përkthimeve në gjuhën angleze në pikat kryesore kulturore/turistike të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut" | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 36 | Dr. Zamira Shkreli | Fakulteti i Shkencave Shoqërore | "Dom Ndoc Nikaj, rilindasi i fundit" | |
| 37 | Prof. as. dr. Senada Reci | Fakulteti i Drejtësisë | Politizimi dhe inkriminimi i organizatave mediatike si shkaktar i dezinformimit në cështjet e shtetit dhe së drejtës | Institutin Shqiptar i Medias |
| | | | | Financuar nga Ambasada e SHBA në Tiranë |
| 38 | Departamenti i së Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane | Fakulteti i Drejtësisë | Shkolla e I-rë e Verës, Rinia dhe e ardhmja europian | |
| | | | | |
| 39 | Departamenti i së Drejtës Publike dhe Penale | Fakulteti i Drejtësisë | "Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit për ndihmën juridike falas, përmes angazhimit të stafit dhe studentëve të Fakultetit të Drejtësisë" | |
| 40 | Prof. as. dr. Senada Reci | Fakulteti i Drejtësisë | Telders Moot Court Competition in International Laë 2023 | |
| 41 | Dr. Albana Hadri | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" | Edukim për Median dhe Informacionin për Mësuesit e ardhshëm | Ambasada Amerikane dhe Instituti Shqiptar i Medias |
| 42 | Dr. Aurora Dibra | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" | Improving REsearch capacities of Albanian higher education institutions in conservation and restoration of Cultural Heritage 610390-EPP-1-2019-1-AL-EPPKA2-CBHE-SP – REACH | Programi Erasmus+ i Bashkimit Europian |
| 43 | Dr. Fatjon Nurja | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" | Entrepreneurial skills for a Modern Education in Albania, EntrAL; 617886-EPP-1-2020-1-FI-EPPKA2-CBHE-SP | Programi Erasmus+ i Bashkimit Europian |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **44** | Dr. Rina Muka | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" | "Inclusive tertiary Education in Western Balkans – IDEA" Capacity – Development in pursuit of Equity and Accessibility of HEIs in the Western Balkans for Students ëith Disabilities and/or Learning Difficulties"; 618859- EPP-1-2020-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP. | Programi Erasmus+ i Bashkimit Europian |
| **45** | Dr. Julian Kraja | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" | Strengthening capacities and digital competences in biomedical education through internationalization at home – BIOSINT - Project number: 101082863 | Programi Erasmus+ i Bashkimit Europian |
| **46** | Dr. Eranda Halluni | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" | MOOC-based micro-credentials for teacher professional development CRED4TEACH - Project number 101082858 | Programi Erasmus+ i Bashkimit Europian |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 47 | Dr. Nora Deda | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" | SHAPE "Sport, Health and People: A Western Balkan University Network" | Programi Erasmus+ i Bashkimit Europian |
| 48 | Dr. Aurora Dibra | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" | E-le.G.A.N.T.S. "E-Learning Gamified and Networked Training for Startupper" | Programi Erasmus+ i Bashkimit Europian |
| 49 | Dr. Ylvije Kraja | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" | SMART "Innovation Centres for the Development of Innovative and Entrepreneurial Thinking to Facilitate the Development of Sustainable Smart Solutions in the Western Balkan"; Project: 101082938 — SMART — ERASMUS-EDU-2022-CBHE | Programi Erasmus+ i Bashkimit Europian |
| 50 | Dr. Brikenë Dionizi | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" | "U-SIA University to Society Innomediaries in Albania: | Programi Erasmus+ i Bashkimit Europian |
| 51 | Dr. Brikenë Dionizi | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" | WU2-SIA, University to Society Collaborations for Inclusive Digital Transformation in the Western Balkans, Erasmus+ CBHE project, https://u2sid.al/home | Programi Erasmus+ i Bashkimit Europian |
| 52 | Dr. Mario Curcija | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" | Sustainable University - Enterprise Cooperation for Improving Graduate Employability (SUCCESS). 618975-EPP-1-2020-1-BA-EPPKA2-CBHE-JP; 01-230-1/2020 | Programi Erasmus+ i Bashkimit Europian |
| 53 | Prof. dr.Arjeta Troshani | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" | "Reforming doctoral studies in Montenegro and Albania – good practice paradigm" MARDS, 598465-EPP-1-2018-1-ME-EPPKA2-CBHE-SP (2018 – 2479/ 001-001) | Programi Erasmus+ i Bashkimit Europian |

**Tabelë 5.1. Projekte të aplikuara për financim**

Universiteti i Shkodrës prej vitesh është shquar jo vetëm si një qendër e rëndësishme e mësimdhënies, por edhe e kërkimit shkencor (**Evidencë 4.6.1**). Në vitin 2010, të gjitha seritë e Buletinit Shkencor u pajisën me ISSN. Si periodik i përhershëm, botohen 4 seri brenda vitit. Për vitin akademik 2022-2023 janë botuar: ( **Evidencë 4.10.1**).

Seria e shkencave shoqërore nr. 72, 2022, është gati po kjo seri për 2023;

Seria e shkencave të natyrës, nr. 72, 2022;

Seria e shkencave të edukimit, nr. 72, 2022;

Seria e shkencave ekonomike, nr. 16, 2022.

## 5.1. Kualifikimi i stafit

USH është partner në disa projekte kombëtare dhe ndërkombëtare (**Evidencë 5.8.3**). Fokusi kryesor ka qenë jo vetëm shkëmbimi i përvojave akademike nëpërmjet mobilitetit të stafit dhe studentëve, por edhe përmirësimi i cilësisë së programeve të studimit, i formave të mësimdhënies dhe të nxënit si dhe infrastrukturës në dispozicion të tyre. (**Evidencë 5.7.5**).

**Mobilitetet e stafit akademik dhe studentëve**.

Mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve është një aspekt i rëndësishëm në fushën e arsimit dhe shkencës. Kjo përfshin lëvizjen e individëve nga një institucion arsimor në një tjetër, nga një vend në tjetrin, ose përfshin pjesëmarrjen në programe shkëmbimi ndërkombëtar. Pasqyrimi i këtij mobiliteti mund të ketë ndikime të ndryshme në individë, institucione dhe shoqërinë në përgjithësi.

**Mobiliteti i stafit akademik krijon prioritet:**

*Në cilësinë* e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të stafit;

*Në forcimin* e lidhjeve ndërkombëtare; (**Evidencë 4.14.2**).

*Në përgatitjen* e stafit për kërkesat ndërkombëtare dhe mundësi për bashkëpunime afatgjata.

**Mobiliteti i studentëve krijon mundësi që studentët të**:

*Zhvillojnë* aftësi ndërkulturore dhe të mësojnë të jetojnë e punojnë në mjedise të ndryshme kulturore;

*Përparojnë* në fushën akademike dhe profesionale duke përmirësuar dhe forcuar dijen mbi gjuhët e huaja, duke rritur komunikimin dhe krijuar lidhje të dobishme për karrierën e tyre në të ardhmen.




**Tabelë 6: Mobilitetet**

USH është vazhdimisht në kërkim të mjeteve dhe mënyrave për të promovuar kontekstin e duhur të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor për edukimin e qytetarëve të ardhshëm dhe profesionistëve të kualifikuar që do të mundësojnë integrimin e vendit tonë në një kontekst më të gjerë vlerash evropiane. (**Evidencë 4.11.2**).

### 5.2. Struktura organizative e USH.

Struktura organizative e USH- së është e publikuar edhe në faqen web të Universitetit (Ref.link https://unishk.edu.al/). (Evidencë 5.1.5). Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" përbëhet nga 6 fakultete dhe 22 departamente.



Tabelë 7: Organigrama e USH-së.

## 6. Të dhënat e Njësive kryesore bazuar në RVB-të përkatëse

### *6.1. Fakulteti i Shkencave të Natyrës*

**Misioni:** Misioni dhe objektivat e FSHN vijnë në të njëjtën linjë me misionin dhe objektivat e Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi". *Fakulteti i Shkencave të Natyrës* ka si mision formimin e studentëve me njohuritë më bashkëkohore për një përgatitje cilësore dhe konkurruese si mësues në Biologji-Kimi, Fizikë, Matematikë, Informatikë, gjithashtu specialistë në fushën e informatikës (IT, programues, web), specialistë në fushat mjekësore teknike si: Infermieri, Mami dhe Fizioterapi, si dhe ekspertë të shkencave të ushqimit. Gjithashtu dhe teknikë në dy fusha, teknik elektrik dhe teknik sistemesh dhe rrjetesh kompjuterike.

**Politika e Cilësisë:** Të mbajë dhe të zhvillojë më tej rolet dhe funksionin e fakultetit si sigurues i cilësisë në arsimimin e të gjitha shtresave në funksion të prioriteteve të zhvillimit të vendit.

**Fakulteti ofron:**

Kurrikula të pasura dhe të larmishme programesh mësimore në të dy nivelet, (Programe profesionale 2 vjeçare, Cikli I dhe Cikli II), në zbatim të *Deklaratës së Bolonjës*, legjislacionit për Arsimin e Lartë dhe udhëzimeve të MAS, në përputhje me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësinë për të fituar njohuritë e fundit akademike dhe aftësitë e nevojshme praktike.

Staf akademik të kualifikuar me tituj e grada shkencore, profesionalizëm dhe përkushtim i tij për t'u përballuar me sfidat për përmbushjen e qëllimeve që ka FSHN.

Nivel të lartë të punës kërkimore - shkencore të pedagogëve dhe të aktivitetit të tyre botues. Monitorim i përvitshëm i cilësisë së mësimdhënies. Numër të lartë aktivitetesh të realizuara nga pedagogët me studentë (orët e hapura, të ftuar specialistë të fushës, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, workshopeve). Marrëdhënie të ngushtë bashkëpunimi me institucionet e qeverisjes lokale dhe shërbimet e ofruara nga OJF – të, ku zhvillohen praktikat profesionale të studentëve. Bashkëpunim të vazhdueshëm të *Fakultetit të Shkencave të Natyrës* me komunitetin akademik, e më gjerë.

*Skeda informuese për FSHN-në*

| **EMRI I FAKULTETIT** | **Fakulteti i Shkencave të Natyrës** |
|---|---|
| Adresa: | Rruga Jeronim de Rada 12, Shkodër |
| Kontakt: | website: www.unishk.edu.al/Fakultetet |
| Licencuar: | 2 Shtator 1957 si ILP<br>Në vitin 1991, themelohet si fakultet më vete |
| Dekani | Prof. as. Dr. Rrok Smajlaj<br>Email- rrok.smajlaj@unishk.edu.al |
| 6 Departamente | Departamenti i Biologji-Kimisë<br>Departamenti i Matematikës<br>Departamenti i Fizikës<br>Departamenti i Lëndëve Paraklinike<br>Departamenti i Lëndëve Klinike |
| Qendra SURSH | Qendra e Studimit të Ujërave |
| Ciklet e studimit | 9 programe studimi Bachelor<br>2 programe studimi profesional (2 vjeçar)<br>6 programe studimi Master Profesional<br>1 program studimi Master i Shkencave |

**Tabelë 8. Skedë informuese e FSHN-së**

*Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHN-ja*

| Departamenti | Programi i studimit | Dokument Licencimi |
|---|---|---|
| **1. Departamenti i Lëndëve Paraklinike dhe Departamenti i Lëndëve Klinike** | Bachelor në "Infermieri e përgjithshme" (180 ECTS) | Shkresë MASH Nr. 784/1 prot., datë 05.06.2001 |
| | Bachelor në "Infermieri - Mami" (180 ECTS) | Shkresë MASH Nr. 3955 prot., datë 01.06.2007 |
| | Bachelor në "Fizioterapi" (180 ECTS) | Shkresë MASH Nr. 3954 prot., datë 01.06.2007 |
| | Master profesional në "Psikologji Shëndeti' (90 ECTS) | UMASH Nr. 503, datë 18.10.2012 |
| **2. Departamenti i Biologji – Kimisë** | Bachelor në "Biologji-Kimi" (180 ECTS) | VKM Nr.150, prot., datë 18.04.1957 |
| | Bachelor në "Biologji-Kimi" në gjuhën angleze (180 ECTS) | VKM nr. 459, datë 27.07.2022 Nr. prot., 4088/2, datë 29.07.2022 |
| | Master Profesional në *Mësuesi në Biologji - Kimi* (120 ECTS) | VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008 |
| | Master i Shkencave në *Biologji Mjedisore* (120 ECTS) | VKM Nr. 1162, datë 25.11.2009 |
| **3. Departamenti i Fizikës** | Program profesional "Specialist i lartë elektrik" me 120 ECTS | VKM nr. 459, datë 27.07.2022 Nr. prot., 4088/2, datë 29.07.2022 |
| | | |
| | Bachelor në Fizikë (180 ECTS) | Vendim Nr. 4/1 i Ministrit, datë 15.01.1999 |
| | Master Profesional në *Mësuesi në Matematikë e Fizikë* (120 ECTS) | VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008 |
| | | |
| **4. Departamenti i Matematikës** | Program profesional "Teknik sistemesh dhe rrjetesh kompjuterike" (120 ECTS). | VKM Nr. 190, datë 03.07.2020 |
| | Bachelor në "Matematikë" (180 ECTS) | MASH Nr. 4, datë 15.01.1999 |
| | Bachelor në "Informatikë" (180 ECTS) | Shkresë MASH Nr. 2571/1 prot., datë 19.07.2002 |
| | Bachelor në "Informatikë" në gjuhën angleze (180 ECTS), | Urdhër nr. 365, datë 01.07.2022 Nr. prot., 3321/3, datë 08.07.2022 |

| | | |
|---|---|---|
| | Master Profesional në *Mësuesi në Informatikë* me Profil Minor në Matematikë (120 ECTS) | MASH Nr. 506, datë 8.11.2010 |
| | Master Profesional në *Mësuesi në Matematikë* me Profil Minor në Informatikë (120 ECTS) | MASH Nr. 506, datë 08.11.2010 |
| | Master Profesional *Advanced Software Development* me 120 pikë kredite | Urdhër nr. 581, datë 04.10.2022, |

**Tabelë 9:** *Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHN-ja*

### *6.2. Fakulteti i Shkencave të Edukimit*

**Misioni i FSHE**-së vjen në të njëjtën linjë me misionin e USH, duke synuar krijimin, zhvillimin, mbrojtjen dhe transmetimin e dijeve me anën e mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore, formimin e specialistëve të lartë dhe përgatitjen e shkencëtarëve të rinj në fushën e mësimdhënies në arsimin parashkollor, në arsimin fillor, edukimin fizik, në fushën e arteve dhe në fushat e shkencave sociale me specialitet psikologjinë dhe punën sociale. FSHE punon në realizimin e objektivave me qëllim që të sigurojë një mësimdhënie të kualifikuar, të krijojë kushte për mësim dhe kërkim shkencor si dhe të përgatisë specialistë të aftë në të gjitha disiplinat që mbulon FSHE.

**Politika e Cilësisë:** Të mbajë dhe të zhvillojë më tej rolet dhe funksionin e fakultetit si sigurues i cilësisë në arsimimin e të gjitha shtresave në funksion të prioriteteve të zhvillimit të vendit.

**Fakulteti ofron:**

Kurrikula të pasura dhe të larmishme programesh mësimore në të dy nivelet, (Cikli I dhe Cikli II), në zbatim të *Deklaratës së Bolonjës*, legjislacionit për *Arsimin e Lartë* dhe udhëzimeve të MAS, në përputhje me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësinë për të fituar njohuritë e fundit akademike dhe aftësitë e nevojshme praktike.

Staf akademik të kualifikuar me tituj e grada shkencore, profesionalizëm dhe përkushtim i tij për t'u përballur me sfidat për përmbushjen e qëllimeve që ka FSHE-ja.

Nivel të lartë të punës kërkimore - shkencore të pedagogëve dhe të aktivitetit të tyre botues.

Monitorim i përvitshëm i cilësisë së mësimdhënies.

Numër të lartë aktivitetesh të realizuara nga pedagogët me studentë (orët e hapura, të ftuar specialistë të fushës).

Marrëdhënie të ngushtë bashkëpunimi me institucionet e qeverisjes lokale dhe shërbimet e ofruara nga OJF – të, ku zhvillohen praktikat profesionale të studentëve.

Bashkëpunim të vazhdueshëm të *Fakultetit të Shkencave të Edukimit* me komunitetin akademik, e më gjerë.

*Skedë informuese për FSHE*

| **EMRI I FAKULTETIT** | **Fakulteti i Shkencave të Edukimit** |
|---|---|
| Adresa: | Rruga "Kolë Heqimi", Shkodër |
| Kontakt: | Website: www.unishk.edu.al/Fakultetet |
| Licencuar: | VKM nr.125, datë 01.09.1991 si Fakultet i Ciklit të Ulët.<br>Vendim Senati nr. 117, datë 31.10.2000 si Fakulteti i Shkencave të Edukimit |
| Dekani | Prof. as. Dr. Fatmir Vadohej<br>Email-fatmir.vadahi@unishk.edu.al |
| 4 Departamente | Departamenti *Psikologji-Punë Sociale*<br>Departamenti i *Mësuesisë*<br>Departamenti *Edukim fizik dhe sporte*<br>Departamenti i Arteve |
| Ciklet e studimit | Cikli I i studimeve (me 7 programe studimi Bachelor),<br>Cikli II i studimeve ( me 3 programe studimi *Master Profesional* dhe me 3 programe studimi *Master i Shkencave*) |

**Tabelë 10. Skedë informuese e FSHE-së**

*Skedë informuese për programet e studimit që ofron FSHE-ja*

| Departamenti | Programi i studimit | Dokument Licencimi |
|---|---|---|
| **1. Psikologji - Punë Sociale** | Bachelor në *Psikologji* (180 ECTS) | Shkresë MASH Nr. 4276 prot., datë 01.07.2004 |
| | Bachelor në *Punë Sociale* (180 ECTS) | VKM Nr. 560, datë 12.08.2005 |
| | Master i shkencave në "Psikologji klinike" (120 ECTS) | MASH Nr. 395, datë 10.08.2011 |
| | Master i shkencave në "Psikologji organizative" (120 ECTS) | MASH Nr. 395, datë 10.08.2011 |
| | Master Profesional në "Shërbimet Sociale'' (60 ECTS). (Për vitin akademik 2021-2022), (60 ECTS). | VKM Nr. 334, datë 17.09.2021 |
| **2. Departamenti i Mësuesisë.** | Bachelor në Mësuesi për "Arsimin fillor" (180 ECTS) | VKM Nr.167, datë 28.05.1991 |
| | Bachelor në Mësuesi për "Arsimin parashkollor" (180 ECTS) | VKM Nr.332, datë 13.05.1996 |
| | Master i shkencave në Mësuesi për "Biologji - Kimi me profil minor në "Karriera dhe aftësimi për jetën" (120 ECTS). | VKM Nr. 548, datë 16.08.2012 |
| | Master profesional në Mësuesi për "Arsimin fillor" (120 ECTS) | VKM Nr. 598, datë 07.12.2012 |
| | Master profesional në "Pedagogji Speciale" (120 ECTS) | Master Profesional në "Pedagogji Speciale" Urdhër Nr. 441, datë 10.08.2023 120 ECTS |
| | Programi i studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike (35 ECTS). | Program studimi i Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko - Pedagogjike Urdhër Nr.375, datë 14.07.2023 35 ECTS |
| **3. Edukim Fizik dhe Sporte** | Bachelor në "Edukim fizik" (180 ECTS) | Shkresë e MASH-it Nr. 2742 prot., datë 27.04.2006 |
| | | |
| | Master profesional në Mësuesi për "Edukim fizik dhe Sporte" (120 ECTS). | VKM Nr. 1212, datë 11.12.2009 |
| **4. Departamenti i Arteve** | Bachelor në "Pikturë e Grafikë" (180 ECTS) | MASH Nr. 272, datë 20.07.2015 |

| | | |
|---|---|---|
| | Bachelor në "Pedagogji muzikore" (180 ECTS) | MASH Nr. 272, datë 20.07.2015 |
| | Master profesional në "Mësues muzike'' (120 ECTS), | Urdhër nr. 581, datë 04.10.2022, nr. prot., Nr 1701/2, datë 04.10.2022 |
| | Master profesional "Mësues i Artit Pamor'' (120 ECTS). | Urdhër nr. 504, datë 06.09.2022, nr. prot., Nr. 5697/1, datë 06.09.2022 |

**Tabelë 11: Skedë informuese të programeve të studimit FSHE**

### *6.3. Fakulteti i Drejtësisë*

**Misioni:** *Fakulteti i Drejtësisë* ka si mision t'u ofrojë studentëve njohuri të përgjithshme dhe specifike profesionale dhe shkencore në përshtatje me tregun e punës në fushën e të drejtës. *Fakulteti i Drejtësisë* synon ofrimin e njohurive të përgjithshme dhe specifike, shkencore dhe profesionale në fushën e së drejtës, duke përgatitur për ndjekjen e Shkollës së Magjistraturës dhe shkollimit në profesionet e lira, por edhe në ushtrimin e profesionit si punonjës të administratës publike dhe asaj gjyqësore, nëpunës gjyqësorë civilë.

**Politika e Cilësisë:** *Fakulteti i Drejtësisë* synon rritjen e cilësisë së arsimimit të studentëve, përmes përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe kualifikimit të vazhdueshëm të stafit akademik.

**Fakulteti ofron:**

Një kurrikul të pasur dhe të larmishëm programesh mësimore në të dy ciklet e studimeve, në përputhje me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësinë për të fituar njohuritë e fundit akademike dhe aftësitë praktike për hartimin e akteve ligjore si juristë në administratën gjyqësore, publike e private, në aftësimin për argumentim të përshtatshëm për zgjidhjen e çështjeve juridike të përgjithshme dhe të veçanta të nevojshme për specialitetin përkatës në tregun e punës.

Një kurrikul në bashkërendim me kërkesat dhe parimet evropiane që mundëson lëvizshmërinë e studentëve në programe studimi jashtë vendi me mundësi ekuivalentimi.

Infrastrukturë mbështetëse për studentët, mjedise me hapësira të përshtatshme dhe teknologji bazë, pajisje dhe programe kompjuterike, internet, bibliotekë universitare etj.

Bashkëpunim të ngushtë student-pedagog dhe mbështetje të vazhdueshme për formimin profesional të studentëve.

*Skedë informuese për Fakultetin e Drejtësisë*

| EMRI I FAKULTETIT | Fakulteti i Drejtësisë |
|---|---|
| Adresa: | Rruga "Jeronim de Rada" 12, Shkodër |
| Kontakt: | Website: www.unishk.edu.al/Fakultetet |
| Licencuar: | VKM nr.332, datë 13.05.1996 |
| Dekani | Dr. Gasper Kokaj<br>Email- gasper.kokaj@unishk.edu.al |
| Departamentet | Departamenti i të *Drejtës Publike dhe Penale*<br>Departamenti i të *Drejtës Civile*<br>Departamenti i të *Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane* |
| Ciklet e studimit | 1. Cikli I i studimeve (1 program studimi Bachelor)<br>1. Programi i integruar i studimit *Master i Shkencave në Drejtësi*;<br>2. Master i Shkencave në të *Drejtën Kushtetuese dhe Administrative*;<br>3. Master i Shkencave në të *Drejtën Private dhe të Biznesit*. |

**Tabelë 12: Skedë informuese e FD**

*Skeda informuese për programet e studimit që ofron FD*

| Programi i studimit | Dokument Licencimi |
|---|---|
| Program i Integruar i studimit *Master i Shkencave në Drejtësi* (300 ECTS) | VKM Nr. 191, datë 03.07.2020 |
| Bachelor në *Drejtësi* (180 ECTS) | VKM Nr. 349, datë 10.08.1992 |
| 2. Master i Shkencave në të *Drejtën Kushtetuese dhe Administrative* (120 ECTS) | VKM Nr. 682, datë 25.08.2010 |
| 3. Master i Shkencave në të *Drejtën Private dhe të Biznesit*. (120 ECTS) | VKM Nr. 1162, datë 25.11.2009 |
| Master i Shkencave në *Drejtësi* (5 vjeçar) PIND | Urdhër nr. 191, datë 03.07.2020<br>Nr. prot., 2329/2, datë 03.07.2022 |

**Tabelë 13: Skedë informuese për programet e studimit që ofron FD**

## 6.4. Fakulteti Ekonomik

**Misioni**: *Fakulteti Ekonomik* ka si mision formimin e studentëve me njohuritë më bashkëkohore duke synuar përgatitjen e tyre, si: menaxherë, financierë, kontabilistë dhe specialistë në fushën e turizmit të aftë për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të komunitetit e të vendit, si dhe në kërkimin shkencor dedikuar fushës së ekonomisë.

**Politika e Cilësisë:** Të mbajë dhe të zhvillojë më tej rolet dhe funksionin e fakultetit si sigurues i cilësisë në arsimimin e të gjitha shtresave në funksion të prioriteteve të zhvillimit ekonomik të vendit.

**Fakulteti ofron:**

Programe mësimore në të dy ciklet e studimeve, në përputhje me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësinë për të fituar njohuritë e fundit akademike dhe aftësitë praktike.

Pjekuri e profesionalizëm, përkushtim i një personeli akademik dinamik për t`i përballuar me sukses sfidat në përmbushje të misionit të fakultetit.

Mbështetje nga profesorë të ftuar vendas dhe të huaj, të cilët pasurojnë programet tona duke ndarë përvojat e tyre.

Mundësi kombinimi të vazhdueshëm të njohurive teorike me praktikën profesionale në organizata biznesi, institucione të ndryshme, sipas fushës së studimit.

Studime universitare që zhvillohen në përputhje me rregullat dhe parimet e *Hapësirës Evropiane* të *Arsimit të Lartë.*

Mundësi për të marrë pjesë në programet mësimore të ofruara nga *Fakulteti Ekonomik* edhe për studentët e trojeve shqiptare.

Bashkëpunim i FE-së me universitete në Evropë dhe në SHBA për kërkimin shkencor, mobilitete për stafin akademik dhe studentët e këtij fakulteti.

Bashkëpunim i vazhdueshëm i FE-së me komunitetin akademik, autoritetet e qeverisjes qendrore e vendore, komunitetin e biznesit dhe OJF-të në realizimin e misionit të tij.

*Skeda informuese për FE*

| EMRI I FAKULTETIT | Fakulteti Ekonomik |
|---|---|
| Adresa: | Sheshi "Dugajtë e Reja", Shkodër |

| | |
|---|---|
| Kontakt: | Website: www.unishk.edu.al/Fakultetet |
| Licencuar: | VKM nr.332, datë 1996 |
| Dekani | Prof. as. dr. Blerta Dragusha<br>Email- blerta.dragusha@unishk.edu.al |
| Departamentet | *1.* Departamenti i *Financë-Kontabilitetit*<br>*2.* Departamenti i *Administrim-Biznesit*<br>*3.* Departamenti i *Turizmit* |
| Ciklet e studimit | *3* programe studimi *Bachelor*<br>*4* programe studimi *Master Profesional*<br>4 programe studimi *Master i Shkencave*<br>1 Doktoratë në "Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm". |

**Tabela 14. Skeda informuese për FE**

*Skeda informuese për programet e studimit që ofron FE*

| Departamenti | Programi i studimit | Dokument Licencimi |
|---|---|---|
| **Departamenti i *Financë – Kontabilitetit*** | Bachelor në *Financë – Kontabilitet* (180 ECTS) | Shkresë MASH Nr. 4390 Prot., datë 23.10.2000 |
| | Master Profesional në *Financë – Bankë* (120 ECTS) | UMASH Nr. 503, datë 18.10.2012 |
| | Master Profesional në *Menaxhimi financiar, Kontabiliteti dhe Kontrolli në Administratën Publike* (60 ECTS) | MASR Nr. 702, datë 19.10.2018 |
| | Master i Shkencave në Kontabilitet (120 ECTS) | UMASH Nr. 395, datë 10.08.2011 |
| | Master i Shkencave në Financë (120 ECTS) | MASH Nr. 395, datë 10.08.2011 |
| **Departamenti Administrim - Biznes** | Bachelor në *Administrim – Biznes* (180 ECTS) | VKM Nr. 349, datë 10.08.1992 |
| | Master Profesional në *Administrim - Biznes* (120 ECTS) | UMASH Nr. 503, datë 18.10.2012 |
| | Master i Shkencave në *Administrim - Biznes* (120 ECTS) | UMASH Nr. 395, datë 10.08.2011 |
| **3. Turizëm** | Bachelor në *Turizëm* (180 ECTS) | MAS vendim 1803/1, datë 05.06.2001 |

| | | |
|---|---|---|
| | Master Profesional në *Trashëgimi kulturore dhe Menaxhim Turizmi* (120 ECTS) | UMASH Nr. 503, datë 18.10.2012 |
| | Master i Shkencave në *Turizëm të Qëndrueshëm* (120 ECTS) | VKM Nr. 1370, datë 10.10.2008 |
| | Doktoraturë në "*Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm*" | Nr. 86, Dt.14.11.2022, |

**Tabelë 15: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FE**

### *6.5. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja*

**Misioni:** *Fakulteti i Gjuhëve të Huaja* ka si mision formimin e studentëve të nivelit *Bachelor* me njohuritë më bashkëkohore, duke synuar përgatitjen e tyre si specialistë në fushën e gjuhësisë, të letërsisë, të përkthimit dhe të komunikimit ndërkulturor, aftësimin e studentëve për të kryer punë kërkimore edhe në rrafshe krahasimore mes gjuhës dhe kulturës së studiuar dhe asaj shqipe. formimin e studentëve të nivelit *Master Profesional* me metodologjitë dhe teknikat më bashkëkohore dhe të njohura në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës së huaj.

**Politika e Cilësisë:** Të ruajë standardet dhe të zhvillojë më tej rolet dhe synimin e fakultetit si sigurues i cilësisë në arsimimin e brezave në funksion të kërkesave për specialistë dhe përkthyes të gjuhëve të huaja.

**Fakulteti ofron:**

Programe mësimore në të dy nivelet, *Bachelor* dhe *Master Profesional*, të hartuara me mbështetjen e fortë dhe të qëndrueshme të universiteteve dhe institucioneve partnere evropiane në bashkërendim me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësi për të fituar njohuritë më të përditësuara në fushën akademike dhe aftësitë praktike.

Një kurrikul në bashkërendim me kërkesat dhe parimet evropiane që mundëson lëvizshmërinë e studentëve në programe studimi jashtë vendi me mundësi ekuivalentimi.

Formim, përkushtim, korrektësi dhe profesionalizëm të stafit akademik të specializuar në universitete perëndimore për të përballuar dhe përmbushur me sukses sfidat dhe detyrimet në përmbushje të misionit të fakultetit dhe për t'u formuar në vazhdimësi.

Mbështetje nga profesorë dhe personalitete të ftuar, vendas dhe të huaj, nga universitetet partnere që pasurojnë programet e studimit pranë këtij fakulteti, duke bashkëndarë përvojat e

tyre me stafet e FGJH-së, përmes leksioneve të hapura dhe konferencave që realizohen me nisma të përbashkëta.

Bashkëpunime të frytshme me *Universitete Evropiane*, që ofrojnë mundësi të shkëlqyera studimi përmes akordimit të bursave për studentët dhe përvoja shkëmbimi dhe pasurimi profesional për stafin akademik.

Ofrimi i bursave semestrale në kuadër të programit *Erasmus+* në universitete gjermane dhe italiane

Mësimdhënie nga lektorë të huaj austriakë, italianë, amerikanë, të cilët ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së studimit akademik.

Klimë pozitive bashkëpunimi mes stafit akademik dhe studentëve. Në fakultetin tonë mirëpriten studentët e trojeve dhe të huaj me kuota të veçanta.

**Skeda informuese për FGJH**

| EMRI I INSTITUCIONIT | Fakulteti i Gjuhëve të Huaja |
|---|---|
| Adresa: | Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Rruga Dom Bosko, nr. 2, P.O.BOX 4001 |
| Kontakt: | dekanatifgjhush@gmail.com<br>Website: www.unishk.edu.al/Fakultetet |
| Dekani | Prof. as.dr. Edlira Bushati<br>Email-edlira.bushati@unishk.edu.al |
| Licencuar: | VKM Nr. 28, datë 20.01.2001 si Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi". |
| Akredituar: | Vendim i KA, Nr. 130/4, datë 16.10.2006 |
| Departamentet | Departamenti i Gjuhës Angleze<br>Departamenti i Romanistikës<br>Departamenti i Gjermanistikës |
| Ciklet e studimit | Cikli I i studimeve (Bachelor)<br>Cikli II i studimeve (Master Profesional) |

**Tabelë 16: Skedë informuese për FGJH**

*Skeda informuese për programet e studimit që ofron FGJH-ja*

| Departamenti | Programi i studimit | Dokument Licencimi |
|---|---|---|
| **1. Departamenti i Gjuhës Angleze** | Bachelor në *Gjuhë Angleze* (180 ECTS) | VKM Nr. 300, datë 21.06.1994 |
| | "Master Profesional në Mësuesi" *në Gjuhë Angleze* (120 ECTS) | hapur me VKM nr. 1291, datë 24.09.2008 |

| | | |
|---|---|---|
| | | ristrukturuar me Urdhër të MASR nr.335, datë 17.09.2021. |
| **2. Departamenti i Gjermanistikës** | Bachelor në *Gjuhë Gjermane* (180 ECTS) | Shkresë MASH Nr. 960 prot. datë 11.03.1996 |
| | "Master Profesional në Mësuesi" në Gjuhën Gjermane (120 ECTS) | VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008 ristrukturimi me Urdhër të MASR nr.333, datë 17.09.2021 |
| **3. Departamenti i Romanistikës** | Bachelor në "Gjuhë Italiane" (180 ECTS) | VKM Nr. 146, datë 04.08.1998 |
| | Bachelor në "Gjuhë Frënge" (180 ECTS) | VKM Nr.560, datë 12.08.2005 |
| | "Master Profesional në Mësuesi" në *Gjuhën Frënge* (120 ECTS) | VKM Nr. 1333, datë 01.10.2008 Ristrukturimi " Master profesional në Mësuesi" me 120 ECTS, me Urdhër të MASR nr. 336, datë 17.09.2021 |
| | "Master Profesional në Mësuesi" në Gjuhë Italiane (120 ECTS) | VKM Nr. 1333, datë 01.10.2008 ristrukturimi në "Master profesional në Mësuesi" me 120 ECTS, është miratuar me Urdhër të MASR nr. 337, datë 17.09.2021 |

**Tabelë 17: Skedë informuese për programet e studimit që ofron FGJH-ja**

### *6.6. Fakulteti i Shkencave Shoqërore*

**Misioni:** *Fakulteti i Shkencave Shoqërore* ka si mision formimin dhe kualifikimin e studentëve në të gjitha ciklet, përgatitjen e specialistëve në fushën e gjuhësisë, të letërsisë, të historisë, të gjeografisë, të gazetarisë, por edhe të disiplinave të përafërta kulturore, si: redaktorë gjuhësorë dhe letrarë, punonjës biblioteke, ciceronë muzesh dhe guidë turistike, zëdhënës shtypi e specialistë të sektorit të komunikimit. Gjithashtu ky fakultet përmes programeve të studimit *Master Profesional në Mësuesi* synon formimin e mësuesve të kualifikuar në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Përmes programeve të studimit Master i Shkencave dhe Doktoraturë synohet formimi i specialistëve të profilit të lartë në fushat e sipërpërmendura, si: pedagogë, studiues e kërkues shkencor.

**Politika e Cilësisë:** *Fakulteti i Shkencave Shoqërore* kujdeset dhe shquhet për cilësinë e studimeve në arsimin e lartë në të gjitha ciklet. Ai vepron në fushën e formimit kulturor dhe profesional, duke synuar arritjen e standardeve të larta dhe konkurruese në profilet e

përmendura në nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtar, si dhe kujdeset për formimin dhe përditësimin e njohurive.

**Fakulteti ofron:**

Programe studimi në të dy ciklet për të gjitha profilet e studimit, ndërsa për Gjuhën shqipe edhe në nivel doktorature.

Kurrikula të përditësuara që u japin mundësi studentëve të përballen dhe të jenë të suksesshëm në tregun e punës.

Staf akademik të kualifikuar brenda dhe jashtë vendit, me përvojë akademike, që ofron një mësimdhënie bashkëkohore.

Personalitete me kontribute të veçanta nga fushat kërkimore që mbulojnë dhe bashkëpunim në kërkimin shkencor.

Përfshirjen e të gjithë stafit të fakultetit jo vetëm në procesin mësimor, por edhe në kërkimin shkencor përmes botimeve me vlerë konkurruese në nivel kombëtar, në fushat përkatëse.

Infrastrukturë mbështetëse për studentët, mjedise me hapësira të përshtatshme dhe teknologji bazë, pajisje dhe programe kompjuterike, internet, bibliotekë universitare etj.

Bashkëpunim të ngushtë student-pedagog dhe mbështetje të vazhdueshme për formimin profesional e shkencor të studentëve.

Lidhje të teorisë me praktikën përmes ekspeditave, praktikave profesionale, laboratorëve dhe punëve praktike.

Mobilitet të studentëve në kuadrin e projekteve të ndryshme ndërkombëtare.

Bashkëpunim me fakultetet simotra brenda dhe jashtë vendit, si dhe me qendra të rëndësishme kërkimore-shkencore.

*Skeda informuese për FSHSH-në*

| EMRI I FAKULTETIT | **Fakulteti i Shkencave Shoqërore** |
|---|---|
| Adresa: | Rruga "Jeronim de Rada" 4, Shkodër |
| Kontakt: | Website: www.unishk.edu.al/Fakultetet |
| Licencuar: | VKM nr. 167, datë 28.03.1991 |
| Dekani | Prof. dr. Artan Haxhi<br>Email - artan.haxhi@unishk.edu.al |

| | |
|---|---|
| Departamentet | 1. Departamenti i Gjuhës shqipe<br>2. Departamenti i Letërsisë<br>3. Departamenti i Historisë<br>4. Departamenti i Gjeografisë |
| Ciklet e studimit | 6 programe studimi Bachelor.<br>3 programe studimi Master Profesional<br>4 programe studimi Master i Shkencave<br>1 Doktoraturë në "Gjuhë shqipe" |

**Tabelë 18: Skedë informuese për FSHSH-në**

*Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHSH*

| Departamenti | Programi i studimit | Dokument Licencimi |
|---|---|---|
| **1. Departamenti i Gjuhës shqipe** | Bachelor në *Gjuhë – Letërsi* (180 ECTS) | VKM Nr. 150 prot., datë 18.04.1957 |
| | Master Profesional në *Mësuesi në Gjuhë – Letërsi* (120 ECTS) | VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008 |
| | Master i Shkencave në "Studime shqiptare dhe Etnokulturore", profili "Studime të Thelluara në Gjuhësi" (120 ECTS) | VKM Nr. 619, datë 11.06.2009 |
| | Doktoraturë në "Gjuhë shqipe" | UMASH Nr. 498, datë 07.10.2011 |
| **2. Departamenti i Letërsisë** | Bachelor në *Gazetari dhe Komunikim* (180 ECTS) | Shkresë MASH Nr. 2743 prot., datë 27.04.2006 |
| | Master Shkencave në "Studime shqiptare dhe Etnokulturore", profili "Etnokultura dhe Letërsia Shqipe" (120 ECTS) | VKM Nr. 619, datë 11.06.2009 |
| **3. Departamenti i Historisë** | Bachelor në *Histori-Gjeografi* me drejtim Histori (180 ECTS) | Shkresë MASH Nr. 1127 prot., datë 20.02.2006 |
| | Bachelor në *Histori dhe trashëgimi kulturore* (Për vitin akademik 2021-2022) (180 ECTS) | VKM Nr. 272, datë 21.07.2021 |
| | Master i Shkencave "*Studime të Historisë dhe të kulturës Shqiptare*" | Urdhër Nr. 583, datë 04.10.2022 |

| | | |
|---|---|---|
| 4. Departamenti i Gjeografisë | Bachelor në *Histori-Gjeografi* me drejtim Gjeografi (180 ECTS) | Shkresë MASH Nr. 1127 prot., datë 20.02.2006 |
| | Bachelor në "Gjeografi dhe zhvillim territori" | |
| | Master Profesional në "Mësuesi Histori – Gjeografi" (120 ECTS) | VKM Nr. 1212, datë 11.12.2009 |
| | Master i Shkencave "Studime Regjionale në Gjeografi" (120 ECTS) | UMASH Nr. 212, datë 31.05.2013 |
| | Program studimi me karakter profesional "Udhërrëfyes turistik dhe Menaxhues i itinerareve turistike për Rajonin Verior" (60 ECTS) | VKM Nr. 196, datë 03.07.2020 |
| | Master i Shkencave *Studime Regjionale në Gjeografi* | VKM nr. 440, datë 20.07.2022 Nr. prot., 4872/1, datë 25.07.2022 |

**Tabelë 19: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHSH**

## 7. Përmbledhje e analizave sipas RVB-ve të fakulteteve

Analiza e RVB-ve të fakulteteve mbështetur në standarde është një proces i rëndësishëm që shërben për të vlerësuar dhe përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e funksionimit të një institucioni akademik. RVB-të e fakulteteve kanë vlerësuar funksionimin e programeve të studimit dhe kanë identifikuar fushat ku mund të përmirësohet cilësia e mësimdhënies dhe e nxënies. Kanë vlerësuar përgatitjen e studentëve në njohuri, aftësi dhe kompetenca të fituara gjatë studimeve. RVB-të e fakulteteve në procesin e akreditimit na sigurojnë kriteret e nevojshme.




| **Standardi 1.** ***Institucioni i arsimit të lartë, menaxhimi, autonomia dhe sigurimi i cilësisë*** **FSHE** | |
|---|---|
| **Menaxhimi** | Organet kolegjiale në FSHE janë:<br>a) Asambleja e personelit akademik;<br>b) Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë në FSHE dhe në programet e studimit; c) Dekanati.<br>FSHE ka përgatitur strategjinë e zhvillimit, në përputhje me misionin e tij dhe me objektivat dhe platformën e zhvillimit të USH-së. |
| **Autonomia** | FSHE respekton autonominë e vet, bazuar në Statutin e USH-së.<br>Në FSHE ekziston debati konstruktiv, që nga njësia bazë deri tek dekanati. Në nivel departamenti vendimet merren në mbledhje, ku secili anëtar shpreh mendimet e tij. E njëjta frymë diskutimi është edhe në dekanat.<br>**Evidence 1.1.** Statuti .<br>https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/dokumenta_unishk/Statuti_USH_qershor_2018.pdf.<br>Evidence 1.2 Rregullore e administratës.<br>Evidence 1.3 Rregullore e Fakultetit.<br>Evidence 1.4. Rregullore e Departamentit.<br>Evidence 1.5 Rregullore e programeve të Studimit. |
| | Departamentet hartojnë raportin mbi veprimtarinë mësimore dhe shkencore, bazuar në raportet e secilit pedagog. Përgjegjësi i departamentit harton raportin përfundimtar, i cili bëhet objekt diskutimi në një mbledhje të caktuar. (Evidencë 1.10. Strategjinë e zhvillimit të FSHE). |
| **Sigurimi i cilësisë** | Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit përbën një preokupim kryesor për të gjitha departamentet. Në FSHE është ngritur NjSBC-ja e Fakultetit. GVB-të përkatëse hartojnë raportet e vlerësimit të brendshëm për secilin program studimi. Këto raporte diskutohen dhe miratohen në departamentet përkatëse, më pas në |

| | |
|---|---|
| | dekanat. (**Evidencë 5.7.1**). Po ashtu, NjSBC-ja e fakultetit, me ndihmën dhe monitorimin e zv.dekanes, harton RVB-në e fakultetit, i cili diskutohet dhe miratohet në dekanat (**Evidencë 5.7.2**). Dekanati, me Vendim Nr. 61, datë 06.11.2020, ka miratuar një pyetësor për të marrë mendimet e studentëve të sapo diplomuar. Të dhënat e përftuara analizohen dhe hartohet relacioni përkatës, i cili diskutohet dhe miratohet në dekanat.<br>FSHE bën përpjekje për të monitoruar programet e studimit që ofron. Në fillim të vitit akademik secili departament miraton syllabuset e lëndëve, duke raportuar ndryshimet e bëra dhe arsyet përkatëse. Gjithashtu, merret edhe mendimit i studentëve që diplomohen. Pas përfundimit të diplomimit, të diplomuarit plotësojnë pyetësorin lidhur me cilësinë e programit të studimit, për të cilin hartohet një raport që kalon në Dekanat, nga ku nxirren edhe përfundimet përkatëse.<br>Departamentet angazhohen në proceset për sigurimin e brendshëm të cilësisë në FSHE. Çdo departament ka krijuar grupin e punës për hartimin e RVB-ve të programeve të studimit. Në përbërje të këtyre grupeve janë të përfshirë pedagogë, studentë dhe ekspertë të fushës të cilët gjenerojnë ide me qëllim përmirësimin e cilësisë. RVB-të e hartuara kalojnë për miratim në departamentet përkatëse dhe më pas në Dekanat. (Evidencë 1.15 Raporti i punës mësimore shkencore 2020-2021); (**Evidencë 1.16.** Relacion mbledhje depar. ose dekanati për miratimin e RVB-ve).<br>Për herë të parë disa programe studimi kalojnë në proces akreditimi: Ba në Mësuesi për Arsim fillor, Ba në Mësuesi për Edukim fizik e sporte, Ba në Psikologji. Njëkohësisht, do të vazhdojë puna me përfshirjen në procesin e akreditimit të programeve të tjera të ciklit të parë për të finalizuar procesin e akreditimit të të gjitha programeve të studimit që fakulteti ofron. |

| Standardi 1. ***Institucioni i arsimit të lartë, menaxhimi, autonomia dhe sigurimi i cilësisë***<br>FE | |
|---|---|
| Menaxhimi | Në USH ka ndarje të qarta të veprimtarisë së organeve dhe autoriteteve drejtuese dhe personelit akademik dhe atij administrativ. Kompetencat janë të detajuara në statutin e USH-së si dhe në rregulloret e tij konform legjislacionit përkatës në fuqi. |
| Autonomia | Statuti i USH-së garanton mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit. Strategjia e USH-së është e mire strukturuar dhe në përputhje me ligjin e arsimit të lartë. |
| Sigurimi i cilësisë | USH ka hartuar dhe zbaton politika dhe instrumente konkrete të vlerësimit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, të cilat synojnë përfshirjen në këtë proces të të gjithë stafeve dhe studentëve të fakulteteve të këtij universiteti. Njëkohësisht, rezultatet e këtij procesi janë transparente dhe u komunikohen si stafeve ashtu edhe studentëve të fakulteteve përkatëse. Raporti vjetor i USH-së diskutohet gjerësisht me grupet e interesit si dhe është i aksesueshëm në website. Gjatë kësaj periudhe në NJSBC-në e FE-së dhe departamenteve përkatëse janë atashuar ekspertë të jashtëm akademikë, të cilët ofrojnë ekspertizën e tyre në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit si dhe të mësimdhënies e kërkimit shkencor në nivel fakulteti. |

| **Standardi 1.** ***Institucioni i arsimit të lartë, menaxhimi, autonomia dhe sigurimi i cilësisë*** |
|---|

| FSHN | |
|---|---|
| **Menaxhimi** | Organet kolegjiale në FSHN janë:<br>a) Asambleja e personelit akademik;<br>b) Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë në FSHN dhe në programet e studimit;<br>c) Dekanati.<br>FSHN ka përgatitur strategjinë e zhvillimit, në përputhje me misionin e tij dhe me objektivat dhe platformën e zhvillimit të USH-së. |
| **Autonomia** | FSHN respekton autonominë e vet, bazuar në Statutin e USH-së.<br>Në FSHN ekziston debati konstruktiv, që nga njësia bazë deri tek dekanati. Në nivel departamenti vendimet merren në mbledhje, ku secili anëtar shpreh mendimet e tij. E njëjta frymë diskutimi është edhe në dekanat.<br>Departamentet hartojnë raportin mbi veprimtarinë mësimore dhe shkencore, bazuar në raportet e secilit pedagog. Përgjegjësi i departamentit harton raportin përfundimtar, i cili bëhet objekt diskutimi në një mbledhje të caktuar. |
| **Sigurimi i cilësisë** | Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit përbën një preokupim kryesor për të gjitha departamentet. Në FSHN është ngritur NjSBC-ja e Fakultetit (**Evidencë A**). GVB-të përkatëse hartojnë raportet e vlerësimit të brendshëm për secilin program studimi. Këto raporte diskutohen dhe miratohen në departamentet përkatëse, më pas në dekanat. Këtë vit 3 programe studimi te ciklit te pare i janë nënshtruar akreditimit, përkatësisht programet bachelor ne Biologji Kimi, bachelor ne matematik dhe bachelor ne informatike (**Evidencë 1.4; 1.5**).<br>Në ditën e diplomimit, pasi të kenë përfunduar provimin apo prezantimin e punimit shkencor, ata plotësojnë një pyetësor lidhur me cilësinë e programit të studimit (**Evidencë 1.6**)<br>FSHN bën përpjekje për të monitoruar programet e studimit që ofron. Në fillim të vitit akademik secili departament miraton syllabuset e lëndëve, duke raportuar ndryshimet e bëra dhe arsyet përkatëse. Gjithashtu, merret edhe mendimit i studentëve që diplomohen. Pas përfundimit të diplomimit, të diplomuarit plotësojnë pyetësorin lidhur me cilësinë e programit të studimit, për të cilin hartohet një raport që kalon në Dekanat, nga ku nxirren edhe përfundimet përkatëse. |

| Standardi 1. ***Institucioni i arsimit të lartë, menaxhimi, autonomia dhe sigurimi i cilësisë***<br>FD | |
|---|---|
| **Menaxhimi** | FD respekton kufijtë e autonomisë universitare të garantuara nga IAL (80/2015). Ai ka autonomi të plotë dhe liri akademike që përcaktohen në Statutin e USH, Rregulloren e Studimeve në USH. FD vlerëson, në mënyrë të veçantë, kontributin e palëve të interesit në procesin e diskutimit dhe të vendimmarrjes. Dekani, zv/dekani dhe përgjegjësit e departamenteve mblidhen rregullisht në përputhje me detyrat e ngarkuara nga IAL (80/2015) dhe Statuti i USH. Dekanati respekton dhe diskuton në lidhje me opinionet dhe propozimet që bëhen nga anëtarët e dekanatit si dhe propozimet që vijnë nga departamentet e ndryshme apo nga grupe të caktuara studentësh të FD. |

| | |
|---|---|
| | Këshilli studentor gjithashtu ju ofron mundësi studentëve të jenë të mundur të shprehin mendimet dhe kërkesat e tyre për organet drejtuese të FD, kërkesa këto që shpesh dërgohen me anë të shkresës, por edhe mund të bëhen publike në ambientet e FD apo edhe në rrjetet sociale të FD dhe të këshillit studentor. |
| **Autonomia** | FD, i krijuar që në vitin 1992 si një nga njësitë kryesore të USH-së (**Evidencë 1.7**), aktualisht përbëhet nga tre departamente: Departamenti i të drejtës publike dhe penale; Departamenti i të drejtës civile; Departamenti i të drejtës ndërkombëtare dhe evropiane. Në FD funksionojnë dhe organet kolegjiale: Asambleja e personelit akademik; Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë (KGSC) në FD; Dekanati. Pranë FD funksionon edhe Klinika e Ligjit, e cila në zbatim edhe të Ligjit 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shtetit" ofron ndihmë ligjore parësore (**Evidencë 1.5**).<br>USH ka miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 115, datë. 31 maj 2022 "Strategjitë e zhvillimit të USH" (**Evidencë 1.6**). Ndër prioritetet e zhvillimit të USH bëjnë pjesë zhvillimi dhe implementimi i një strukture akademike të qëndrueshme, rritja e ofertës formative nëpërmjet programeve specifike të studimit. Në këtë drejtim përsa i përket ofertës formative të ofruar nga FD për studentët tashmë është cikli 5-vjeçar "Master i Integruar në Drejtësi", si dhe dy master shkencor në sistemin e studimit më kohë të plotë. |
| **Sigurimi i cilësisë** | Në Statutin e Universitetit janë parashikuar komisionet të cilat do të monitorojnë aspektet e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Neni 23 i Statutit ka të parashikuar Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë (KGSC) në USH dhe programeve të studimit (**Evidencë 1.2**). Aty përcaktohet detyrimi për të ngritur në rang universiteti dhe në njësitë kryesore komisionet për garantimin e standardeve të cilësisë dhe të programeve të studimit. Me vendimin e Senatit të USH-së Nr. 92, datë 13.04.2022 është miratuar "Manuali i cilësisë në USH", i cili synon të sigurojë dhe monitorojë sigurimin e cilësisë në USH dhe të programeve të studimit (**Evidencë 1.8**). Manuali parashikon ngritjen në njësitë kryesore të KGSC-ve dhe detyrat përkatëse të tyre. Me vendimin e Dekanatit, datë 14.11.2023 me nr. 486 Prot., është ristrukturuar KGSC në Fakultetin e Drejtësisë. Bazuar në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, FD ka krijuar Grupet e Vlerësimit të Brendshëm me pedagogë, studentë dhe ekspertë të jashtëm (GVB) për programet e studimit që ofron FD (**Evidencë 1.9 dhe 1.10**),<br>FD ka një praktikë të konsoliduar tashmë në monitorimin dhe vlerësimin e programeve të studimit, përmes hartimit të RVB-ve përkatëse nga Grupet e Vlerësimit të (GVB) të programeve të studimit, Departamentet kanë një rëndësi të madhe në këtë pikë. Diskutimet dhe vendosja e prioriteteve për programet e reja apo ndryshime të atyre ekzistuese si dhe për kurrikulën e çdo lëndë brenda departamentit përkatës e bën mësimdhënien të monitorueshme, në funksion të të nxënit më të mirë të mundshëm nga studentët e FD. Analiza vjetore e punës shkencore individuale dhe institucionale mundëson monitorimin e veprimtarisë shkencore të çdo anëtari të stafit akademik dhe mundëson përcaktimin e prioriteteve në të ardhmen (**Evidencë 1.13**).<br>Këshilli Drejtues i FD (Dekanati që përbëhet nga Dekan, Zv/dekan dhe Shefat e Departamenteve) nëpërmjet veprimtarisë kontrolluese të tij vlerëson në mënyrë periodike frytshmërinë e veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe administrative të FD. Departamenti gjithashtu luan një rol të rëndësishëm, pasi aty diskutohen programet dhe metodat e kërkimit dhe të mësimdhënies në lëndët përkatëse. Në funksion të realizimit të zhvillimit dhe ecurisë së programeve të studimit vjen edhe Paketa e instrumenteve për matjen e cilësisë në USH (**Evidencë 1.12**). |

| Standardi 1. ***Institucioni i arsimit të lartë, menaxhimi, autonomia dhe sigurimi i cilësisë*** FGJH | |
|---|---|
| **Menaxhimi** | Në FGJH ka ndarje të qarta të veprimtarisë mes organeve dhe autoriteteve drejtuese, personelit akademik dhe atij administrativ. Organizimi dhe funksionimi i kësaj njësie përcaktohet në Rregulloren e tij, e bazuar në statutin e USH-së si dhe në rregulloret e tij konform kuadrit ligjor në fuqi. Statuti i USH-së garanton mbarëvajtjen e veprimtarisë së fakultetit, që shkon në një linjë me Strategjinë e USH-së, e hartuar në përputhje me ligjin e arsimit të lartë. |
| **Autonomia** | FGJH respekton autonominë e vet, bazuar në Statutin e USH-së.<br>Në FGJH ekziston debati konstruktiv, duke filluar që nga njësia bazë deri tek dekanati. Në nivel departamenti vendimet merren në mbledhje të departamenteve, ku secili anëtar shpreh mendimet e tij. E njëjta frymë diskutimi është edhe në dekanat. |
| **Sigurimi i cilësisë** | Në hartimin e raporteve për vlerësimin e brendshëm për secilin program studimi marrin pjesë të gjithë anëtarët e departamenteve, duke filluar që nga përgjegjësi i departamentit, i cili ndihmon me mendimet dhe shkresat përkatëse, duke vazhduar me mendimet e studentëve dhe të ekspertit të jashtëm.<br>(Evidencë 1.11 Vendim për Zyrën e Sigurimit të Cilësisë).<br>(Evidencë 1.12 Vendim për Komisionin Ad-hoc për RVB).<br>(Evidencë 1.13 Vendim NjSBC në Fakultete).<br>(Evidencë 1.24 Analizë e pyetësorit të studentëve në USH nga Zyra e Sigurimit).<br>Edhe raporti lidhur me programin e studimit, bazuar në të dhënat e përftuara nga pyetësori me studentët e sapo diplomuar, diskutohet në dekanat dhe nxirren konkluzionet përkatëse.<br>Raporti vjetor i FGJH-së diskutohet gjerësisht me grupet e interesit si dhe do të jetë prioritet në vazhdim konsultimi i tij në website të FGJH-së, pasi kjo faqe të bëhet dinamike. Gjatë kësaj periudhe në NJSBC në nivel fakulteti dhe departamenti janë atashuar ekspertë të jashtëm akademikë, të cilët ofrojnë ekspertizën e tyre në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit si dhe të mësimdhënies e kërkimit shkencor në nivel fakulteti. Bëhen përpjekje për hapjen e programeve të reja të studimit në përputhje me nevojat e tregut të punës. |

| Standardi 1. ***Institucioni i arsimit të lartë, menaxhimi, autonomia dhe sigurimi i cilësisë*** FSHSH | |
|---|---|
| **Menaxhimi** | FSHSH funksionon në përputhje me statutin e Universitetit dhe në përputhje me të ka nxjerrë të gjitha aktet rregulluese të Fakultetit, të Departamenteve, të programeve të studimit etj. FSHSH siguron eficencë në menaxhim nëpërmjet mire organizimit të punës nga Rektori tek Dekani dhe tek pedagogët e studentët dhe anasjelltas, si dhe |

| | |
|---|---|
| | koordinimit të stafit akademik dhe jo akademik. FSHSH harton një strategji zhvillimi të vetën dhe të departamenteve, mbështetur mbi strategjinë e zhvillimit të Universitetit. |
| **Autonomia** | FSHSH njeh dhe respekton autonominë organizative e administrative, sipas Statutit të USH-së, që përfshin vetëdrejtimin. FSHSH favorizon debatin konstruktiv nëpërmjet procedurave të proceseve e punëve të vazhdueshme universitare. FSHSH publikon veprimtarinë kryesore të organeve kolegjiale që lidhen me transparencën. |
| **Sigurimi i cilësisë** | FSHSH harton dhe zbaton politika e procedura për sigurimin e cilësisë në programet e studimit që ofron. FSHSH monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme programet e studimit për të garantuar arritjen e objektivave dhe rezultateve të të nxënit, nëpërmjet pyetësorëve dhe formave të tjera të sigurimit të cilësisë. FSHSH përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës, por mund të bëjë një punë më të specializuar për këtë. FSHSH përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC të programeve të studimit, por mund të bëjë më shumë në lidhje me informimin e palëve të interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre, ashtu si mund të bëhet më shumë në mënyrë që politikat, proceset dhe veprimtaritë për *Sigurimin e Brendshëm* të cilësisë të jenë më publike, më transparente dhe më efektive dhe të kontribuojnë në krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë. |

**Përfundime mbi standardin**

- USH e ushtron veprimtarinë e tij akademike dhe shkencore bazuar në aktet ligjore në fuqi, në Statutin e USH-së dhe në të gjitha aktet e tjera të miratuara nga organet dhe autoritetet qeverisëse të USH-së. Krahas këtyre dokumenteve bazë fakultetet bazohen edhe në Rregulloren e Fakultetit. Gjithashtu, secili departament ka rregulloren e vet, të miratuara me vendim të Dekanatit. Secili program studimi ka rregulloren përkatëse, miratuar me vendim të Dekanatit. Fakultetet respektojnë autonominë e vet, bazuar në Statutin e USH-së. Në USH ekziston debati konstruktiv, duke filluar që nga njësia bazë deri tek dekanati. Në nivel departamenti vendimet merren në mbledhje të departamenteve, ku secili anëtar shpreh mendimet e tij. E njëjta frymë diskutimi është edhe në dekanat. Në grupet e vetëvlerësimit janë të pranishëm studentë, ekspertë të jashtëm, të cilët gjenerojnë ide, me qëllim përmirësimin e cilësisë.
- Departamentet hartojnë raportin mbi veprimtarinë mësimore-shkencore, ku shpalosen arritjet e departamentit. Secili anëtar i departamentit harton raportin e vet, pastaj përgjegjësi i departamentit harton raportin përfundimtar, i cili bëhet objekt diskutimi në

një mbledhje të caktuar. Raporti, së bashku me problematikat e dala në mbledhje, i përcillet Dekanit nga secili përgjegjës i departamentit.

- Në Fakultete është ngritur NjSBC-ja e Fakultetit. GVB-të përkatëse hartojnë raportet e vlerësimit të brendshëm për secilin program studimi. Këto raporte diskutohen dhe miratohen në departamentet përkatëse, më pas në dekanat. Secili departament miraton, në një mbledhje të veçantë, syllabuset e lëndëve që mbulon, duke raportuar ndryshimet e bëra dhe arsyet përkatëse.
- Departamentet angazhohen në proceset për sigurimin e brendshëm të cilësisë në Fakultete. Në departamente janë të krijuara grupet e punës për hartimin e RVB-ve të programeve të studimit dhe në përbërje të këtyre grupeve janë të përfshirë pedagogë, studentë dhe ekspertë të fushës. RVB-të e hartuara kalojnë për miratim në departamentet përkatëse dhe më pas në Dekanat. Pasi miratohen në Dekanat, përcillen në Rektorat. Edhe raporti lidhur me programin e studimit, bazuar në të dhënat e përftuara nga pyetësori me studentët e sapo diplomuar, diskutohet në dekanat dhe nxirren konkluzionet përkatëse.

***Vlerësimi i fushës: Standardet përmbushen plotësisht.***

| Standardi II.<br>**BURIMET DHE PARTNERITETI**<br>FSHN | |
|---|---|
| **BURIMET** | FSHN zhvillon një procedurë transparente lidhur me rekrutimin e personelit. Të gjitha njoftimet publikohen në faqen zyrtare të USH-së, si dhe në Buletinin e APP-së (Agjencia e Prokurimit Publik).( Evidencë 1.10).<br>https://unishk.edu.al/universiteti/dokumentet/vendime-te-senatit-akademik;<br>https://unishk.edu.al/njoftime-per-punesim/mundesi-punesimi-per-pedagoget-e-jashtem;<br>https://unishk.edu.al/punesime/mundesi-punesimi-per-pedagoget-e-brendshem; ;<br>https://unishk.edu.al/njoftime-per-punesim/mundesi-punesimi-per-staf-joakademik.<br>FSHN, ashtu si vetë institucioni, bën përpjekje për të zbatuar një politikë integruese të personelit. Ka një bashkëveprim të mirë mes stafit akademik me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme, mes departamenteve dhe fakulteteve si për realizimin e procesit mësimor, ashtu edhe për realizimin e veprimtarive të ndryshme. Po kështu, për realizimin me sukses të procesit mësimor, stafi akademik bashkëpunon me sekretarinë mësimore dhe personelin administrativ e teknik. (Evidencë 5.1.10)<br>Ka një bashkëveprim të mirë për koordinimin e punës mes dekanateve të fakulteteve të ndryshme. Në disa programe studimi zhvillojnë mësim kolegë nga fakultetet e tjera. Çdo fillim viti akademik, bazuar |

në nevojat e departamenteve, përgjegjësit hartojnë shkresat përkatëse dhe i dërgojnë tek Dekani. Dekani dërgon shkresat për nevojat për pedagogë tek fakultetet përkatëse dhe, në këtë mënyrë, studentit i sigurohet mësimdhënia e duhur, me specialistë të fushës. (Evidence 1.7)

FSHN bën përpjekje për të vlerësuar aftësitë e personelit. Politika e FSHN-së në këtë drejtim konsiston në disa pika, të tilla si:

a) marrja e feedbekut lidhur me programin e studimit nga studentët që diplomohen; b) analizimi i raporteve të vetëvlerësimit të programeve të studimit në departamentet përkatëse e, më pas, në dekanat;

c) analiza e punës mësimore-shkencore në departamente e në dekanat;

d) diskutimi dhe miratimi i syllabuseve të lëndëve në mbledhje të departamentit, etj.

Të gjitha departamentet i kushtojnë vëmendje dhe zhvillimit të veprimtarive të ndryshme me studentët. Studentët nxiten që të marrin pjesë në veprimtari ekstrakurrikulare, të marrin pjesë në veprimtari të përbashkëta të realizuara me organizata të ndryshme. Po kështu, vlen të theksohet pjesëmarrja e studentëve tanë në veprimtari të ndryshme, si dhe vullnetarizmi i shfaqur nga studentët tanë në drejtime të ndryshme, si dhurim gjaku, dhënia e ndihmës së parë, matja e presionit arterial dhe glicemisë në pika të ndryshme të qytetit, ndihma në raste fatkeqësish, konferenca studentore etj.

Të gjitha departamentet kanë në përbërjen e tyre staf të kualifikuar, me kohë të plotë, që realizon programet e studimit të ofruara prej tyre. Po kështu, edhe përzgjedhja e stafit akademik me kohë të pjesshme bëhet mbi bazën e rankimit të kandidatëve, bazuar në *Rregulloren e punësimit*. (Evidencë 2.1 Rregullore e punësimit në USH), bazuar në Rregulloren e punësimit Tashmë, tre programe studimi kane kryer procesin e akreditimit për herë të parë.

Ka përpjekje nga institucioni për të mbështetur personelin për realizimin e detyrimeve dhe për rritjen profesionale të tij.

Fakulteti disponon mjedise dhe infrastrukturën e duhur për veprimtarinë akademike-shkencore. Duhet theksuar se ka vend për përmirësim.

Në FSHN ka laboratorë cilësorë, të tillë si: Laboratori i fizioterapisë, i mikrobiologjisë të cilët ofrojnë edhe shërbim për të tretët. Po kështu është në fazë përfundimtare laboratori i analizës ushqimore

FSHN përpiqet të menaxhojë mirë asetet që ka në dispozicion, duke u kujdesuar për mirëmbajtjen e tyre dhe për ristrukturimin e tyre në rast nevoje. Ka ndërgjegjësim në rritje për përmirësimin e aksesibilitetit të studentëve me aftësi të kufizuara. (Evidencë 5.1.11).

FSHN disponon dokumentacion të plotë. Ruajtja e dokumentacionit është në nivel departamenti, në nivel dekanati dhe në sekretarinë mësimore.

Institucioni ve në përdorim sisteme të informimit dhe të menaxhimi në nivel institucional. (Evidencë 5.1.5).

U-Albania, University Albania" https://ualbania.al, është një portal që përfshin të gjitha informacionet dhe shërbimet në lidhje me universitetet në Shqipëri. Sistemi i informacionit institucional menaxhohet përmes Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), i cili i ofron Universitetit një hapësirë të dhënash për mësimdhënie, mësim, hulumtim, menaxhimin e burimeve njerëzore, financiare dhe administrative.

| | |
|---|---|
| | SMAK https://smak.unishk.edu.al/home, është një program aplikimi akademik për rezultatet e nevojshme për menaxhimin akademik. Programi mësimor i programeve të studimit mund të gjendet, gjithashtu, në këtë portal, por programet mësimore nuk janë të dukshme. IAL ka një webpage www.unishk.edu.al, ku publikohen statistika periodike për programet e studimit, veprimtaritë e Universitetit dhe njësive akademike.<br>Brenda USH-së, ekziston Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë e cila kujdeset për fushat e teknologjisë së informacionit, në këtë mënyrë duke pasqyruar veprimet e njësive akademike dhe departamenteve të tyre me orare mësimore, orare të provimeve, njoftime për aktivitete akademike dhe vendime të ndryshme të Universitetit.<br>USH-ja punon për informatizimin në çdo hap të punës student - sekretari mësimore- staf akademik. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë në USH bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit, duke pasqyruar përmes tyre oraret e mësimit, datat e provimeve, strukturën organizative, organigramën, detyrimet e studentit, tarifat e studimit, vlerësimet e studentëve, veprimtarinë akademike dhe sociale të USH-së. (www.unishk.edu.al).<br>Universiteti në hartimin e buxhetit bazohet në kërkesat e sjella nga fakultetet. Dekanatet i bazojnë kërkesat e tyre në nevojat e departamenteve, të cilat specifikohen në një mbledhje të veçantë. Më pas bëhet miratimi në Senatin akademik.<br>Fakulteti i nënshtrohet auditit financiar të brendshëm dhe të jashtëm dhe rezultatet, në të dy rastet, u prezantohen organeve kolegjiale në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar). |
| **PARTNERITETI** | Institucioni ka të parashikuar në strategjinë e tij politikën e bashkëpunimit. USH ka një sërë lidhjesh me Universitete të huaja të shprehura në marrëveshje bashkëpunimi. (Evidencë 4.11.2)<br>Departamentet e vlerësojnë shumë bashkëpunimin me institucionet e tjera. Ka një sërë marrëveshjesh të natyrave të ndryshme, si: bashkëpunim si partner në projekte të ndryshme, bashkëpunim për realizimin e praktikave mësimore, etj.,<br>Mobiliteti i stafit në FSHN realizohet përmes pjesëmarrjes në veprimtari të ndryshme shkencore, si: konferenca, mësimdhënie, pjesëmarrje në projekte të ndryshme, etj. Zyra e marrëdhënieve me jashtë publikon informacione të vazhdueshme në faqen e USH-së në lidhje me veprimtaritë ndërkombëtare, duke përfshirë mundësitë për mobilitetin e stafit dhe studentëve.<br>Ka përpjekje në FSHN për të bërë studimin e tregut të punës ne departamente si dhe përpjekje për të kryer monitorimin e punësimit të të diplomuarve ndër vite, megjithatë duhet që institucioni të angazhohet më shumë për realizimin e një studimi të mirëfilltë të tregut. |

| Standardi II.<br>BURIMET DHE PARTNERITETI<br>FSHE | |
|---|---|
| Burimet | FSHE, ashtu si vetë institucioni, bën përpjekje për të zbatuar një politikë integruese të personelit. Ka një bashkëveprim të mirë mes stafit akademik me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme, mes departamenteve dhe fakulteteve si për realizimin e procesit mësimor, ashtu edhe për realizimin e veprimtarive të ndryshme. Po kështu, për realizimin me sukses të procesit mësimor, stafi akademik bashkëpunon me sekretarinë mësimore dhe me personelin administrativ.<br>Të gjitha departamentet kanë në përbërjen e tyre staf të kualifikuar, me kohë të plotë, që realizon programet e studimit të ofruara prej tyre. Po kështu, edhe përzgjedhja e stafit akademik me kohë të pjesshme bëhet mbi bazën e rankimit të kandidatëve, bazuar në Rregulloren e punësimit. Tashmë, disa programe studimi janë në procesin e akreditimit për herë të parë.<br>Fakulteti disponon mjedise dhe infrastrukturën e duhur për veprimtarinë akademike-shkencore.<br>Në FSHE ka laboratorë cilësorë, të tillë si: Laboratori i Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar, (krijuar me vendim të Senatit Akademik të USH nr. 264, datë 15.07.2019), laboratori në kuadër të projektitT@ask.<br>FSHE përpiqet të menaxhojë mirë asetet që ka në dispozicion, duke u kujdesuar për mirëmbajtjen e tyre dhe për ristrukturimin e tyre në rast nevoje. Ka ndërgjegjësim në rritje për përmirësimin e aksesibilitetit të studentëve me aftësi të kufizuara. Vitet e fundit është realizuar një rampë për PAK e cila është vendosur në katin e parë të godinës.<br>FSHE disponon dokumentacion të plotë. Ruajtja e dokumentacionit është në nivel departamenti, në nivel dekanati dhe në sekretarinë mësimore.<br>Institucioni ve në përdorim sisteme të informimit dhe të menaxhimi në nivel institucional.<br>U-Albania, University Albania" https://ualbania.al, është një portal që përfshin të gjitha informacionet dhe shërbimet në lidhje me universitetet në Shqipëri. Sistemi i informacionit institucional menaxhohet përmes Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), i cili i ofron Universitetit një hapësirë të dhënash për mësimdhënie, mësim, hulumtim, menaxhimin e burimeve njerëzore,<br>financiare dhe administrative. SMAK https://smak.unishk.edu.al/home, është një program aplikimi akademik për rezultatet e nevojshme për menaxhimin akademik. IAL ka një webpage www.unishk.edu.al, ku publikohen statistika periodike për programet e studimit, veprimtaritë e Universitetit dhe njësive akademike, përkatësisht departamenteve të tyre, publikimin e dokumenteve të USH-së, si: Statuti i Universitetit, rregulloret funksionale dhe të tjera.<br>USH-ja punon për informatizimin në çdo hap të punës student - sekretari mësimore- staf akademik. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë në USH bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit, duke pasqyruar përmes tyre oraret e mësimit, datat e provimeve, strukturën organizative, organigramën, detyrimet e studentit, tarifat e studimit, vlerësimet e studentëve, veprimtarinë akademike dhe sociale të USH-së (www.unishk.edu.al). |

| | |
|---|---|
| | Universiteti në hartimin e buxhetit bazohet në kërkesat e sjella nga fakultetet. Dekanatet i bazojnë kërkesat e tyre në nevojat e departamenteve, të cilat specifikohen në një mbledhje të veçantë. Më pas bëhet miratimi në Senatin akademik.<br>Fakulteti i nënshtrohet auditit financiar të brendshëm dhe të jashtëm dhe rezultatet, në të dy rastet, u prezantohen organeve kolegjiale në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar). |
| Partneriteti | Institucioni ka të parashikuar në strategjinë e tij politikën e bashkëpunimit. USH ka një sërë lidhjesh me Universitete të huaja të shprehura në marrëveshje bashkëpunimi. Edhe FSHE e ka një objektiv të tillë.<br>Departamentet e vlerësojnë shumë bashkëpunimin me institucionet e tjera. Ka një sërë marrëveshjesh të natyrave të ndryshme, si: bashkëpunim si partner në projekte të ndryshme, bashkëpunim për realizimin e praktikave mësimore, etj., si p.sh., me DAR Lezhë, ZVA Shkodër, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Prokurorinë e Rrethit Shkodër, Spitalin Rajonal të Shkodrës, OJQ, etj.). Mobiliteti i stafit në FSHE realizohet përmes pjesëmarrjes në veprimtari të ndryshme shkencore, si: konferenca, mësimdhënie, pjesëmarrje në projekte të ndryshme, etj. Pedagogë nga FSHE japin mësim pranë Universitetit të Malit të Zi, Fakulteti i Filozofisë, në programin studimor për Arsimimin e Mësuesve në Gjuhën Shqipe. Zyra e marrëdhënieve me jashtë publikon informacione të vazhdueshme në faqen e USH-së në lidhje me veprimtaritë ndërkombëtare, duke përfshirë mundësitë për mobilitetin e stafit dhe studentëve. |

| Standardi II.<br>**BURIMET DHE PARTNERITETI**<br>FE | |
|---|---|
| **BURIMET** | USH-ja ndjek një politikë të qartë dhe të mirë strukturuar për rekrutimin e pedagogëve në përputhje me rregulloren. Vendet vakante njoftohen tek Buletini i njoftimeve publike pranë Agjencisë së Prokurorimit publik dhe në websit-in e USH-së.<br>Në përputhje me statutin e USH-së dhe rregulloren e Njësisë Kryesore, në lidhje me aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe partner të angazhuar, informacioni menaxhohet sipas strukturave përgjegjëse të institucionit. Ky informacion ruhet në formë hardcopy dhe elektronike në disa njësi të universitetit. Në përputhje me rregulloren e FE, ky informacion dokumentohet përmes Cv, planeve mësimore, syllabuseve, ngarkesës akademike, ngarkesës për kontributin institucional, ngarkesës intelektuale. Këto dokumente ruhen në departament dhe bëhen pjesë integrale e analizës mësimore dhe shkencore të departamentit, e cila bëhet çdo vit dhe përcillet në Fakultet dhe Rektorat.<br>Sistemi i menaxhimit të informacionit krijon akses për personelin akademik, ndihmës akademik dhe studentët përmes formave të ndryshme. Informacionin në lidhje me aktivitetet e njësisë kryesore/bazë bëhet publik përmes faqes zyrtare të universitetit, faqes zyrtare në rrjete sociale te fakultetit, lajmërimeve brenda ambienteve të fakultetit, fletëpalosjeve, etj. Kjo procedurë siguron informacion për publikun. Një vend të rëndësishëm zë edhe shpërndarja e informacionit që lidhet me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ky |

| | |
|---|---|
| | informacion dokumentohet përmes raportimeve që bëhen në dekanat dhe web-in e Universitetit me seksion të veçantë për fakultetin, departamentin apo edhe programin e studimit. Ky informacion lidhet me strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, kurrikulën e programit, mundësitë e punësimit, kompetencat e stafit dhe studentëve<br>Shpërndarja e burimeve financiare të USH-së bëhet në përputhje me strategjinë afatmesme të buxhetit të përgjithshëm. Struktura e hartimit të buxhetit të USH-së bëhet sipas strukturës së Buxhetit të Shtetit.<br>Urdhri Prot., 1359, dt. 19.04.2021 për miratimin e programit të transparencës:<br>https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2020-2021/programi_i_transparencës/Urdher_1359_Prot_dt_19.04.2021<br>Shih edhe rubrikën për buxhetin: https://unishk.edu.al/universiteti/buxheti; për Bordin e Administrimit dhe: Vendimet: https://unishk.edu.al/universiteti/dokumentet/vendime-te-bordit-te-administrimit.<br>Për Senatin dhe vendimet e tij: https://unishk.edu.al/universiteti/dokumentet/vendime-te-senatit-akademik<br>Ndërkohë, mungon autonomia financiare e fakultetit e cila do të lehtësonte vendimmarrjen në fakultet lidhur me zgjerimin e programeve aktuale të studimit, krijimin e programeve të reja, sigurimin e shërbimeve të tretëve dhe realizimin e disa prej planeve e iniciativave që po diskutohen nga stafi i tij, si krijimi i Qendrës së Asistencës së Biznesit, vënia në funksionim e qendrës së USIA-s në kuadrin e projektit me të njëjtin emër, etj. Qendra e Asistencës për Biznesin vjen si një traditë e hershme e FE-së, që në kohën e zbatimit të projektit të Departamentit Amerikan të Shtetit me SIUC), (Evidence 2.13 Lista e marrëveshjeve të USH), që mund të ofrojë shërbime për bizneset, por në të njëjtën kohë mund të analizojë nevojat e tregut të punës që ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme për t'ia përshtatur kështu ofertën akademike të FE-së. (Evidencë 2.17, Studimi i tregut të punës. Evidencë 2.18 Shkresa për Panairin e Punës FE. Po kështu Zyra e Ekselencës (Evidence 2.10 Aktivitete zyra e Ekselencës FE), duhet të fuqizohet financiarisht për të ofruar trajnime cilësore të stafeve akademike në drejtim të metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies si dhe metodat e avancuara të kërkimit shkencor. Në prioritet e FE është edhe Zyra e Këshillimit të Karrierës, duke ofruar shërbime për studentet duke i mundësuar punësimin dhe promovimin e tyre. |
| **PARTNERITETI** | Hapa pozitivë të mëtejshëm janë bërë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së pedagogut, përmes trajnimeve dhe mësimdhënies në vendet e Evropës Perëndimore. Në kuadrin e projekteve ndërkombëtare FE ndjek një politikë mjaft aktive të mbështetjes së stafeve akademike, të personelit administrativ dhe ndihmës mësimor-shkencor me mobilitete nga ku ata kanë mundësi të përfitojnë kualifikime dhe eksperienca ndërkombëtare. (Evidence 2.16 Shkresa për mobilitetet e stafit e studentëve FE).<br>Në kuadrin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin e SIUC (Southern Illinois University at Carbondale), SCC (Sandhills Community College), Universitetin e Bolonjes, Universitetin e Varshaves, Universitetin e Eberswaldit janë realizuar disa botime dhe punime kërkimore të stafit të FE me stafet përkatëse te këtyre Universiteteve Perëndimore.<br>Evidence 2.5 Trajnim i stafit akademik FE<br>Evidence 2.6 Artikull shkencor me bashkautorë të huaj partner FE |

| Standardi II.<br>**BURIMET DHE PARTNERITETI**<br>**FD** | |
|---|---|
| **BURIMET** | Fakulteti i Drejtësisë ka krijuar kushte dhe mjedise të përshtatshme si dhe mundësi të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Kualifikimi profesional i personelit akademik të angazhuar në programet e studimit të ofruara nga FD është përgjithësisht nxitje individuale për ngritje profesionale nga vetë anëtarët e stafit; megjithatë së fundmi është rritur mbështetja e USH (edhe ajo financiare) për zhvillimin profesional dhe kualifikimin e stafit akademik.. Personeli akademik është kryesisht, në pjesën më të madhe të tij, i punësuar me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar, të cilët kanë së paku gradën shkencore "Doktor". Kjo siguron qëndrueshmëri afatgjatë të personelit akademik ndër vite. Fakulteti i Drejtësisë krijon, për të gjithë personelin e vet, kushte, mundësi dhe shanse të barabarta për zhvillimin e personalitetit, karrierës profesionale, si dhe të kushteve të punës. Personeli akademik gëzon status dhe trajtim të veçantë, në përputhje me VKM nr. 329, datë 12. 4. 2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik" (Evidencë 2.2).<br>Fakulteti i Drejtësisë kryen studime mbi tregun lokal e rajonal të punës për programin e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve në mënyrë periodike, bazuar në anketime të thjeshta, por edhe duke përdorur platformat dixhitale për realizimin e pyetësorëve.<br>Fakulteti i Drejtësisë siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse. Studentët kanë mundësi dhe akses për shfrytëzimin e sallave të leximit, përdorimin e pajisjeve kompjuterike dhe aksesin në internet në godinën e bibliotekës së USH. Me qëllim menaxhimin akademik përdoret sistemi SMAK, https://smak.unishk.edu.al/home, i cili është një program aplikimi akademik ku rezultojnë të regjistruara aktivitetet akademike të çdo pedagogu dhe administrohet nga përgjegjësi i departamentit.<br>Fakulteti i Drejtësisë disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. U-Albania, University Albania" https://ualbania.al, është një portal që përfshin të gjitha informacionet dhe shërbimet në lidhje me universitetet në Shqipëri. Sistemi i informacionit institucional menaxhohet përmes Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), Fakulteti i Drejtësisë disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.<br>Sistemi i menaxhimit Pitagora siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. |
| **PARTNERITETI** | Fakulteti i Drejtësisë është i përfshirë në programet ERASMUS + si dhe në programe të tjera të shkëmbimit të studentëve dhe si rrjedhojë ofron, kur kërkohet një gjë e tillë, module të lëndëve të veçanta në gjuhë të huaj (angleze apo italiane) (Evidencë 2.4 dhe Evidencë 2.5). |

| Standardi II.<br>**BURIMET DHE PARTNERITETI**<br>**FGJH** | |
|---|---|
| **BURIMET** | FGJH zhvillon një procedurë transparente lidhur me rekrutimin e personelit, bazuar në Rregulloren e punësimit. Të gjitha njoftimet publikohen në faqen zyrtare të USH-së.<br>Ka një bashkëveprim të mirë për koordinimin e punës mes dekanateve të fakulteteve të ndryshme.<br>FGJH përcakton përparësitë kryesisht lidhur me rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor dhe realizon vlerësimin e aftësive të personelit të tij duke ballafaquar rezultatet me strategjitë e përcaktuara. Departamentet kanë në përbërjen e tyre staf të kualifikuar, me kohë të plotë, që realizon programet e studimit të ofruara prej tyre.<br>Fakulteti disponon mjedise dhe infrastrukturën e duhur për veprimtarinë akademike-shkencore. Megjithatë ka ende vend për përmirësim.<br>FGJH disponon dokumentacion të plotë, i cili ruhet në departamenti, në nivel dekanati dhe në sekretarinë mësimore.<br>USH-ja punon për informatizimin në çdo hap të punës student - sekretari mësimore- staf akademik. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë në USH bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit, duke pasqyruar përmes tyre oraret e mësimit, datat e provimeve, strukturën organizative, organigramen, detyrimet e studentit, tarifat e studimit, vlerësimet e studentëve, veprimtarinë akademike dhe sociale të USH-së.<br>Universiteti në hartimin e buxhetit bazohet në kërkesat e sjella nga fakultetet. Dekanatet i bazojnë kërkesat e tyre në nevojat e departamenteve, të cilat specifikohen në një mbledhje të veçantë. Më pas bëhet miratimi në Senatin akademik.<br>Fakulteti i nënshtrohet auditit financiar të brendshëm dhe të jashtëm dhe rezultatet, në të dy rastet, u prezantohen organeve kolegjiale në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar). |
| **PARTNERITETI** | Në kuadër të strategjisë për bashkëpunim në nivel rajonal dhe kombëtar, një ndër prioritetet e FGJH-së është ndërkombëtarizimi. Gjatë kësaj periudhe është intensifikuar mobiliteti i stafit akademik dhe i studentëve, si rezultat i nënshkrimit të marrëveshjeve të ndryshme mes Universitetit të Shkodrës dhe universiteteve të tjera në rajon dhe më gjerë. |

| | |
|---|---|
| | FGJH përpiqet për një politikë të integrimit të personelit akademik të ftuar si dhe të studiuesve të huaj, në përgjigje të kërkesave dhe nevojave bashkëkohore si të fakultetit ashtu edhe të stafit akademik.<br>Ka një sërë marrëveshjesh të natyrave të ndryshme, si: bashkëpunim si partner në projekte të ndryshme, bashkëpunim për realizimin e praktikave mësimore, etj., si p.sh., me DAR Lezhë, ZVA Shkodër, etj.<br>FGJH ndjek politika të jashtme për mobilitetin e stafit dhe të studentëve. Me koordinimin e Zyrës së marrëdhënieve me jashtë, FGJH ka qenë në lidhje të vazhdueshme me institucione homologe në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, falë një sërë marrëveshjesh formale të lidhura nga USH, që iu ofrojnë stafit dhe studentëve mundësinë për të marrë pjesë në veprimtari ndërkombëtare. Në kuadrin e bashkëpunimit me universitetet e tjera, pedagogët e fakultetit kanë marrë pjesë në veprimtari të organizuara brenda dhe jashtë vendit (konferenca shkencore, kongrese, simpoziume, tryeza diskutimesh), sikundër edhe kanë mirëpritur kolegë të tyre nga universitetet e tjera brenda dhe jashtë vendit.<br>FGJH përpiqet të monitorojë punësimin e të diplomuarve të tij ndër vite, zakonisht një vit pas diplomimit, mundësuar me ndihmën e Zyrës së këshillimit të karrierës dhe Alumnit. |

| Standardi II.<br>**BURIMET DHE PARTNERITETI**<br>**FSHSH** | |
|---|---|
| **BURIMET DHE PARTNERITETI** | FSHSH ndjek një politikë transparente dhe rigoroze të punësimit, bazuar në Rregulloren e Universitetit "Për zënien dhe ruajtjen e vendit të punës".<br>FSHSH bën përpjekje për të zbatuar një politikë integruese të personelit. Ka një bashkëveprim të mirë mes stafit akademik me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme, mes departamenteve dhe fakultetit si për realizimin e procesit mësimor, ashtu edhe për realizimin e veprimtarive të ndryshme, si p.sh., konferenca, aktivitete të ndryshme, etj. Për realizimin me sukses të procesit mësimor, stafi akademik bashkëpunon me sekretaritë dhe personelin administrativ. Ka një bashkëveprim të mirë për koordinimin e punës edhe mes dekanateve të fakulteteve të ndryshme. FSHSH bën përpjekje për të vlerësuar aftësitë e personelit. Studentët nxiten që të marrin pjesë në veprimtari ekstra-kurrikulare. FSHSH ka një sistem të mirë informimi. FSHSH zhvillon mësimin në godinën përkatëse, disponon laborator dhe përpiqet të menaxhojë mirë asetet që ka në dispozicion. FSHSH disponon dokumentacion të plotë. Ruajtja e dokumentacionit është në nivel departamenti, dekanati dhe në sekretarinë mësimore. FSHSH ndjek një strategji të hapur bashkëpunimi dhe partneriteti në nivel vendor, nivel kombëtar dhe nivel ndërkombëtar. Duhet punuar për të përmirësuar instrumentet për matjen e performancës së pedagogut. Mund të punohet më shumë për infrastrukturën, mjediset e argëtimit. |

**Përfundime mbi standardin**

- Të gjitha departamentet kanë në përbërjen e tyre staf të kualifikuar, me kohë të plotë, që realizon programet e studimit të ofruara prej tyre. Po kështu, edhe përzgjedhja e stafit akademik me kohë të pjesshme bëhet mbi bazën e rankimit të kandidatëve, bazuar në *Rregulloren e punësimit*. Fakulteti disponon mjedise dhe infrastrukturën e duhur për veprimtarinë akademike-shkencore, në masën më të madhe, duhet theksuar se ka vend për përmirësim.
- USH përpiqet të menaxhojë mirë asetet që ka në dispozicion, duke u kujdesuar për mirëmbajtjen e tyre dhe për ristrukturimin e tyre në rast nevoje. Ka ndërgjegjësim në rritje për përmirësimin e dhe përfshirjen e studentëve me aftësi të kufizuara. USH disponon dokumentacion të plotë. Ruajtja e dokumentacionit është në nivel departamenti, në nivel dekanati dhe në sekretarinë mësimore, Zyra Protokoll-arkiva. Institucioni ve në përdorim sisteme të informimit dhe të menaxhimi në nivel institucional.U-Albania, University Albania" https://ualbania.al, është një portal që përfshin të gjitha informacionet dhe shërbimet në lidhje me universitetet në Shqipëri. Sistemi i informacionit institucional menaxhohet përmes Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), i cili i ofron Universitetit një hapësirë të dhënash për mësimdhënie, mësim, hulumtim, menaxhimin e burimeve njerëzore, financiare dhe administrative. SMAK https://smak.unishk.edu.al/home, është një program aplikimi akademik për rezultatet e nevojshme për menaxhimin akademik. Programi mësimor i programeve të studimit mund të gjendet, gjithashtu, në këtë portal, por programet mësimore nuk janë të dukshme. IAL ka një webpage www.unishk.edu.al, ku publikohen statistika periodike për programet e studimit, veprimtaritë e Universitetit dhe njësive akademike, përkatësisht departamenteve të tyre, publikimin e dokumenteve të USH-së, si: Statuti i Universitetit, rregulloret funksionale dhe të tjera. Brenda USH-së, ekziston Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë e cila kujdeset për fushat e teknologjisë së informacionit, në këtë mënyrë duke pasqyruar veprimet e njësive akademike dhe departamenteve të tyre me orare mësimore, orare të provimeve, njoftime për aktivitete akademike dhe vendime të ndryshme të Universitetit.
- USH-ja punon për informatizimin në çdo hap të punës student - sekretari mësimore- staf akademik. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë në USH bashkërendon

veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit, duke pasqyruar përmes tyre oraret e mësimit, datat e provimeve, strukturën organizative, organigramen, detyrimet e studentit, tarifat e studimit, vlerësimet e studentëve, veprimtarinë akademike dhe sociale të USH-së. (www.unishk.edu.al). Universiteti në hartimin e buxhetit bazohet në kërkesat e sjella nga fakultetet. Dekanatet i bazojnë kërkesat e tyre në nevojat e departamenteve, të cilat specifikohen në një mbledhje të veçantë. Më pas bëhet miratimi në Senatin akademik.

- Fakulteti i nënshtrohet auditit financiar të brendshëm dhe të jashtëm dhe rezultatet, në të dy rastet, u prezantohen organeve kolegjiale në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar).Institucioni ka të parashikuar në strategjinë e tij politikën e bashkëpunimit.
- USH ka një sërë lidhjesh me Universitete të huaja të shprehura në marrëveshje bashkëpunimi. Departamentet e vlerësojnë shumë bashkëpunimin me institucionet e tjera. Ka një sërë marrëveshjesh të natyrave të ndryshme, si: bashkëpunim si partner në projekte të ndryshme, bashkëpunim për realizimin e praktikave mësimore. Mobiliteti i stafit në USH realizohet përmes pjesëmarrjes në veprimtari të ndryshme shkencore, si: konferenca, mësimdhënie, pjesëmarrje në projekte të ndryshme, etj.
- Zyra e marrëdhënieve me jashtë publikon informacione të vazhdueshme në faqen e USH-së në lidhje me veprimtaritë ndërkombëtare, duke përfshirë mundësitë për mobilitetin e stafit dhe studentëve. Ka përpjekje në USH për të bërë studimin e tregut të punës si dhe përpjekje për të kryer monitorimin e punësimit të të diplomuarve ndër vite, megjithatë duhet që institucioni të angazhohet më shumë për realizimin e një studimi të mirëfilltë të tregut.

***Vlerësimi i fushës: Standardet përmbushen kryesisht.***

Standardi III.

## PROGRAMET E STUDIMIT, MËSIMDHËNIA DHE VLERËSIMI

| | FSHN |
|---|---|
| **PROGRAMET E STUDIMIT** | Programet e studimit janë në përputhje me kapacitetet e fakultetit, si ato akademike, ashtu edhe kapacitete infrastrukturore. (https://unishk.edu.al/studimi-ne-unishk/cikli-i-pare-i-studimeve-bachelor/2)<br>Veprimtaritë që kryen personeli akademik në IAL janë: a) mësimdhënie; b) kërkimi shkencor; c) kontribut institucional; d) kontribut profesional.<br>FSHN krijon të gjitha lehtësirat për përfundimin e studimeve në kushte të mira brenda kritereve akademike dhe infrastrukturore dhe fillimin e një cikli të ri studimesh. Në veprimtaritë e programeve të studimit (formimi i përgjithshëm, formimi karakterizues, veprimtari në disiplina të ngjashme ose dhe integruese, disiplina me zgjedhje, njohuritë tjera formuese dhe teza e diplomës) përfshihen lëndë, që bazohen në syllabuset bashkëkohore. Syllabuset janë, gjithashtu, të bazuara në literatura të huaja dhe të viteve të fundit. Programet e studimit janë të hartuara në mënyrë të atillë që lejojnë mundësinë e transferimit në programe të tjera homologe, bazuar në kreditet e fituara. Burimi i informacionit merret përmes rregullores përkatëse të studimeve.<br>Programet Bachelor u japin mundësi studentëve që të ndjekin studimet në programet e cikleve pasardhëse falë njohurive solide që u ofrojnë studentëve. (Evidencë 3.3- Model syllabusi)<br>Programet e studimeve "Master i Shkencave" hartohen në mbështetje të politikave kërkimore të Universitetit dhe në përputhje me strategjitë e këtij institucioni, të cilat janë sanksionuar si tek Statuti i USH-së 2011, ashtu dhe tek Strategjia e USH-së.<br>Në FSHN ka laboratorë cilësorë, të tillë si: qendra e diagnostikimit mikrobiologjik, qendra e fizioterapisë që ofrojnë shërbim edhe për të tretët. Është në përfundim laboratori i analizës ushqimore, si dhe është miratuar dhe ka filluar punimet për laboratorin klinik biokimik.<br>Biblioteka e USH-së ofron literaturë të pasur në shkencat natyrore dhe ato teknike mjekësore. Burim mjaft i rëndësishëm për shfrytëzimin e literaturës së huaj është edhe biblioteka digjitale, U -libary. |
| **MËSIMDHËNIA** | Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt. 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", programet e studimeve përmirësohen, bëhen ndryshime në emërtimin e lëndëve, në numrin e pikë krediteve, në mënyrë që studentëve t'u ofrohet një kurrikul bashkëkohore.<br>FSHN ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Një objektiv të tillë departamentet e realizojnë përmes:<br>-diskutimit dhe miratimit të ndryshimeve për programet e studimit; (Evidencë 3.5).<br>-marrjes në konsideratë të mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve që diplomohen; (Evidencë 1.18).<br>-organizimit çdo vit të mbledhjes "Analiza e punës mësimore dhe shkencore";(Evidencë 3.3).<br>-organizimit çdo vit të mbledhjes me tematikë "Miratimin e syllabuseve";<br>-diskutimin dhe miratimin çdo vit të RVB-ve për secilin program studimi.<br>Edhe Dekanati e ndjek këtë proces. Në dekanat analizohet puna mësimore-shkencore e Fakultetit, miratohen ndryshimet që departamentet sjellin për programet e studimit, miratohen RVB-të e programeve të studimit. FSHN ka krijuar dhe janë funksionale mekanizmat që e monitorojnë cilësinë, siç janë GVB-të e programeve të studimit dhe NjSBC-ja e Fakultetit. |

| | |
|---|---|
| | Lëndët dhe modulet e programeve të studimit realizohen nëpërmjet orëve të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve. Diskutimet dhe projektet e kursit i ndihmojnë studentët që ta ruajnë informacionin e fituar edhe pas mbarimit të kursit. Stafi bën përpjekje për integrimin e elementëve praktikë në realizimin e syllabuseve të lëndëve edhe përmes bashkëpunimit me institucione vendore dhe OJF-ve, duke krijuar mundësinë që ekspertë të fushave përkatëse të sjellin praktikat dhe ekspertizën e tyre për studentët. Disa programe studimi zhvillojnë praktika profesionale dhe ekspedita në terren.<br>Programet e studimit përmbajnë objektiva të qarta dhe përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programeve të studimit. Programet e studimit kanë në përmbajtjen e tyre informacion të mjaftueshëm dhe koherent për studentët. Ato përditësohen me prurjet më të reja të literaturës bashkëkohore. Pedagogët kanë të parashikuara në syllabuset e tyre edhe projekte kursi për vlerësimin e studentëve, zhvillimi i të cilave u mundëson përvetësimin më të mirë të lëndës dhe zhvillimin e shprehive të punës së pavarur. (Evidencë 3.5 -Ndryshime në programin e studimit).<br>Diplomat që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe përmban informacion të detajuar. (Evidencë 3.6-Model diplome dhe suplementi). |
| **VLERËSIMI** | Programet dhe planet mësimore janë objekt vlerësimesh, diskutimesh e përmirësimesh të vazhdueshme me qëllimin për të lehtësuar mobilitetet e studentëve dhe njohjen e programeve dhe diplomave nga institucionet arsimore të huaja.<br>Edhe studentët e FSHN-së përfshihen në vlerësimin e programeve të studimeve.<br>Studentët që përfundojnë një program studimi të nivelit Bachelor zhvillojnë dy gjuhë të huaja, përkatësisht: në vitin e parë gjuhën angleze, në vitin e dytë/tretë zhvillojnë njërën nga gjuhët e huaja: frëngjisht, italisht, gjermanisht, turqisht, në formën e lëndës me zgjedhje. Studentët e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë kanë kriter pranimi edhe njohjen e dokumentuar të një nga pesë gjuhët e huaja: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht.<br>Pasi kanë kryer të gjitha detyrimet, studentët kanë të drejtën e diplomimit, provim me shkrim apo punim teme, bazuar në rregulloren e studimeve.<br>Pas marrjes së vlerësimit pozitiv, studentët pajisen me diplomën përkatëse, e shoqëruar me suplementin. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe ka informacion të hollësishëm rreth programit të studimit dhe vlerësimit të studentit. |

## Standardi III.
## PROGRAMET E STUDIMIT, MËSIMDHËNIA DHE VLERËSIMI
FSHE

| | |
|---|---|
| PROGRAMET E STUDIMIT | Programet e studimit në FSHE janë në përputhje me bazën ligjore dhe objektivat kombëtarë e ndërkombëtarë. Programet e studimit janë të përafërta me programe të ngjashme në IAL-të e tjera vend bazuar në Ligjin nr.80/2015 datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë''. Ato janë hartuar duke marrë parasysh edhe kurrikulat e programeve të ngjashme të huaja. Në këtë mënyrë, studentët tanë kanë mundësi studimi të mëtejshëm në universitete të tjera brenda vendit apo jashtë tij. Ata, gjithashtu, kanë mundësi punësimi jashtë vendit.<br>Veprimtaritë që kryen personeli akademik në IAL janë: a) mësimdhënie; b) kërkimi shkencor; c) kontribut institucional; d) kontribut profesional. Në fakultet ka pasur vazhdimisht rekrutime të stafit akademik me kohë të plotë. Ka edhe staf akademik me kohë të pjesshme, në varësi edhe të specialiteteve që mbulojnë, me qëllim që studentëve t'u ofrohet cilësi sa më e mirë në mësimdhënie.<br>Programet Bachelor u japin mundësi studentëve që të ndjekin studimet në programet e cikleve pasardhëse falë njohurive solide që u ofrojnë studentëve. FSHE krijon të gjitha lehtësirat për përfundimin e studimeve në kushte të mira brenda kritereve akademike dhe infrastrukturore dhe fillimin e një cikli të ri studimesh. Veprimtaritë (disiplina të formimit të përgjithshëm, disiplina të formimit karakterizues, disiplina të ngjashme ose dhe integruese, me zgjedhje, njohuritë tjera formuese dhe teza e diplomës) përfshijnë lëndë, që bazohen në syllabuset bashkëkohore, të ngjashme me ato të universiteteve të huaja. Syllabuset janë, gjithashtu, të bazuara në literatura të huaja dhe të viteve të fundit. Programet e studimit janë të hartuara në mënyrë të atillë që lejojnë mundësinë e transferimit në programe të tjera homologe, bazuar në kreditet e fituara. Burimi i informacionit merret përmes rregullores përkatëse të studimeve.<br>Programet e studimeve "Master i Shkencave" hartohen në mbështetje të politikave kërkimore të Universitetit dhe në përputhje me strategjitë e këtij institucioni, të cilat janë sanksionuar si tek Statuti i USH-së 2011, ashtu dhe tek Strategjia e USH-së. |
| MËSIMDHËNIA | Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt. 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", programet e studimeve përmirësohen, bëhen ndryshime në emërtimin e lëndëve, në numrin e pikë krediteve, në mënyrë që studentëve t'u ofrohet një kurrikul bashkëkohore.<br>FSHE ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Një objektiv të tillë departamentet e realizojnë përmes:<br>-diskutimit dhe miratimit të ndryshimeve për programet e studimit;<br>-marrjes në konsideratë të mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve që diplomohen;<br>-organizimit çdo vit të mbledhjes "Analiza e punës mësimore dhe shkencore";<br>-organizimit çdo vit të mbledhjes me tematikë "Miratimin e syllabuseve'';<br>-diskutimin dhe miratimin çdo vit të RVB-ve për secilin program studimi.<br>Edhe Dekanati e ndjek këtë proces. Në dekanat analizohet puna mësimore-shkencore e Fakultetit, miratohen ndryshimet që departamentet sjellin për programet e studimit, miratohen RVB-të e programeve të studimit. FSHE ka krijuar dhe janë funksionale mekanizmat që e monitorojnë cilësinë, siç janë GVB-të e programeve të studimit dhe NjSBC-ja e Fakultetit. |

| | |
|---|---|
| | Lëndët dhe modulet e programeve të studimit realizohen nëpërmjet orëve të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve. Diskutimet dhe projektet e kursit i ndihmojnë studentët që ta ruajnë informacionin e fituar edhe pas mbarimit të kursit. Stafi bën përpjekje për integrimin e elementëve praktikë në realizimin e syllabuseve të lëndëve edhe përmes bashkëpunimit me institucione vendore dhe OJF-ve, duke krijuar mundësinë që ekspertë të fushave përkatëse të sjellin praktikat dhe ekspertizën e tyre për studentët.<br>Programet e studimit përmbajnë objektiva të qarta dhe përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programeve të studimit. Programet e studimit kanë në përmbajtjen e tyre informacion të mjaftueshëm dhe koherent për studentët. Ato përditësohen me prurjet më të reja të literaturës bashkëkohore. Pedagogët kanë të parashikuara në syllabuset e tyre edhe projekte kursi për vlerësimin e studentëve, zhvillimi i të cilave u mundëson përvetësimin më të mirë të lëndës dhe zhvillimin e shprehive të punës së pavarur.<br>Në FSHE ka laboratorë cilësorë, të tillë si: Laboratori i Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar, (krijuar me vendim të Senatit Akademik të USH nr. 264, datë 15.07.2019), laboratori në kuadër të projektitT@ask.<br>Programet e studimit, në përgjithësi, kanë të parashikuara edhe praktika profesionale. Praktikat profesionale realizohen në kuadër të marrëveshjeve institucionale me institucione vendore publike si dhe përmes bashkëpunimit me sektorin privat. Institucionet vendore shtetërore me të cilat bashkëpunohet janë: Bashkia Shkodër, DAR, Shërbimi i Provës, Zyra vendore Shkodër, Spitali Rajonal Shkodër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Drejtoria Rajonale e SH.S.SH-së Shkodër, OJF "THE DOOR", Fototeka "Marubi", Muzeu Historik Shkodër, organizata të shoqërisë civile, jofitimprurëse dhe me institucione të tjera të sektorit privat dhe shtetëror që operojnë në zonën e Veriut.<br>Diplomat që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe përmban informacion të detajuar.<br>Biblioteka e USH-së ofron literaturë të pasur në shkencat psiko-sociale. Tashmë Biblioteka është pasuruar më tej me libra të fushës psiko-sociale në kuadrin e projektit T@ask.<br>Burim mjaft i rëndësishëm për shfrytëzimin e literaturës së huaj është edhe biblioteka digjitale, U-library.<br>Revista "Buletini Shkencor", seria e Shkencave didaktike shërben edhe si burim literature ndihmëse për studentët. Ai mund të gjendet në bibliotekën e Universitetit, ashtu sikurse edhe on -line në faqen zyrtare të universitetit, me akses të hapur për të gjithë.<br>Evidencë 3.10 - Lista e librave T@sk-kontratë shtesë<br>Evidencë 3.11 - Aksesi në bibliotekën online U library<br>Evidencë 3.12 - Njoftim Buletini i Shkencave të Edukimit. |
| VLERËSIMI | Programet dhe planet mësimore janë objekt vlerësimesh, diskutimesh e përmirësimesh të vazhdueshme me qëllimin për të lehtësuar mobilitetet e studentëve dhe njohjen e programeve dhe diplomave nga institucionet arsimore të huaja.<br>Edhe studentët e FSHE-së përfshihen në vlerësimin e programeve të studimeve. |

| | |
|---|---|
| | Studentët që përfundojnë një program studimi të nivelit Bachelor zhvillojnë dy gjuhë të huaja, përkatësisht: në vitin e parë gjuhën angleze, në vitin e dytë/tretë zhvillojnë njërën nga gjuhët e huaja: frëngjisht, italisht, gjermanisht, turqisht, në formën e lëndës me zgjedhje. Studentët e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë kanë kriter pranimi edhe njohjen e dokumentuar të një nga pesë gjuhët e huaja: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht.<br>Pasi kanë kryer të gjitha detyrimet, studentët kanë të drejtën e diplomimit, provim me shkrim apo punim teme, bazuar në rregulloren e studimeve.<br>Pas marrjes së vlerësimit pozitiv, studentët pajisen me diplomën përkatëse, e shoqëruar me suplementin. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe ka informacion të hollësishëm rreth programit të studimit dhe vlerësimit të studentit. |

| **Standardi III.<br>PROGRAMET E STUDIMIT, MËSIMDHËNIA DHE VLERËSIMI<br>FE** | |
|---|---|
| PROGRAMET E STUDIMIT | FE-ja ofron tre programe studimi në të tre ciklet. Departamentet bëjnë përpjekje të vazhdueshme për hapjen e programeve të reja të studimit në përputhje me nevojat e tregut të punës. Ka përmirësime të dukshme në publikimin në faqen zyrtare të USH-së të kritereve të pranimit të studentëve. Programet e studimit ndjekin me rigorozitet bazën ligjore përkatëse dhe në përmbajtjen e tyre harmonizojnë komponentët e tyre. FE-ja bën përpjekje për përmirësimin e programeve të studimeve duke marrë për bazë rezultatet e vlerësimit të tyre nga personeli akademik dhe nga studentët. (Evidence 1.11).<br>FE-ja bën përpjekje për të realizuar formimin e vazhduar si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Programet e studimit janë në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e USH-së. FE-ja e harton politikën e tij në përputhje me politikat kombëtare. FE bën përpjekje për të siguruar koherencë me programe të ngjashme studimi të universiteteve të tjera në vend e më gjerë, në rajon. Departamentet, çdo fillim viti akademik diskutojnë dhe miratojnë ngarkesën mësimore vjetore të normuar dhe kohën vjetore të punës, mbështetur në bazën ligjore përkatëse. |
| MËSIMDHËNIA | Programet e studimit u bëhen të ditura studentëve çdo fillim viti akademik, ku njihen me elemente bazë të tij, si dhe me parimet bazë të "Kodit të Etikës" të USH-së. Fakulteti ka manuale për studentët. Pedagogët dhe studentët, gjithashtu, përdorin edhe komunikimin online. Programet e studimit kanë hartuar objektiva të përcaktuara qartë në lidhje me përfshirjen e dijeve, njohurive dhe zotësive që duhet të përvetësojë një student i programit përkatës. Lëndët dhe ngarkesat e tyre në kurrikula përputhen me objektivin e programit për të përgatitur specialistë sa më të zotë në fushën përkatëse.<br>FE-ja ka intensifikuar përpjekjet për informimin e studentëve lidhur me mundësinë e studimit në vende të huaja. Ka pasur përmirësim në drejtim të mobilitetit të studentëve gjatë viteve akademike 2017-2022. Institucioni ofron, gjithashtu, mundësinë që disa lëndë në programe të ndryshme studimi të ofrohen në gjuhën angleze. Stafi bën |

| | |
|---|---|
| | përpjekje për integrimin e elementëve praktikë në realizimin e syllabuseve të lëndëve. Departamentet vazhdimisht organizojnë dhe nxisin pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete jashtë kurrikulës. FE ka përgatitur udhëzues për studentët për përgatitjen e punimeve të diplomave. Në programet e studimit të ciklit të dytë është përgatitur paketa e mbrojtjes finale, e cila përcakton qartë të gjitha procedurat e mbrojtjes. FE bën përpjekje për përfshirjen dhe mbështetjen e studentëve në organizimin e aktiviteteve/projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare me karakter social, kulturor dhe sportiv.<br>Stafi akademik i FE-së angazhohet në veprimtari kërkimore-shkencore. Ekziston një bashkëpunim i fortë ndërmjet stafit akademik të FE-së me institucione vendore publike e private. (Evidencë 1.9). |
| VLERËSIMI | Diplomat që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe përmban informacion të detajuar. |

| Standardi III.<br>PROGRAMET E STUDIMIT, MËSIMDHËNIA DHE VLERËSIMI<br>FD | |
|---|---|
| PROGRAMET E STUDIMIT | Programet e studimit në FD janë hartuar në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e strategjisë së zhvillimit të Universitetit të Shkodrës. USH ka si bazë të funksionimit të tij për të gjithë programet e studimit, statutin dhe rregulloren e tij.<br>Misioni i FD është formimi i specialistëve të nivelit të lartë dhe rritja intelektuale e tyre, transmetimi i dijeve me anë të mësimdhënies dhe nxitja e punës kërkimore-shkencore në përputhje me interesat kombëtare; konform kërkesave të legjislacionit evropian si pjesë e rëndësishme e krejt procesit të integrimit të Shqipërisë në BE apo tregun ndërkombëtar të punës. Përditësimi i kurrikulave mësimore, mban parasysh edhe nevojat e studentëve lidhur me ndjekjen e studimeve të mëtejshme në universitete të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.<br>Objektivat e programeve të studimit janë të përcaktuara qartë dhe përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat akademike dhe profesionale që duhet të fitojnë studentët gjatë studimeve në këto programe. Këto programe në bazë të kërkesave të tregut të punës për jurist me formim të plotë ofrojnë njohuri të thelluara për çështjet kushtetuese, administrative, të pronësisë, juridiko – civile, juridiko – penale, ndërkombëtare dhe në veçanti evropiane etj.<br>FD zotëron kapacitete akademike dhe infrastrukturore për realizimin e programeve të studimit që ofron. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programeve të studimit në FD, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin si dhe mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. FD ka angazhuar në procesin e mësimdhënies apo të praktikave profesionale mësimdhënës me kohë të pjesshme, kryesisht ne lëndët apo fushat e të drejtës ku kërkohet një eksperiencë në praktikë të ushtrimit të lëndës në fjalë (mjekësi ligjore, kriminalistikë, psikologji ligjore, pjesë të lëndëve proceduriale si dhe udhëheqjet në praktikat profesionale). |

| | |
|---|---|
| | FD ofron për vitin akademik 2022 – 2023 tre programe studimi: 1. Programi i integruar i studimit "Master i Shkencave në Drejtësi" (Evidencë 3.2); 2. Master i Shkencave në të Drejtën Kushtetuese dhe Administrative (Evidencë 3.3); 3. Master i Shkencave në të Drejtën Private dhe të Biznesit (Evidencë 3.4); Program Bachelor në Drejtësi (180 ects) (Ky program mbyllet në përfundim të vitit akademik 2022-2023 si rezultat i reformimit të legjislacionit mbi edukimin in ligjor.<br>Programet e studimit në FD përmbajnë kurrikula të hartuara nga njësitë bazë, të cilat synojnë të japin një formim të plotë të studentëve në drejtësi. Ato i përgatisin me shprehi e njohuri të thelluara në fusha të ndryshme të së drejtës. Programet e studimit në FD kanë të grupuara në mënyrë të qartë lëndët formuese sipas ndarjes së njësive bazë. Ato janë të shpërndara në të gjitha vitet e studimit në mënyrë uniforme me ngarkesën përkatëse në kredite. Këto programe pasqyrojnë në mënyrë krejt të qartë profilin kërkimor dhe profesional të njësive. Në mënyrë të veçantë Fakulteti i Drejtësisë synon dhe organizimin e programeve të tjera të ciklit të dytë të cilat i shërbejnë formimit të vazhdueshëm të studentëve të cilët përfundojnë studimet në ciklin 5 vjeçar të studimeve.<br>Në FD është krijuar Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë (KGSC) në njësi kryesore dhe GVB të Programeve të Studimit (Evidencë 1.9 dhe Evidencë 1.10). Këto struktura të koordinuara nga Dekanati i Fakultetit të Drejtësisë organizojnë mbikëqyrjen e ecurisë së programeve të studimit dhe përmes RVB institucional dhe të programeve, të cilat evidentojnë pikat e forta dhe të dobëta mundësojnë edhe diskutimin dhe ndërhyrjet për përditësimin apo ndryshimin e këtyre programeve. Departamentet organizojnë takime të herëpashershme për mësimdhënie dhe problematikë të ngritura gjatë këtij procesi nga të gjithë aktorët (staf akademik, administrativ dhe studentë) me qëllimin e përmirësimit apo zgjidhjes së problematikave që ngrihen (Realizimi i programeve monitorohet më tej edhe në nivel universiteti, përmes strukturave përkatëse). |
| MËSIMDHËNIA | Teknikat e mësimdhënies në fushën e drejtësisë përfshijnë metodat interaktive të nxitjes së debatit pedagog – studentë. Përveç trajtimeve teorike dhe doktrinare, një vend të veçantë duhet të zërë edhe analiza e case – law, jurisprudencës e cila ndihmon në kuptimin dhe angazhimin më të plotë të studentëve. Programet e lëndëve (syllabuset) dhe teknikat e mësimdhënies diskutohen në departamente, duke promovuar shembujt pozitiv dhe më të përshtatshëm; realizimi i procesit mësimor dhe kërkimit shkencor diskutohen në mbledhje të veçanta të departamenteve dhe miratohen pastaj në Dekanat, i cili harton raportin përkatës për njësinë kryesore.<br>Bashkëpunimi me partnerët nga tregu i punës është prezent gjithmonë në punën e FD. Studentët e të gjitha programeve të studimit në FD kryejnë praktika profesionale pranë organeve të sistemit të drejtësisë ashtu edhe pranë organeve të administratës publike qendrore e vendore, si dhe në rastet kur është e mundur edhe në sipërmarrje private.<br>Format dhe metodat e mësimdhënies të bazuara në metodat interaktive të nxitjes së debatit pedagog – student. FD garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. Në kuadër të kontrollit të mësimdhënies mundësohet edhe diskutimi i programeve të lëndëve përkatëse në departamente si dhe me anë të anketimeve të ndryshme në kohë dhe në përmbajtje, të plotësuara nga studentët për pedagogët dhe lëndët. Studentët plotësojnë pyetësorë dy herë në vit, d.m.th. në fund të semestrit të parë dhe të dytë, me studentë të përzgjedhur rastësisht, por pyetësori nuk është specifikisht për pedagoget. Departamentet analizojnë të dhënat dhe sugjerimet e |

| | |
|---|---|
| | studentëve për të krijuar raporte vjetore që përmbajnë raportet e veprimtarisë së mësimdhënies dhe kërkimin shkencor.<br>Programet e studimit në FD janë hartuar duke patur si synim kryesor përshtatjen me tregun e punës. Kurrikula është e organizuar qartë duke grumbulluar kredite ECTS që lehtësojnë transferimin dhe lëvizshmërinë e studimeve. Në bazë të strategjisë së USH, bashkëpunimi ndërkombëtar është një përparësi, si dhe lëvizshmëria e pedagogëve dhe studentëve në programe të ndryshme. FD ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitete të huaja, kryesisht ato italiane si me universitetin e Bergamos, Catanias, Firences, Universiteti "La Sapienza" i Romes, Universiteti "Luigi Vanvitelli" i Napolit.<br>FD nuk ka të parashikuar në programin e studimit të vet zhvillimin e orëve laboratorike dhe në logjistikë nuk ka të përshirë laboratorë. Pedagogët dhe Studentët kanë mundësi dhe akses për shfrytëzimin e sallave të leximit, përdorimin e pajisjeve kompjuterike dhe aksesin në internet në godinën e bibliotekës së USH.<br>Në mbështetje të programeve të studimit mund të konsiderohen sistemet e komunikimit të brendshëm me akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjakë të dedikuar për personelin akademik dhe studentët. Biblioteka shkencore e USH është plotësisht e mundur për t'u shfrytëzuar. ka një fond prej rreth 170 mijë librash. Fondet e bibliotekës në shqip dhe në gjuhë të huaj mbulojnë edhe Fakultetin e Drejtësisë. FD ka synuar edhe ngritjen e një fondi të bibliotekës brenda departamenteve, të cilat janë relativisht të pajisura me literaturë bashkëkohore, në shqip dhe në gjuhë të huaj. Nga kjo bibliotekë u shërbejmë studentëve në çdo kohë. Kemi krijuar një kontingjent librash për studentët. Burimi janë kryesisht donacione dhe projekte nga/me fakultete te universiteteve partnere dhe organizata, kryesisht të huaja (TEMPUS, ERASMUS, OSCE). Gjithashtu, Klinika e Ligjit ka një numër të konsiderueshëm botimesh (broshura e studime të ndryshme) mbi të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, mbrojtjen nga diskriminimi, të cilat janë siguruar nga pjesëmarrja e stafit në seminare e workshop-e të ndryshme dhe nga institucionet e të drejtave të njeriut në kuadër të aktiviteteve të tyre ndërgjegjësuese. Aktualisht Universiteti i Shkodrës ka një librari digjitale on-line në adresën https://ulibrary.rash.al/, e cila është e aksesueshme nga studentët si dhe nga stafi akademik në funksion të mësimdhënies dhe mësim nxënies. |
| VLERËSIMI | Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve i referohen rezultateve të vlerësimit të dijeve në raport me kreditet e përcaktuara për çdo kurrikul. Sekretaria mësimore ka të ngritur sistemin e pasqyrimit të vlerësimeve. Programet kanë të pasqyruar dhe numrin e krediteve të cilat iu bëhen më dijë studentëve. Gjithashtu Rregullorja e Studimeve ka të përcaktuar numrin e krediteve që i duhen studentit për të vijuar studimet. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë e cila është një dokument zyrtar i pajisur me numrin e matrikullit si dhe i vulosur nga Rektori i USH dhe Dekani i FD. |

**Standardi III.**

**PROGRAMET E STUDIMIT, MËSIMDHËNIA DHE VLERËSIMI**

**FGJH**

| | |
|---|---|
| PROGRAMET E STUDIMIT | FGJH ofron katër programe studimi në nivel të parë, Bachelor në gjuhë angleze, frënge, gjermane dhe italiane, dhe katër programe studimi në nivel të dytë, Master në mësuesi në gjuhë angleze, frënge, gjermane dhe italiane të hartuara në përputhje me misionin e institucionit, i cili është të prodhojë studentë kompetentë të informuar dhe produktive, duke u krijuar mundësi studentëve që të përfitojnë eksperiencë edukuese me cilësi të lartë, të angazhohen në aktivitete kërkimore dhe krijuese dhe të ofrojnë shërbime të vlefshme për komunitetin, shtetin dhe me gjerë.<br>FGJH ofron programe studimi që janë në përputhje objektivat e përgjithshme kombëtare dhe ndërkombëtare, me prirjet e zhvillimit te arsimit të lartë në vend. Kurrikulat akademike janë të përshtatura me kërkesat e zhvillimit social dhe ekonomik të vendit si dhe me tregun e punës përmes përfshirjes së aktorëve të tjerë në procesin e krijimit, vlerësimit dhe përmirësimit të kurrikulave akademike.<br>Objektivat e programeve të studimit në FGJH janë të përcaktuar qartë dhe lehtësisht të kuptueshme në përputhje me objektivat e përgjithshme të institucionit. Kurrikulat e programeve të studimit të FGJH mund të gjenden në faqen e internetit të Universitetit.<br>Në FGJH, programet e studimeve mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike. Kurrikulat synojnë formimin e aftësive profesionale nëpërmjet ndërthurjes së teorisë dhe praktikës.<br>Aktualisht, FGJH ofron programe studimi në dy nivele: Programet e studimit të ciklit të parë në<br>FGJH synojnë të japin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme.<br>Programet e studimeve të ciklit të dytë mbështeten mbi kërkime dhe për realizimin e tyre, FGJH ka bashkëpunuar me aktorë të fushës ekonomike. Formimi i vazhdueshëm është pjesë integrale e programeve të studimeve në FGJH. Programet e e studimit te nivelit të parë BA ofrojnë formim akademik dhe strukturor të tillë i cili mundëson vazhdimësinë e formimit të studentëve nëpërmjet ofrimit të programeve të studimit të Masterit profesional, të cilat synojnë vendosjen e stafit në tregun e punës. Strategjia e USH përcakton qëllimet e institucionit për të vazhduar trajnimin e stafit të brendshëm akademik. |
| MËSIMDHËNIA | FGJH ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies përmes Drejtorisë së Kurrikulës, Kërkimit shkencor dhe Standardeve. Programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë respektojnë zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të përparuara në fushën akademike dhe profesionale; pajisin studentët me kompetencat e duhura për zgjidhjen e problematikave që mund të lindin në vijimësi të zbatueshmërise së procesit të punës në një fushë të specializuar studimi ose profesional.<br>FGJH përpiqet të krijojë ura lidhëse me partnerët e mundshëm të tregut të punës me qëllim evidentimin dhe futjen e lëndëve, njohurive të nevojshme për të përmbushur kërkesat e tij.<br>Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me universitete të tjera të arsimit të lartë, si dhe me ato simotra, përfaqësues biznesi e kompani të ndryshme, vë në dispozicion infrastrukturën dhe personelin akademik e atë ndihmës-akademik për të ndikuar në përmirësimin dhe cilësinë e mësimdhënies.<br>Programet e studimeve në FGJH synojnë të nxisin mobilitetin e studentëve shqiptarë në Evropë dhe më gjerë. Strategjia e FGJH është e hartuar në një linjë me zhvillimin strategjik të USH |

| | |
|---|---|
| | FGJH disponon mjaft pajisje ndihmëse për zhvillimin e procesit mësimor si kompjutera, projektorë, mjete audio, etj., që ndihmojnë në realizimin sa më të mirë të mësimit, por prapë ka hapësirë për përmirësim dhe shtim të mjeteve ndihmëse didaktike.<br>Çdo departament i FGJH në programet e tyre të studimit të ciklit të parë dhe të dytë dhe kurrikulën për secilën lëndë të ofruar, përditëson programet e lëndëve/moduleve lidhur me programin e studimit përkatës në mënyrë të vazhdueshme duke u ofruar studentëve, jo vetëm literaturën e detyruar, e cila pasurohet vijueshëm, por personeli akademik vë në dispozicion edhe literature ndihmëse të viteve të fundit. Literatura bazë dhe ndihmëse është e disponueshme dhe përcaktohet qartazi në syllabuset e çdo lënde, sipas zërave të posaçëm dhe formatit të syllabuseve. Literatura bazë dhe ndihmëse është gjithashtu e pasqyruar në programet e lëndëve. |
| VLERËSIMI | Studenti në përfundim të kursit të plotë të studimeve, për të fituar të gjitha kreditet e parashikuara në planin mësimor i nënshtrohet procesit të diplomimit për të fituar titullin sipas emërtimit të diplomës. |

| **Standardi III**<br>**PROGRAMET E STUDIMIT, MËSIMDHËNIA DHE VLERËSIMI**<br>**FSHSH** | |
|---|---|
| PROGRAMET E STUDIMIT | FSHSH ofron programe në përputhje me misionin, strategjinë e tij të zhvillimit, kërkesat e tregut, objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Programet e FSHSH kanë objektiva të përcaktuar qartë. FSHSH i përcakton qartë dhe i ndjek procedurat për miratimin e programeve të reja, të cilat ofrohen në përputhje të plotë me kapacitetet e institucionit. Programet e studimit janë të organizuar në cikle studimi dhe nga cikli në cikël hartohen me qëllim mire orientimin dhe përftimin gradual të njohurive nga studentët.<br>Programet e studimeve mbështeten në profilin kërkimor dhe profesional të FSHSH dhe realizohen në bashkëpunim me aktorë të fushës. Ato janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm në funksion të rritjes së cilësisë. |
| MËSIMDHËNIA | Programet e studimeve të shpallura zbatohen sipas strukturave të miratuara në nivel institucional e kombëtar dhe mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike. Programet zhvillohen me qëllim përfshirjen aktive të studentëve në përftimin e kompetencave. Ato synojnë përgatitjen e studentëve për punësim dhe nxitjen e mobilitetit të studentëve shqiptarë dhe të huaj.<br>Institucioni siguron laboratorë të dedikuar në mbështetje të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor/artistik. Institucioni siguron pajisje laboratorike, infrastrukturë dhe shërbime në mbështetje të programeve të studimit. Biblioteka, infrastruktura dhe shërbimet e saj sigurojnë akses në literaturë bashkëkohore të lidhur me fushat e studimit dhe kërkimit në programe. FSHSH ofron programe të të nxënit gjatë gjithë jetës.<br>FSHSH ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. |
| VLERËSIMI | Institucionet pajisin studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit, me diplomën përkatëse, që është dokument zyrtar. |

| | |
|---|---|
| | Mund të bëhen pyetësorë më specifikë për të kuptuar nëse rezultatet e të nxënit të studentëve përputhen me nivelin e profilin e kualifikimit që ofrojnë programet e FSHSH. Programet e studimeve mund të monitorohen në mënyrë më specifike dhe periodike. |

**Përfundime mbi standardin**

- Në ***USH*** ofrohen programe studimi në tre cikle, programet e studimit në USH janë në përputhje me bazën ligjore dhe në përputhje me objektivat kombëtarë e ndërkombëtarë. Kurrikulat e programeve janë hartuar duke marrë parasysh edhe kurrikulat e programeve të ngjashme të huaja. Në këtë mënyrë, studentët tanë kanë mundësi studimi të mëtejshëm në universitete të tjera brenda vendit apo jashtë tij. Ata, gjithashtu, kanë mundësi punësimi jashtë vendit. Bazuar në elementet përbërëse të programeve të studimit, informacioni që jepet në këto programe është i plotë, duke filluar që me emërtimin, kohëzgjatjen, pikë kreditet, vendimet e hapjes, objektivat formues, karakteristikat, mundësitë për punësim, struktura akademike përgjegjëse dhe strukturat bashkëpunuese, plani mësimor, etj. Programet e studimit në USH janë në përputhje me kapacitetet e fakulteteve, si ato akademike, ashtu edhe kapacitete infrastrukturore.
- Ngarkesa mësimore e pedagogut në USH është ngarkesa e plotë vjetore prej 1536 orësh. Veprimtaritë që kryen personeli akademik në IAL janë: a) mësimdhënie; b) kërkimi shkencor ose artistik; c) kontribut institucional; d) kontribut profesional. Në fakultete ka pasur vazhdimisht rekrutime të stafit akademik me kohë të plotë, me qëllim që pjesa më e madhe e lëndëve të mbulohen me pedagogë me kohë të plotë. Normalisht, ka edhe staf akademik me kohë të pjesshme, në varësi edhe të specialiteteve që mbulojnë, me qëllim që studentëve t'u ofrohet cilësi sa më e mirë në mësimdhënie. Kapacitetet infrastrukturore mundësojnë zhvillimin e programeve të studimit në USH.
- USH krijon të gjitha lehtësirat për përfundimin e studimeve në kushte të mira brenda kritereve akademike dhe infrastrukturore dhe fillimin e një cikli të ri studimesh. Secili tip i veprimtarisë (veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm, veprimtari në disiplina të formimit karakterizues, veprimtari në disiplina të ngjashme ose dhe integruese, disiplina me zgjedhje, njohuritë tjera formuese dhe teza e diplomës) ka në përbërjen e tij lëndët përkatëse, të cilat bazohen në syllabuse bashkëkohore. Syllabuset janë, gjithashtu, të bazuara në literatura të huaja dhe të viteve të fundit. Programet e studimit janë të hartuara në mënyrë të atillë që lejojnë mundësinë e transferimit në programe të tjera homologe, bazuar në kreditet e fituara. Burimi i informacionit merret përmes rregullores përkatëse të studimeve.
- Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", programet e studimeve në tre cikle përmirësohen, bëhen ndryshime në emërtimin e lëndëve, në numrin e pikë krediteve, në mënyrë që studentëve t'u ofrohet një kurrikul bashkëkohore.USH ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së

mësimdhënies. Një objektiv të tillë departamentet e realizojnë përmes: diskutimit dhe miratimit të ndryshimeve për programet e studimit në një mbledhje të veçantë në department. Pedagogët sugjerojnë ndryshimet përkatëse në programin e studimit. Më pas shkresa kalon në Dekanat dhe më pas në Senat. Senati akademik, në një mbledhje të veçantë miraton ndryshimet e propozuara, nëse e gjykon të arsyeshme; marrjes në konsideratë edhe të mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve që diplomohen, organizimit çdo vit të mbledhjes "Analiza e punës mësimore dhe shkencore". Gjatë këtyre mbledhjeve analizohet puna e bërë nga pedagogët për zbatimin e lëndëve sipas programeve të studimit dhe puna shkencore e secilit pedagog. Evidentohen arritjet, problematikat dhe vështirësitë të cilat bëhen objekt diskutimesh, me qëllim përmirësimin e tyre dhe përcaktohen objektivat për vitin pasardhës, organizimit çdo vit të mbledhjes me tematikë "Miratimin e syllabuseve'', ku secili pedagog pasqyron syllabuset e lëndëve dhe ndryshimet që ka bërë krahasuar me vitin akademik paraardhës, duke i argumentuar ato ndryshime që ka bërë. Edhe Dekanati e ndjek këtë proces. Në dekanat analizohet puna mësimore-shkencore e Fakultetit, miratohen ndryshimet që departamentet sjellin për programet e studimit, miratohen RVB-të e programeve të studimit. Çdo fakultet ka krijuar mekanizmat që e monitorojnë cilësinë, siç janë GVB-të e programeve të studimit dhe NjSBC-ja e Fakultetit.

- Programet e studimit kanë në përmbajtjen e tyre informacion të mjaftueshëm dhe koherent për studentët. Në programet e studimeve janë të paraqitura rubrikat përkatëse në përputhje me bazën ligjore. Programet e lëndëve përditësohen me prurjet më të reja të literaturës bashkëkohore. Pedagogët kanë të parashikuara në sylabuset e tyre edhe projekte kursi për vlerësimin e studentëve, zhvillimi i të cilave u mundëson përvetësimin m ëtë mirë të lëndës dhe zhvillimin e shprehivetë punës së pavarur. Programet e studimit, në përgjithësi, kanë të parashikuara edhe praktika profesionale. Praktikat profesionale realizohen në kuadër të marrëveshjeve institucionale me institucione vendore publike si dhe përmes bashkëpunimit me sektorin privat. Institucionet vendore shtetërore me të cilat bashkëpunohet janë: Bashkia Shkodër, DAR, Shërbimi i Provës, Zyra vendore Shkodër, Spitali Rajonal Shkodër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Drejtoria Rajonale e SH.S.SH-së Shkodër, OJF "THE DOOR", Fototeka "Marubi", Muzeu Historik Shkodër, organizata të shoqërisë civile, jofitimprurëse dhe me institucione të tjera të sektorit privat dhe shtetëror që operojnë në zonën e Veriut. Duke iu referuar përmbajtjes së programeve të studimit në USH konstatohet se lëndët e modulet e përfshira në këto programe formojnë profesionistë në fushat përkatëse. Diplomat që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe përmban informacion të detajuar.
- Programet dhe planet mësimore janë objekt diskutimesh e përmirësimesh të vazhdueshme dhe u janë nënshtruar rishikimeve, në përputhje jo vetëm me kërkesat e akteve të reja nënligjore, por edhe duke reflektuar sugjerime që vijnë nga stafi akademik,

studentët apo institucionet me të cilat bashkëpunohet. Hartimi i programeve është realizuar edhe në bazë të konsultimeve me programe të ngjashme studimi kombëtare dhe ndërkombëtare, duke bërë të mundur lehtësimin e studentëve për të ndjekur në vazhdimësi studimet e mëtejshme edhe në universitete të tjera në arenën ndërkombëtare.

- Studentët që përfundojnë një program studimi të nivelit Bachelor zhvillojnë dy gjuhë të huaja, përkatësisht: në vitin e parë të studimeve zhvillojnë gjuhën angleze, në vitin e dytë të studimeve zhvillojnë njërën nga gjuhët e huaja: frëngjisht, italisht, gjermanisht, turqisht, gjuhë malazeze, në formën e lëndës me zgjedhje. Studentët e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë kanë kriter pranimi edhe njohjen e dokumentuar të një nga pesë gjuhët e huaja: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Pasi kanë kryer të gjitha detyrimet, studentët kanë të drejtën e diplomimit, provim me shkrim apo punim teme, bazuar në Rregulloren e studimeve. Pas marrjes së vlerësimit pozitiv, studentët pajisen me diplomën përkatëse, e shoqëruar me suplementin. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe ka informacion të hollësishëm rreth programit të studimit dhe vlerësimit të studentit.
- Në USH ka laboratorë cilësorë në secilin Fakultet, ku kryesisht në FSHN këta laboratorë janë në funksion edhe të ofrimit të shërbimeve për palë të treta.
- Biblioteka e USH-së ofron literaturë të pasur në shkencat psiko-sociale. Burim mjaft i rëndësishëm për shfrytëzimin e literaturës së huaj është edhe biblioteka digjitale, U-libary. Në bashkëpunim me RASH-in, Drejtoria e IT-së së Universitetit të Shkodrës ka mundësuar aksesin ndaj shërbimit të kësaj librarie dixhitale për të gjithë pedagogët dhe studentët e Universitetit. Revista "Buletini Shkencor", shërben edhe si burim literature ndihmëse për studentët. Ai mund të gjendet në bibliotekën e Universitetit, ashtu sikurse edhe on -line në faqen zyrtare të universitetit, me akses të hapur për të gjithë.

**Vlerësimi i fushës: Standardet përmbushen plotësisht.**

| **Standardi IV.** |
| --- |
| **AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK DHE INOVACIONI** |
| **FSHN** |

| | |
|---|---|
| **AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK** | FSHN ka miratuar planin strategjik 2022-2026. Misioni i FSHN-së vjen në të njëjtën linjë me misionin e USH, duke synuar krijimin, zhvillimin, mbrojtjen dhe transmetimin e dijeve me anën e mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore, formimin e specialistëve të lartë dhe përgatitjen e shkencëtarëve të rinj në fushën e mësimdhënies në bio-kimi, matematikë, fizikë, informatikë, si dhe specialistë mjedisorë, specialistë në informatikë dhe në shkencat mjekësore teknike (infermieri, mami dhe fizioterapi). Çdo vit departamentet zhvillojnë analizën e punës mësimore shkencore, ku, krahas rezultateve të arritura, përcaktohen dhe prioritetet për vitin pasardhës. Gjithashtu, çdo vit Senati Akademik realizon analizën e punës mësimore e shkencore dhe nxjerr në pah pikat e forta e të dobëta, me qëllim përmirësimin e punës.<br>Departamentet planifikojnë aktivitetin shkencor për vitin në vijim. Ka edhe bashkëpunime. (Evidencë 4.1 Lista e aktiviteteve me ndikim social).<br>ndërmjet departamenteve për organizime konferencash apo veprimtarish të tjera. Në FSHN janë zhvilluar një sërë veprimtarish shkencore, si konferenca, workshope, leksione te hapura, si dhe veprimtari të tjera.<br>Në planin strategjik të FSHN-së 2022-2026 rritja e cilësisë së kërkimit shkencor përbën një nga objektivat e punës në vazhdim. Theksi vihet tek botimet në revista prestigjioze, organizimi i një konference ndërkombëtare në nivel fakulteti, rritja e numrit të pedagogëve pjesëmarrës në borde editoriale ndërkombëtare, përmirësim i angazhimit të studentëve në punë kërkimore-shkencore. (Evidencë 4.3.1 Financimi ne Konferenca Shkencore).<br>Duhet punuar më shumë në drejtim të përfshirjes në veprimtaritë mësimore e shkencore të personelit të huaj akademik dhe diasporës.<br>Zyra e marrëdhënieve me jashtë publikon informacione të vazhdueshme në faqen e USH-së në lidhje me veprimtaritë ndërkombëtare, duke përfshirë mundësitë për mobilitetin e stafit dhe studentëve.<br>Evidencë 1.10. Planet strategjike të FSHE, FE<br>Evidencë 4.1. Senati akademik. Miratimi i fushave prioritare kërkimore-shkencore. |
| **INOVACIONI** | FSHN ka shumë resurse të cilat duhet të përdoren për rritjen financiare të institucionit. Mund të përmendim e Qendrën e diagnostikimit mikrobiologjik, Qendrën e Fizioterapisë, që ofrojnë ndërmjet të tjerave edhe shërbim për të tretët. Në fazën përfundimtare është dhe laboratori i Analizës Ushqimore i cili do të mundësojë vlerësimin e cilësisë së ushqimeve në rajonin e Shkodrës, si dhe është në fazën fillestare laboratori klinik biokimik. |

## Standardi IV.
## AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK DHE INOVACIONI
## FSHE

| | |
|---|---|
| **AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK** | FSHE punon në realizimin e objektivave me qëllim që të sigurojë një mësimdhënie të kualifikuar, të krijojë kushte për mësim dhe kërkim shkencor si dhe të përgatisë specialistë të aftë në të gjitha disiplinat që mbulon FSHE. (Evidencë 1.10).<br>Janë përcaktuar dhe qëllimet dhe objektivat kryesore, që janë:<br>Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies, me qëllim formimin e specialistëve të aftë; (Evidencë 5.2.2)<br>Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor;<br>Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara për studentët; (Evidencë 5.2.8).<br>Monitorimi i cilësisë së programeve të studimit;<br>Përmirësimi i aksesit për studentët me nevoja të veçanta;<br>Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit;<br>Rritja e bashkëpunimit me komunitetin.<br>Çdo vit secili departament zhvillon analizën e punës mësimore shkencore, ku, krahas rezultateve të arritura, përcaktohen dhe prioritetet për vitin pasardhës. Ka edhe bashkëpunime ndërmjet departamenteve për organizime konferencash apo veprimtarish të tjera. Çdo vit Senati Akademik realizon analizën e punës mësimore e shkencore dhe nxjerr në pah pikat e forta e të dobëta, me qëllim përmirësimin e punës.<br>Në FSHE janë zhvilluar një sërë veprimtarish shkencore, artistike dhe sportive, si dhe veprimtari të tjera. USH bën përpjekje për përmirësim të vazhdueshëm.<br>Në planin strategjik të FSHE-së 2022-2026 Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor përbën një nga objektivat e punës në vazhdim. Theksi vihet tek botimet në revista prestigjioze, organizimi i një konference ndërkombëtare në nivel fakulteti, rritja e numrit të pedagogëve pjesëmarrës në borde editoriale ndërkombëtare, përmirësim i angazhimit të studentëve në punë kërkimore-shkencore.<br>Duhet punuar më shumë në drejtim të përfshirjes në veprimtaritë mësimore e shkencore/artistike të personelit të huaj akademik dhe diasporës.<br>Zyra e marrëdhënieve me jashtë publikon informacione të vazhdueshme në faqen e USH-së në lidhje me veprimtaritë ndërkombëtare, duke përfshirë mundësitë për mobilitetin e stafit dhe studentëve. (Evidencë 4.11.2). Duhet punuar më shumë në këtë drejtim, me qëllim përfshirjen më të madhe të studentëve për mobilittein dhe përfshirjen më të madhe të pedagogëve në projekte. |
| **INOVACIONI** | FSHE ka shumë resurse të cilat duhet të përdoren për rritjen financiare të institucionit. Mund të përmendim ngritjen e Klinikës së shërbimit psikologjik dhe social, që përbën dhe një nga objektivat e strategjisë së zhvillimit të USH-së. |

**Standardi IV.**

**AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK DHE INOVACIONI**

**FE**

| | |
|---|---|
| **AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK** | FE Departamentet, bazuar në profilin dhe traditën e tyre, kanë grupuar disiplinat mësimore në kuadër të zbatimit të programeve të studimit që mbulojnë. Ato inkurajojnë dhe nxisin përpjekjet për kualifikim të mëtejshëm shkencor të stafit. FE-ja ka një përvojë të pasur në fushën e kërkimit shkencor dhe vazhdimisht e ka ndihmuar zhvillimin e tij duke i dhënë prioritet partneritetit me institucione kërkimore-shkencore brenda dhe jashtë vendit si dhe pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Institucioni mbështet organizimin e konferencave dhe veprimtarive shkencore. (Evidencë 4.16.2). Personeli akademik, nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare, jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës si dhe promovon njëkohësisht edhe vlerat dhe traditën e fakultetit përkatës. Shpesh iniciativat individuale kthehen në projekte institucionale. (Evidencë 4.9).<br>FE-ja bashkëpunon me organizma shkencorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. FE përpiqet të integrojë kërkuesit shkencorë nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit me studiues të huaj, si: në mësimdhënie, konferenca ndërkombëtare dhe evente të tjera shkencore. (Evidencë 4.16.1)<br>Evidencë 4.2 Sfidat e zhvillimit rajonal FE<br>Evidencë 4.3 Miratimi i rregullores së zyrës së ekselencës, (17/7/2019) e cila nxit kërkimin shkencor të studentëve të Masterit, nëpërmjet punimit te Diplomës. |

| **Standardi IV.<br>AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK DHE INOVACIONI<br>FD** | |
|---|---|
| **AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK** | FD Kërkimi shkencor konsiderohet si një nga objektivat kryesorë të punës për të gjitha strukturat e Universitetit të Shkodrës. Në këtë këndvështrim vizioni i USH është të fokusojë kërkimin shkencor në zgjidhje dhe në shërbim të zhvillimeve sociale dhe ekonomike të komuniteteve dhe shoqërisë shqiptare. Gjithashtu USH synon nxitjen e bashkëpunimeve dhe partneriteteve të suksesshme me organizata, institucione private apo publike që operojnë në fushën e kërkimit shkencor (Evidencë 1.6).<br>Me vendimin e Senatit Akademik nr. 97, nr. Prot 1026, datë 29.02.2021, USH ka përcaktuar qartë prioritet e kërkimit shkencor. Reforma në drejtësi dhe Integrimi europian janë prioritetet e kërkimit shkencor në fushën e drejtësisë. Me synim realizimin e këtyre prioriteteve Fakulteti i Drejtësisë ka organizuar aktivitete të ndryshme dhe leksione të hapura te cilat kanë patur si temë kryesore pikërisht Integrimin në Bashkimin Europian apo Reformën në Drejtësi (Evidencë 5.1).<br>USH ka tashmë një politikë të konsoliduar në kuadër të mbështetjes së punës kërkimore shkencore të personelit akademik, e cila realizohet më së miri nëpërmjet publikimeve të kërkimeve shkencore të stafit akademik në revista |

| | |
|---|---|
| | shkencore në fusha të ndryshme sipas fakulteteve. Organizohen gjithmonë promovime të punimeve shkencore të personelit akademik apo edhe leksione të hapura, konferenca në të cilat prezantohen dhe diskutohen punime të ndryshme shkencore të personelit akademik të USH dhe stafe akademike nga Universitete të tjera brenda apo jashtë vendit si dhe me pjesëmarrje të studentëve.<br>Departamenti është njësia bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencor të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat respektive (Evidencë 1.2). Tre departamentet e Fakultetit të Drejtësisë inkurajojnë dhe promovojnë përpjekjet për kualifikimin e mëtejshëm shkencor të stafit dhe kjo paraqitet në raportin vjetor për punën kërkimore shkencore, duke evidentuar qartë arritjet dhe objektivat për vitin pasardhës (Evidencë 1.13).<br>USH me qëllimin kryesor mbështetjen dhe promovimin e personelit akademik në kuadër të ngritjes profesionale të stafit ka vendosur të mbështesë stafin akademik me kohë të plotë duke financuar projektet kërkimore për pedagogët që janë pranë marrjes së titujve akademikë apo financim të projekteve kërkimore për pedagogët që janë të angazhuar në kërkim shkencor (Evidencë 4.1). |
| **INOVACIONI** | Një nga mënyrat e transferimit të rezultateve të veprimtarisë kërkimore e shkencore në funksion të shoqërisë është Klinika e Ligjit e "USH-së", mundësuar nga Fakulteti i Drejtësisë, e cila synon të ofrojë ndihmë juridike falas për personat në pamundësi ekonomike të tilla si: këshillim ligjor, përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën publike, përfaqësimin përpara organeve administrative, përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën dhe përfaqësimin përpara gjykatës në çështjet administrative. Në këtë mënyrë ajo është një nga shembujt më të mirë të ofrimit të shërbimeve në funksion të shoqërisë dhe të zhvillimit të saj (Evidencë 5.7). |

| **Standardi IV.<br>AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK DHE INOVACIONI<br>FGJH** | |
|---|---|
| **AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK** | FGJH Për përmirësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor departamentet e FGJH operojnë ngushtë mes tyre, por edhe me bashkëpunëtorët vendas dhe të huaj në përputhshmërinë e planit mësimor dhe të programit të studimit për të mundësuar dhe garantuar cilësinë e mësimdhënies dhe të kërkimit.<br>FGJH mbështet mobilitetin pedagogeve në universitete të tjera jashtë vendit nëpërmjet projekteve lidhur me eksperimentimin e mësimdhënies, inkurajon dhe nxit përpjekjet për kualifikim të mëtejshëm shkencor të stafit.<br>FGJH synon të përmirësojë infrastrukturën logjistike dhe administrative të përshtatshme duke rekrutuar personel akademik të kualifikuar që i përgjigjet metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.<br>Stafi i FGJH ka një përvojë të pasur në fushën e kërkimit shkencor dhe vazhdimisht e ka ndihmuar zhvillimin e tij duke i dhënë prioritet partneritetit me institucione kërkimore-shkencore brenda dhe jashtë vendit si dhe pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. (Evidencë 4.29 Marrëveshja me Universitetin e Messinës. Vizitë e prof. M. Geraci.) |

| | |
|---|---|
| | FGJH mbështet organizimin e konferencave dhe veprimtarive të ndryshme shkencore. Personeli akademik i FGJH, nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare, jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës si dhe promovon njëkohësisht edhe vlerat dhe traditën e fakultetit e FGJH-së |

| **Standardi IV.<br>AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK DHE INOVACIONI<br>FSHSH** | |
|---|---|
| **AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK** | FSHSH në Universitetin e Shkodrës zhvillon një aktivitet të gjerë shkencor, duke iu përmbajtur fushave parësore shkencore të përcaktuara nga Senati i Universitetit. Në mënyrë periodike organizohen konferenca që trajtojnë tematika të ndryshme nga fushat e albanologjisë, historisë, gjuhësisë, letërsisë, gjeografisë etj. Çdo vit, FSHSH boton "Buletini shkencor", me qëllim zhvillimin e kontributit shkencor të Fakultetit, si dhe aktivizimin e vazhdueshëm të stafin akademik në kërkimin shkencor.<br>Fakulteti garanton performancën dhe cilësinë e punimeve shkencore përmes përcaktimit të redaksive shkencore dhe këshillave shkencorë, të cilat përcaktojnë kriteret e botimit të artikujve dhe kriteret e pranimit të kumtesave, si dhe garantojnë në bazë të ligjit mbrojtjen e të drejtës së autorit.<br>Në funksion të promovimit të aktivitetit shkencor, Fakulteti organizon konferenca ndërkombëtare, ku ftohen edhe studiues nga universitete apo bota akademike jashtë vendit. Stafi i FSHSH boton vazhdimisht artikuj në revista shkencore jashtë vendit dhe merr pjesë në konferenca shkencore të organizuara në shtetet fqinje apo të Europës Perëndimore. Kërkimi shkencor synohet të jetë gjithëpërfshirës, duke organizuar herë pas here konferenca ku përfshihen edhe studentët. Evidencë 4.27 Shembull aktivizimi në projekt. |

**Përfundime mbi standardin**

- USH ka miratuar planin strategjik 2022-2026, duke synuar krijimin, zhvillimin, mbrojtjen dhe transmetimin e dijeve me anën e mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore, formimin e specialistëve të lartë dhe përgatitjen e shkencëtarëve të rinj në fushën e mësimdhënies në arsimin parashkollor, në arsimin fillor, edukimin fizik, në fushën e arteve dhe në fushat e shkencave sociale me specialitet psikologjinë dhe punën sociale. USH punon në realizimin e objektivave me qëllim që të sigurojë një mësimdhënie të kualifikuar, të krijojë kushte për mësim dhe kërkim shkencor si dhe të përgatisë specialistë të aftë në të gjitha disiplinat që mbulon institucioni.
- Janë përcaktuar dhe qëllimet dhe objektivat kryesore, që janë:

SHKODËR

- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies, me qëllim formimin e specialistëve të aftë;
- Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara për studentët;
- Monitorimi i cilësisë së programeve të studimit;
- Përmirësimi i aksesit për studentët me nevoja të veçanta;
- Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit.

Secili departament zhvillon analizën e punës mësimore shkencore, ku, krahas rezultateve të arritura, përcaktohen dhe prioritetet për vitin pasardhës. Senati Akademik është organi që realizon analizën e punës mësimore e shkencore dhe nxjerr në pah pikat e forta e të dobëta, me qëllim përmirësimin e punës. Gjithashtu, çdo vit Senati miraton raportin e vlerësimit të brendshëm. Edhe Dekanati, në mbledhje të veçanta, bën analizën e punës mësimore-shkencore dhe të raportit të vetëvlerësimit.

- USH ka shumë resurse të cilat duhet të përdoren për rritjen financiare të institucioni, siç është ngritja e Klinikës së shërbimit psikologjik dhe social, që përbën dhe një nga objektivat e strategjisë së zhvillimit. Me mjaft interes është dhe zhvillimi i trajnimeve në fushën e mësuesisë, apo zhvillimi i veprimtarive sportive e artistike. Secili departament planifikon punën e vet shkencore për vitin në vijim. Ka edhe bashkëpunime ndërmjet departamenteve për organizime konferencash apo veprimtarish të tjera. Në planin strategjik të USH-së 2022-2026, rritja e cilësisë së kërkimit shkencor përbën një nga objektivat e punës në vazhdim. Theksi vihet tek botimet në revista prestigjioze, Organizimi i një konference ndërkombëtare në nivel fakulteti, Rritja e numrit të pedagogëve pjesëmarrës në borde editoriale ndërkombëtare. Përmirësim i angazhimit të studentëve në punë kërkimore-shkencore.
- Duhet punuar më shumë në drejtim të përfshirjes në veprimtaritë mësimore e shkencore/artistike të personelit të huaj akademik dhe diasporës. Zyra e marrëdhënieve me jashtë publikon informacione të vazhdueshme në faqen e USH-së në lidhje me veprimtaritë ndërkombëtare, duke përfshirë mundësitë për mobilitetin e stafit dhe studentëve.

**Vlerësimi i fushës: Standardet përmbushen kryesisht.**

| Standardi V.<br>STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE<br>FSHN | |
|---|---|
| **STUDENTËT** | FSHN Çdo fillim viti akademik organizohen takime me studentët e viteve të para ku ofrohet informacion për organizimin e programeve të studimit, duke specifikuar objektivat dhe strukturën e moduleve, sistemin e vlerësimit në lidhje me kontrollin e dijeve përmes komponentëve të vlerësimit, kërkesat lidhur me literaturën, frekuentimin, detyrimet dhe metodologjinë e mësimdhënies si dhe me çështje etike të lidhura me aspekte studentore.<br>Një rol të konsiderueshëm luan edhe sistemi i menaxhimit të studentëve "Pitagora", i adoptuar nga USH që nga viti akademik 2020. (Evidence 5.3.5).<br>Në ambientet e FSHN-së ka postera informimi ku pasqyrohen kurrikulat, oraret mësimore dhe njoftime të ndryshme. Gjithashtu, pjesa më e madhe e departamenteve kanë krijuar faqet e tyre në rrjete të ndryshme sociale si elementë të rëndësishëm të përcjelljes së informacionit. Secili pedagog, stafi administrativ dhe studentët janë të pajisur me një adresë elektronike të brendshme të personalizuar, gjë që lehtëson komunikimin pedagog-student-staf administrativ. (Evidencë 5.3.4).<br>Në ndihmë të komunikimit sa më cilësor dhe të rritjes së cilësisë së mësimdhënies janë edhe platformat LMS, Moodle (Evidencë 5.3.2), dhe Teams (Evidencë 5.8.2), në institucionin tonë.<br>Në FSHN sekretaria mësimore orienton studentët që dëshirojnë të transferojnë programet e studimeve. (Evidencë 5.3.3)<br>Secili pedagog ka të përcaktuar në syllabusin e lëndës literaturën bazë dhe ndihmëse dhe e evidenton në mbledhjen e departamentit ku miratohen syllabuset e lëndëve. Në përgjithësi, pedagogët vënë në dispozicion të studentëve tekste të autorëve të njohur në fushat përkatëse, leksione të shtypura, materiale ndihmëse të printuara, tekste të botuara nga pedagogët e tij dhe nga pedagogë të universiteteve të tjera, tekste të përkthyera etj.<br>Edhe Biblioteka e USH-së ofron literaturë të pasur në shkencat natyrore. Burim mjaft i rëndësishëm për shfrytëzimin e literaturës së huaj është edhe biblioteka digjitale, U-library.<br>Revista "Buletini Shkencor", seria e Shkencave natyrore shërben edhe si burim literature ndihmëse për studentët.<br>Secili departament në FSHN aplikon shërbimin e tutoriatit për studentët. Me studentët e viteve të para organizohen orë të hapura, ku studentët njihen me programin e studimit, me Rregulloren, Kodin e Etikës, etj. Çdo shqetësim i studentëve përcillet nga pedagogu në departament, ku, zakonisht, gjen zgjidhje përmes bashkëpunimit me strukturat e tjera.<br>Në përbërjen e strukturës së Njësisë për Vlerësimin e Brendshëm të FSHN-së merr pjesë edhe një student. Gjithashtu, studentët kanë përfaqësues të tyre edhe në grupet e vlerësimit të brendshëm për programet e studimeve.<br>Këshilli Studentor i FSHN-së dhe Këshilli Studentor Institucional i USH-së krijojnë mundësinë që studentët të paraqesin në organet drejtuese të USH-së mendimet dhe opinionet e tyre në lidhje me gjithë veprimtarinë akademike dhe shkencore në USH. |

| | |
|---|---|
| **MBËSHTETJA E TYRE** | USH-ja ka pjesë të politikave të saj mbështetjen shumëdimensionale të studentit. Edhe FSHN kontribuon në këtë drejtim përmes përfshirjes dhe mbështetjes së studentëve në organizimin e aktiviteteve/projekteve kombëtare me karakter social, kulturor dhe sportiv.<br>USH mbështet kategori sociale të veçanta, pjesë e të cilave janë edhe studentë nga FSHN, duke krijuar edhe kushte lehtësuese, dhe ambiente të përshtatshme për ta. Çdo vit akademik akordohen bursa studimi. Të gjitha informacionet si dhe mënyrat e aplikimit publikohen në faqen zyrtare të Universitetit.<br>FSHN hedh, gjithashtu, bazat e punësimit të studentëve pas diplomimit përmes bashkëpunimit me institucione të ndryshme të rajonit sikurse lidhjeve me DAR-in, Spitali Rajonal Shkodër dhe DSHP. |

| **Standardi V.<br>STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE<br>FSHE** | |
|---|---|
| **STUDENTËT** | FSHE Kriteret e pranimit dhe numri i studentëve propozohen nga departamentet, miratohen në dekanat dhe pastaj kalojnë në Senat dhe miratohen nga Senati Akademik. Faqja zyrtare e institucionit siguron informacion mbi kuotat dhe kriteret e pranimit, përfshirë studentët nga Shqipëria dhe nga jashtë. Po kështu, në faqen zyrtare publikohen listat e fituesve për secilin program studimi.<br>Ka një larmi burimesh informimi për studentët., krahas faqes zyrtare, si p.sh., guidë përkatëse, broshurë informuese e FSHE-së. Po kështu, Dekanati, sekretaria mësimore dhe sekretaria e Dekanatit, si dhe njësitë bazë të fakultetit kanë orarin e pritjes së studentëve, me qëllim ofrimin e informacionit dhe sigurimin e mbështetjes së tyre për procesin mësimor apo problematika të tjera të lidhura me të. Secili departament në FSHE përcakton pedagogët tutorë për çdo program studimi që mbulon.<br>Çdo fillim viti akademik organizohen takime me studentët e viteve të para ku ofrohet informacion për organizimin e programeve të studimit, duke specifikuar objektivat dhe strukturën e moduleve, sistemin e vlerësimit në lidhje me kontrollin e dijeve përmes komponentëve të vlerësimit, kërkesat lidhur me literaturën, frekuentimin, detyrimet dhe metodologjinë e mësimdhënies si dhe me çështje etike të lidhura me aspekte studentore.<br>Një rol të konsiderueshëm luan edhe sistemi i menaxhimit të studentëve "ESSE3", i adoptuar nga USH që nga viti akademik 2013, tashmë i pranishëm sistemi Pitagora.<br>Në ambientet e FSHE-së ka postera informimi ku pasqyrohen kurrikulat, oraret mësimore dhe njoftime të ndryshme. Gjithashtu, pjesa më e madhe e departamenteve kanë krijuar faqet e tyre në rrjete të ndryshme sociale si elementë të rëndësishëm të përcjelljes së informacionit.<br>Secili pedagog, stafi administrativ dhe studentët janë të pajisur me një adresë elektronike të brendshme të personalizuar, gjë që lehtëson komunikimin pedagog-student-staf administrativ. |

| | |
|---|---|
| | Në ndihmë të komunikimit sa më cilësor dhe të rritjes së cilësisë së mësimdhënies janë edhe platformat LMS, Moodle dhe Teams në institucionin tonë.<br>Në FSHE sekretaria mësimore orienton studentët që dëshirojnë të transferojnë programet e studimeve.<br>Këshilli Studentor i FSHE-së dhe Këshilli Studentor Institucional i USH-së krijojnë mundësinë që studentët të paraqesin në organet drejtuese të USH-së mendimet dhe opinionet e tyre në lidhje me gjithë veprimtarinë akademike dhe shkencore në USH. |
| **MBËSHTETJA E TYRE** | USH-ja ka pjesë të politikave të saj mbështetjen shumëdimensionale të studentit. Edhe FSHE kontribuon në këtë drejtim përmes përfshirjes dhe mbështetjes së studentëve në organizimin e aktiviteteve/projekteve kombëtare me karakter social, kulturor dhe sportiv.<br>USH mbështet kategori sociale të veçanta, pjesë e të cilave janë edhe studentë nga FSHE, duke krijuar edhe kushte lehtësuese, dhe ambiente të përshtatshme për ta. Çdo vit akademik akordohen bursa studimi. Të gjitha informacionet si dhe mënyrat e aplikimit publikohen në faqen zyrtare të Universitetit.<br>Ndërtesa e FSHE-së është e pajisur me rampë, me qëllim sigurimin e aksesit në ambientet e fakultetit për studentë me probleme të lëvizshmërisë. Tashmë USH është pjesë e projektit IDEA, i cili synon përmirësimin e aksesibilitetit për studentët me AK dhe në këtë projekt marrin pjesë edhe pedagogë nga FSHE.<br>Secili pedagog ka të përcaktuar në syllabusin e lëndës literaturën bazë dhe ndihmëse dhe e evidenton në mbledhjen e departamentit ku miratohen syllabuset e lëndëve. Në përgjithësi, pedagogët vënë në dispozicion të studentëve tekste të autorëve të njohur në fushat përkatëse, leksione të shtypura, materiale ndihmëse të printuara, tekste të botuara nga pedagogët e tij dhe nga pedagogë të universiteteve të tjera, tekste të përkthyera etj. (Evidencë 8.1).<br>Edhe Biblioteka e USH-së ofron literaturë të pasur në shkencat psiko-sociale. Tashmë Biblioteka është pasuruar më tej me libra të fushës psiko-sociale në kuadrin e projektit T@ask. Burim mjaft i rëndësishëm për shfrytëzimin e literaturës së huaj është edhe biblioteka digjitale, U-library.<br>Revista "Buletini Shkencor", seria e Shkencave didaktike shërben edhe si burim literature ndihmëse për studentët.<br>Secili departament në FSHE aplikon shërbimin e tutoriatit për studentët. (Evidencë 5.2.1). Me studentët e viteve të para organizohen orë të hapura, (Evidencë 5.2.2), ku studentët njihen me programin e studimit, me Rregulloren, Kodin e Etikës, etj. Çdo shqetësim i studentëve përcillet nga pedagogu në departament, ku, zakonisht, gjen zgjidhje përmes bashkëpunimit me strukturat e tjera.<br>Në përbërjen e strukturës së Njësisë për Vlerësimin e Brendshëm të FSHE-së merr pjesë edhe një student. Gjithashtu, studentët kanë përfaqësues të tyre edhe në grupet e vlerësimit të brendshëm për programet e studimeve.<br>Fakulteti Ekonomik përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës shtron disa baza të punësimit pas diplomimit, përmes lidhjeve me punëdhënës të ndryshëm, privat dhe publik (DAR, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Shkodrës), bizneseve dhe faktorëve të tjerë, praktikave, workshop-eve, panaireve etj. |

| Standardi V.<br>STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE<br>FE | |
|---|---|
| Studentët | FE përmes njësive bazë dhe njësive kryesore, gjithashtu në bashkëpunim me Zyrën e Këshillimit për Karrierën, bazuar në Statutin dhe rregulloret, krijon një klimë të përshtatshme për kalim të lehtë të studentëve nga mjedisi i sistemit arsimor të mesëm në mjedisin e sistemit arsimor të lartë. Ai ofron informacion për studentët e ardhshëm si për politikat e pranimit ashtu edhe për organizimin e programeve të studimit.<br>Nën konceptin e "Ditëve të Hapura" realizohet informimi i të rinjve për mundësitë e ndryshme që ofrohen nga programet e universitetit duke shtruar dhe propozuar çdo alternativë studimi, duke dhënë përgjigje për çdo pyetje dhe paqartësi dhe duke sugjeruar mundësitë e punësimit në varësi të programit të studimit.<br>FE realizon informimin e studentëve përmes faqes zyrtare si dhe rrjeteve sociale nëpërmjet të cilave informacioni shpërndahet më shpejt tek të rinjtë. Fakultetet mbështesin studentët përkatësisht për çdo program studimi, me orientime dhe aktivitete të veçanta. Që nga vitit 2013 Universiteti i Shkodrës ka adoptuar programin e menaxhimit të studentëve "ESSE3", që realizon mbështetjen e tyre në mësimdhënien me sistemin elektronik dhe në të shkruar, të zëvendësuar tashmë me sistemin Pitagora.<br>Universiteti i Shkodrës respekton të drejtat e studentëve që u përkasin kategorive të veçanta dhe i mbështet ato gjatë procesit mësimor duke i lehtësuar aksesin në mësimdhënie dhe duke krijuar ambiente të përshtatshme që janë gjithnjë në përmirësim.<br>FE ofron dhe siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë plotësuese në gjuhë shqipe dhe gjuhë të huaj. Institucioni ka ngritur struktura ndihmëse që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në përputhje me standardet bashkëkohore.<br>Biblioteka e Universitetit të Shkodrës ka literaturë të pasur me tekste të autorëve të njohur në fushat ekonomike nga universitete të njohura në botë, por që duhet të pasurohet vazhdimisht duke pasur parasysh që fusha e kërkimit Shkencave është dinamike dhe në ndryshim të vazhdueshëm. Biblioteka e Universitetit ofron kushte optimale për të studiuar apo punuar.<br>Studentët përfaqësohen në Senatin Akademik (dy studentë) dhe Bordin e Administrimit, (Statuti i Universitetit, Neni 47,2/b). Ata janë të organizuar në Këshillin Studentor me përfaqësues nga secili fakultet, rezultat i një procesi të rregullt dhe gjithë përfshirës zgjedhor. Këshilli merr pjesë aktive në çështje që lidhen me të drejtat e studentëve.<br>FE ka në politikën e tij përfshirjen dhe mbështetjen e studentëve në organizimin kombëtar dhe ndërkombëtar të aktiviteteve/projekteve me karakter shoqëror, kulturor dhe sportiv. Përmes tyre sigurohet një klimë miqësore për shoqërizimin e studentëve edhe jashtë auditorëve të universitetit.<br>Link https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/07/22/80<br>https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2020-2021/senati/2486_senati.pdf,<br>https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2020-2021/senati/vendimi_nr_98.pdf,<br>Evidencë 5.1 Miratimi i kuotave |

| | |
|---|---|
| | Evidencë 5.2 3.2 Relacion ditët<br>e hapura 12 qershor 2019.PDF<br>Evidencë 5.3 Rregullore e sekretarive mësimore,<br>Evidencë 5.4 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së informacionit. |
| Mbështetja | FE ofron disa baza të punësimit pas diplomimit, përmes lidhjeve me punëdhënës të ndryshëm, privat dhe publik, bizneseve dhe faktorëve të tjerë, praktikave, workshopeve, panaireve etj. Ne mendojmë se përkushtimi i FE është në nivelin e duhur për të përmbushur nevojat e studentëve në çdo dimension, si informacioni për zhvillimin profesional, ashtu edhe mbështetja për punësim. Universiteti i Shkodrës ka krijuar një formë regjistrimi, ku studentët e diplomuar, në mënyrë vullnetare, mund të regjistrojnë të dhënat e tyre në databaset e USH-së. Kjo formë ka si qëllim mbledhjen e të dhënave dhe më pas analizimin e tyre në funksion të afrimit të diplomës së përvetësuar dhe kërkesave të tregut të punës. Zyra e Këshillimit dhe e Karrierës organizon aktivitete të vazhdueshme me ALUMNI për monitorimin dhe kontaktet me ish- studentë të FE –së.<br>Evidencë 5.5 Tutoriati<br>Evidencë 5.6 Orë e hapur me studentët e vitit të parë<br>Evidencë 1.5 Rregullore e studimeve ne USH;<br>Evidencë 5.8 Faqe e zyrtare e USH;<br>Evidencë 5.9 Faqe zyrtare e aktiviteteve;<br>Evidencë 5.10. Shkresë për ndryshim date provimi<br>Evidenvë 5.11. Formular regjistrimi<br>Evidencë 5.12 Kalendari i takimeve pedagog- student;<br>Evidencë 5.13 Orare të pritjes;<br>Evidencë 5.14 Kalendari i konsultimeve. |

| **Standardi V.**<br>**STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE**<br>**FD** | |
|---|---|
| **STUDENTËT** | FD Procedura e pranimit të studentëve realizohet në përputhje të plotë më parimet e Ligjit Nr.80/2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" (Evidencë 1.1) dhe me aktet normative të dala në zbatim të tij. Universiteti i Shkodrës ka miratuar Statutin dhe Rregulloren e Studimeve (Evidencë 1.2, 1.3 dhe 1,4). Këto akte rregullojnë juridikisht të gjithë karrierën e ndjekjes së studimeve nga momenti i pranimit në universitet e deri në fazën e diplomimit.<br>Politikat dhe procedurat e pranimit të studentëve në Fakultetin e Drejtësisë, mbështeten gjithmonë në parimet bazë që garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për studentët. |

| | |
|---|---|
| | Në faqen web të Universitetit janë lehtësisht të aksesueshme aktet normative nëpërmjet të cilave studentët mund të njihen me procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studentëve, kuotat përkatëse, transferimit dhe njohjen e studimeve të mëparshme (Evidencë 6). USH respekton të drejtat e studentëve që u përkasin kategorive të veçanta dhe i mbështet ato gjatë procesit mësimor duke iu lehtësuar aksesin në mësimdhënie dhe duke krijuar ambiente të përshtatshme që janë gjithmonë në përmirësim, edhe pse në këtë drejtim nevojitet të bëhet më shumë për sigurimin e kushteve të përshtatshme sipas nevojave specifike të studentëve.<br>USH realizon informimin e studentëve nëpërmjet faqes zyrtare dhe rrjeteve sociale nëpërmjet të cilave informacioni shpërndahet më shpejt tek të rinjtë. Në faqen web të Universitetit janë të publikuara të gjitha informacionet e që iu nevojiten studenteve në lidhje me Rregulloren e Universitetit, Kodin e Etikes të USH si dhe të gjitha informacionet dhe udhëzimet që lidhen me programet e studimit (Evidencë 6). Në faqen web https://unishk.edu.al studentët mund të gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me fakultetet e ndryshme dhe programet e studimit të ofruara nga secili fakultet, në lidhje me procesin mësimor, orarin e mësimeve dhe provimeve, riprovimet, tarifat e shkollimit, njoftime të llojeve të ndryshme që i përkasin procesit mësimor, aktiviteteve ekstrakurrikulare apo mobiliteteve dhe bursave të ofruara nga Universitetet e huaja. Në faqen përkatëse të Fakultetit të Drejtësisë https://unishk.edu.al/universiteti-luigj-gurakuqi/fakultetet/fakulteti-i-drejtesise gjendet informacioni i nevojshëm për studentët.<br>Studentët janë aktorë dhe partnerë të rëndësishëm për të siguruar cilësinë e programeve të studimit. Ligji nr. 80/2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë" ka parashikuar në nenin 99, Këshillat e Studentëve (Evidencë 1.1). Fakulteti ka marrë masa për të organizuar Këshillin Studentor, si organizime të pavarura studentore që koordinojnë përfaqësimin e studentëve në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, kryesisht në Senatin dhe Bordin e Administrimit të Universitetit të Shkodrës. |
| **MBËSHTETJA E TYRE** | Universiteti i ofron mbështetje studentëve nëpërmjet shërbimeve universitare për të lehtësuar ecurinë e tyre. Në këtë drejtim pranë Universitetit të Shkodrës janë ngritur Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni të cilat janë zyra kryesore për orientimin dhe këshillimin e studentëve dhe ndjekjen e studenteve gjatë studimeve të tyre në USH apo edhe pas tyre. Zyra e Këshillimit të Karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.<br>Nevojat e studentëve për literaturë ndihmëse mund të përmbushen edhe nga Biblioteka e Universitetit të Shkodrës që ndodhet fare afër, si dhe Bibliotekat brenda departamenteve të pajisura me literaturë bashkëkohore në shqip dhe gjuhë të huaj. Aksesi në Bibliotekën e Universitetit të Shkodrës është plotësisht i mundur. Për të konsultuar literaturën bashkëkohore në disiplina të ndryshme shkencore vjen në ndihme biblioteka dixhitale e krijuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe rinisë. Në bashkëpunim me RASH, Drejtoria e IT e USH-së ka siguruar mundësinë e përdorimit të këtij shërbimi për të gjithë pedagogët dhe studentët e universitetit në funksion të mësimdhënies, mësim nxënies dhe kërkimit shkencor.<br>Në kuadër të favorizimit të punësimit të studentëve, programet e ofruara nga Fakulteti i Drejtësisë janë të hartuara duke pasë si synim kryesor përshtatjen me tregun e punës (**Evidencë 3.1**). Për këtë është bërë kujdes që kurrikulat të formojnë studentët lidhur më aspekte të cilat shfaqin interes dhe kanë treg pune. Në këtë këndvështrim stafe të |

| | |
|---|---|
| | kualifikuara informojnë studentët me mundësitë që paraqet tregu i punës si dhe krijojnë kontakte të përhershme me institucione të cilat presin studentët në periudhën e praktikave mësimore dhe OJF-të ku studentët aktivizohen përtej procesit mësimor. |

| Standardi V.<br>STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE<br>FGJH | |
|---|---|
| **STUDENTËT** | FGJH Pranimi në FGJH bëhet në bazë të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", "Statutin e USH" dhe rregulloret e studimeve për secilin cikël studimi.<br>Në programet e studimit të FGJH pranohen shtetasit shqiptarë dhe të huaj që plotësojnë kushtet e përcaktuara nga MAS. FGJH ndjek politika për të mirëpritur studentë të huaj. Studentët e huaj janë kryesisht nga rajoni i Ballkanit. Pranimi i studentëve të huaj bazohet në kuadrin ligjor në fuqi.<br>FGHJ bën afishimin e çdo njoftimi tek tabela e njoftimeve, jo vetëm pranë ambienteve të godinës së FGHJ, por gjithashtu përmes njoftimeve të rregullta në faqen e internetit të USH-së, ku postohen të gjitha informacionet dhe njoftimet. |
| **MBËSHTETJA E TYRE** | FGJH kujdeset që studentët të jenë mirë informuar, nga stafi akademik dhe jo-akademik Informacionet dhe aktivitetet e ndryshme, të zhvilluara nga FGJH publikohen edhe në në faqen zyrtare të internetit të USH. Stafi i FGJH dhe departamentet përkatëse udhëzojnë dhe këshillojnë studentët për ciklin e parë dhe të dytë studimit, sikurse Universiteti ka ngritur një Zyrë të Këshillimit të Karrierës për udhëzimin dhe këshillimin e studentëve.<br>FGJH i kushton vëmendje të veçantë studentëve me nevoja të veçanta, si dhe studentëve romë dhe egjiptianë, duke i mbështetur ata në përputhje me kornizën ligjore kombëtare.<br>Udhëheqje e studentëve në përgatitjen e temave të diplomës dhe organizimi i gjithë procesit me përgjegjshmëri dhe në zbatim të Rregullores së USH-së.<br>Institucioni garanton dhe krijon kushtet e përshtatshme dhe të sigurta, si dhe merr përsipër përfshirjen e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik.<br>Qendra e Karrierës dhe Alumni ndjekin ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij, duke ofruar konsulentë për çështje akademike dhe studentore. |

| Standardi V.<br>STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE<br>FSHSH |
|---|

| | |
|---|---|
| **STUDENTËT** | FSHSH harton dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.<br>Burimet për informimin e studentëve janë të shumëllojshme. Në faqen e USH-së publikohen të gjitha vendimet, urdhrat, njoftimet etj. Në këtë faqe publikohen edhe njoftimet dhe lajmet për aktivitete të ndryshme. Platformat e ndryshme digjitale përdoren me qëllim të komunikimit sa më të mirë me studentët dhe lehtësimit të procesit të mësimdhënies. Studentët, personeli akademik dhe ai administrativ janë të pajisur me një adresë e-maili personale që e lehtëson dhe përshpejton komunikimin. Një pjesë e departamenteve kanë hapur llogari në rrjetet e ndryshme shoqërore. Krahas kësaj, në shërbim të studentëve janë sekretaritë mësimore, që ofrojnë shërbime të ndryshme për studentët.<br>Struktura kryesore për këshillimin dhe orientimin e studentëve në nivel të institucionit është Zyra për Këshillimin e Studentëve.<br>Po ashtu pjesë e grupit të punës për sigurimin e brendshëm të cilësisë së njësisë kryesore janë edhe studentët. Studentët kanë përfaqësues të tyre edhe në grupin e vlerësimit të brendshëm për programet e studimeve që ofrojnë njësitë bazë të FSHSH-së. |
| **MBËSHTETJA E TYRE** | Institucioni ka njësi të posaçme në shërbim të orientimit dhe këshillimit të studentëve. Struktura kryesore për orientimin dhe këshillimin e studentëve është Zyra e Këshillimit të Karrierës, si njësi e ngritur në rang universiteti, e cila ofron në mënyrë të vazhduar informacion dhe orientim të posaçëm në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Kjo zyrë mirëpret studentët dhe organizon takime të përbashkëta në formën e sesioneve informuese, sidomos në lidhje me tematika të mundësive për bursa, mundësi për karrierë apo punësim. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta, pjesë e të cilëve janë edhe studentët e FSHSH-së. Çdo vit ndahen bursa studimi për studentë me aftësi të kufizuara, përjashtohen nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit apo ajo reduktohet në masën 50 për qind. Studentët dhe pedagogët e FSHSH-së janë pjesë e projektit IDEA, në kuadër të të cilit zhvillohen tryezat e rrumbullakëta me qëllim të gjithpërfshirjes së të rinjve me aftësi të kufizuara në arsimin e lartë.<br>Institucioni vë në dispozicion të studentëve Bibliotekën Universitare, e cila ofron qasje të barabartë e pa pagesë për studentët edhe në bibliotekat online. Po ashtu në shërbim të studentëve është edhe shërbimi elektronik U-library. |

**Përfundime mbi standardin**

- Për pranimin e studentëve të rinj, USH ndjek një politikë të caktuar. Fillimisht kriteret e pranimit dhe numri i studentëve propozohet nga departamentet, miratohet në dekanat dhe pastaj kalon për miratim në Senatin Akademik. Faqja zyrtare e institucionit siguron informacion mbi kuotat dhe kriteret e pranimit, duke përfshirë studentët nga Shqipëria

dhe vende të tjera. Po kështu, në faqen zyrtare publikohen listat e fituesve për secilin program studimi.

- Ka një larmi burimesh informimi për studentët, krahas faqes zyrtare, si p.sh., guidë përkatëse, broshurë informuese e USH-së. Po kështu, Dekanati, sekretaria mësimore dhe sekretaria e Dekanatit, si dhe njësitë bazë të fakultetit kanë orarin e pritjes së studentëve, me qëllim ofrimin e informacionit dhe sigurimin e mbështetjes së tyre për procesin mësimor apo problematika të tjera të lidhura me të. Secili departament në fakultete përcakton pedagogët tutorë për secilin program studimi që mbulon.
- Çdo fillim viti akademik organizohen takime me studentët e viteve të para ku ofrohet informacion për organizimin e programeve të studimit, duke specifikuar objektivat dhe strukturën e moduleve, sistemin e vlerësimit në lidhje me kontrollin e dijeve përmes komponentëve të vlerësimit, kërkesat lidhur me literaturën, frekuentimin, detyrimet dhe metodologjinë e mësimdhënies si dhe me çështje etike të lidhura me aspekte studentore.
- Një rol të konsiderueshëm luan edhe sistemi i menaxhimit të studentëve "PITAGORA", i adoptuar nga USH në vitin akademik 2021. Pedagogët, stafi administrativ dhe studentët janë të pajisur me një adresë elektronike të brendshme të personalizuar, gjë që lehtëson komunikimin pedagog-student-staf administrativ.
- Në institucionin tonë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies vijnë në ndihmë edhe platformat LMS, Moodle dhe Teams. Në secilin fakultet sekretaria mësimore orienton studentët që dëshirojnë të transferojnë programet e studimeve. Procesi është i dokumentuar dhe arkivuar edhe për të gjitha prurjet e studentëve nga IAL-të të tjera apo anasjelltas.
- USH mbështet kategori sociale të veçanta, duke krijuar kushte lehtësuese, dhe ambiente të përshtatshme për ta. Çdo vit akademik akordohen bursa studimi. Të gjitha informacionet si dhe mënyrat e aplikimit publikohen në faqen zyrtare të Universitetit.
- Secili pedagog ka të përcaktuar në syllabusin e lëndës literaturën bazë dhe ndihmëse dhe e evidenton në mbledhjen e departamentit ku miratohen syllabuset e lëndëve. Në përgjithësi, pedagogët vënë në dispozicion të studentëve tekste të autorëve të njohur në fushat përkatëse, leksione të shtypura, materiale ndihmëse të printuara, tekste të botuara nga pedagogët e tij dhe nga pedagogë të universiteteve të tjera, tekste të përkthyera etj.

SHKODËR

- Edhe Biblioteka e USH-së ofron literaturë të pasur në shkencat psiko-sociale. Tashmë Biblioteka është pasuruar më tej me libra të fushës psiko-sociale në kuadrin e projektit T@ask. Burim mjaft i rëndësishëm për shfrytëzimin e literaturës së huaj është edhe biblioteka digjitale, Ulibary. Revista "Buletini Shkencor", seria e Shkencave shërben edhe si burim literature ndihmëse për studentët.
- Me studentët e viteve të para organizohen orë të hapura, ku studentët njihen me programin e studimit, me Rregulloren, Kodin e Etikës, etj. Çdo shqetësim i studentëve përcillet nga pedagogu në departament, për zgjidhje përmes bashkëpunimit me strukturat e tjera. Në përbërjen e strukturës së Njësisë për Vlerësimin e Brendshëm të fakulteteve merr pjesë edhe një student. Gjithashtu, studentët kanë përfaqësues të tyre edhe në grupet e vlerësimit të brendshëm për programet e studimeve.
- USH-ja ka pjesë të politikave të saj mbështetjen shumëdimensionale të studentit. Secili Fakultet kontribuon në këtë drejtim përmes përfshirjes dhe mbështetjes së studentëve në organizimin e aktiviteteve/projekteve kombëtare me karakter social, kulturor dhe sportiv. Në këtë mënyrë, Fakulteti përmes këtyre aktiviteteve kontribuon në përmirësimin e jetës studentore dhe plotësimin e saj me aktivitete ekstrakurrikulare.
- Ka përpjekje nga departamentet për të realizuar një studim të tregut të punës, por, duhet theksuar se stafi ka nevojë për asistencë për realizimin e një studimi të tillë.
- Secili Fakultet hedh, gjithashtu, bazat e punësimit të studentëve pas diplomimit përmes bashkëpunimit me institucione të ndryshme të rajonit sikurse lidhjeve me DAR-in, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Shkodrës dhe të tjerë aktorë, zhvillimit të praktikave, panairit të punës, etj.

**Vlerësimi i fushës: Standardet përmbushen kryesisht.**

## 8. PËRFUNDIME DHE VLERËSIM I PËRGJITHSHËM

**Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"**

- USH funksionon në përputhje me Ligjin "Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin shkencor", Statutin e Universitetit dhe aktet e tjera rregulluese;
- USH siguron eficencë në menaxhim dhe harton një strategji zhvillimi të vetën dhe të njësive të tij përbërëse, njeh dhe respekton autonominë institucionale, organizative, akademike dhe administrative;
- USH ka në përparësi ndërkombëtarizimin. Gjatë kësaj periudhë është punuar në aspektin e nënshkrimit të marrëveshjeve të ndryshme mes Universitetit të Shkodrës dhe universiteteve të tjera në Rajon dhe më gjerë si në zbatimin e projekteve të përbashkëta me karakter akademik;
- USH favorizon debatin konstruktiv, publikon veprimtaritë kryesore të organeve kolegjiale si në rang universiteti ashtu edhe në rang njësie kryesore e njësie bazë që lidhen me transparencën;
- USH harton dhe zbaton politika e procedura për sigurimin e cilësisë në programet e studimit që ofron, monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme, përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës;
- USH ndjek një politikë transparente dhe rigoroze të punësimit dhe një politikë integruese të personelit;
- USH synon të përmirësojë infrastrukturën logjistike dhe administrative të përshtatshme duke rekrutuar personel akademik të kualifikuar që i përgjigjet metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;
- USH ndjek një strategji të hapur bashkëpunimi dhe partneriteti në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- USH ofron programe në përputhje me misionin, strategjinë e tij të zhvillimit, kërkesat e tregut, objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë në të tre ciklet e studimeve universitare; Bachelor, Master Shkencor dhe Profesional, Doktoraturë;
- USH përcakton qartë dhe ndjek procedurat për miratimin e programeve të reja, të cilat ofrohen në përputhje të plotë me kapacitetet e institucionit dhe mbështeten në profilin kërkimor dhe profesional të njësive kryesore dhe njësive bazë të tij;

SHKODËR

- USH ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, siguron pajisje laboratorike, infrastrukturë dhe shërbime në mbështetje të programeve të studimit;
- Strukturat drejtuese të USH-së dhe njësive të tij përbërëse angazhohen në marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendore publike e private. Nga këto marrëveshje sigurohen realizimet e praktikave profesionale të studentëve në vitin e fundit të studimeve.
- USH zhvillon një aktivitet të gjerë shkencor, duke iu përmbajtur fushave parësore shkencore të përcaktuara nga Senati i Universitetit. Në mënyrë periodike organizohen konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare. Boton çdo vit "Buletinin shkencor". Njësitë kryesore dhe njësitë bazë garantojnë performancën dhe cilësinë e punimeve shkencore;
- USH harton dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.
- USH ndjek një politikë të informimit të studentëve me burime informimi të shumëllojshme. dhe veçanërisht nëpërmjet Zyrës për Këshillimin e Studentëve;
- Studentët përfaqësohen në Senatin Akademik (dy studentë) dhe Bordin e Administrimit, (Statuti i Universitetit, Neni 47,2/b). Ata janë të organizuar në Këshillat studentorë pranë çdo njësie kryesore dhe Këshillin institucional të Universitetit;
- USH ka në politikën e tij përfshirjen dhe mbështetjen e studentëve në organizimin kombëtar dhe ndërkombëtar të aktiviteteve/projekteve me karakter shoqëror, kulturor dhe sportiv;
- USH ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta. Çdo vit ndahen bursa studimi për studentë me aftësi të kufizuara, përjashtohen nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit apo ajo reduktohet në masën 50 për qind;
- USH ofron disa baza të punësimit pas diplomimit, përmes lidhjeve me punëdhënës të ndryshëm, privat dhe publik, bizneseve dhe faktorëve të tjerë, praktikave, workshopeve, panaireve etj.;
- USH ka krijuar një formë regjistrimi, ku studentët e diplomuar, në mënyrë vullnetare, mund të regjistrojnë të dhënat e tyre në databazë e USH-së. Kjo formë ka si qëllim

mbledhjen e të dhënave dhe më pas analizimin e tyre në funksion të afrimit të diplomës së përvetësuar dhe kërkesave të tregut të punës;

- Biblioteka, infrastruktura dhe shërbimet e saj sigurojnë akses në literaturë bashkëkohore të lidhur me fushat e studimit dhe kërkimit në programe. FSHSH ofron programe të të nxënit gjatë gjithë jetës. Biblioteka Universitare ofron qasje të barabartë e pa pagesë për studentët edhe në bibliotekat online.

### 9. Analiza sasiore dhe narrative e pyetësorëve

Pyetësorë drejtuar studentëve, pedagogëve, stafit dhe palëve të tjera të interesuara. Fokus grupe, anketime, intervista.

**Formular vlerësimi nga personeli akademik**. (*Zhvillohet në fund të çdo viti akademik nga personeli akademik*).




**Tabelë 20: Përshkrimi i pyetësorit**

Prezantimi i të dhënave dhe gjetjeve kryesore të pyetësorit drejtuar studentëve mbi lëndën dhe pedagogun ka për qëllim të ndajë informacionin e mbledhur dhe gjetjet. Qëllimet dhe arsyet e prezantimit të të dhënave përfshijnë: komunikimin e rezultateve, Informimin dhe ndikim për t'u

përqendruar në detaje të rëndësishme, mundësi diskutimi, shkëmbimi idesh, rritja e besueshmërisë.

Raporti i hartuar bazohet në dokumentin "Strategjia e zhvillimit e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" 2022-2026, miratuar me Vendimin nr. 115 datë 31.05.2022 të Senatit Akademik.

Një ndër objektivat specifikë të Strategjisë është "rritja e cilësisë, sigurimi i të cilës organizohet nëpërmjet një sërë procesesh themelore që ndikojnë në realizimin e plotë të procesit akademik dhe në zhvillimin perspektiv të kurrikulave universitare e të proceseve themelore të vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit dhe akreditimit institucional. Sigurimi i cilësisë është detyrim ligjor i USH-së, i cili është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e cilësisë".

**Qëllimi i pyetësorit:** Pyetësori ka si qëllim të marrë mendimet dhe qëndrimet e pedagogëve në lidhje me çështje si: cilësia e mësimdhënies, cilësia e mjedisit akademik ku pedagogu ndërvepron, angazhimin e tij të vazhdueshëm në kërkimin shkencor, meritokracinë, komunikimin, bashkëpunimin, etikën profesionale dhe identifikimin e problematikave.

Pyetësori i hartuar nga Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë është ndërtuar me një pyetje të hapur dhe me shkallë vlerësimi: "Plotësisht dakord", "Pjesërisht dakord", "Nuk e di", Pjesërisht kundër" dhe "Plotësisht kundër".

Pyetësori u zhvillua me stafin akademik të të gjitha departamenteve. Universiteti "Luigj Gurakuqi" ka në përbërje të vet personel akademik me kohë të plotë prej 200 pedagogësh. ***Analiza*** e bërë u mbështet mbi të dhënat e mbledhura nga pyetësorët e plotësuar.

1. Pyetjes, sa pedagogu ndihet i kënaqur dhe i realizuar në punë, 87% e pedagogëve e pëlqejnë punën që bëjnë. Ky rezultat është optimist, pasi dëshmon se mjedisi akademik është pozitiv dhe kjo ndihmon në rritjen cilësore të performancës së pedagogëve.




**Figura 1. A jam i kënaqur me punën që bëj**

2. Pyetjes, sa pedagogu është i kënaqur me raportin midis mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe veprimtarive ekstrakurrikulare, 50% e pedagogëve shprehen se janë dakord, 37% se janë pjesërisht dakord, 10% shprehen kundër dhe 3% shprehen se nuk e dinë.




**Figura 2. Jam i kënaqur me raportin mësimdhënie-kërkim shkencor – veprimtari ekstrakurrikulare**

Rezultati mund të kërkojë përmirësimin në vijimësi të politikës së ndarjes të ngarkesave mes këtyre tre proceseve.

3. Pyetjes, sa pedagogu është i kënaqur me nxitjen intelektuale në punë, 50% shprehen se janë plotësisht dakord me nxitjen që stafi, departamenti apo dhe politika e universitetit u ofron, 33.3% shprehen pjesërisht dakord, 13% pjesërisht kundër dhe vetëm 3.3% nuk e dinë.

Rezultati mund të kërkojë nxitje e mbështetje për karrierën personale të pedagogëve si edhe për gjetjen e alternativave të reja për nxitjen intelektuale të tyre.




**Figura 3. Jam i kënaqur me nxitjen intelektuale në punë**

Bashkëpunimi me kolegët është treguesi i mbarëvajtjes së punës në grup, i shkëmbimit të ideve dhe i përvetësimit të njohurive të reja. Çdo pedagog e shikon si të domosdoshëm këtë bashkëpunim në punë, me qëllim kapërcimin e çdo pengesë që mund të ndeshet gjatë punës në përmbushjen e kërkesave të risive intelektuale dhe të realizimit të ideve.

4. Pyetjes, sa i kënaqur është pedagogu në bashkëpunimin me kolegun, 50% shprehen plotësisht të kënaqur, 40% pjesërisht të kënaqur, 3,3% pjesërisht kundër dhe 6,6% nuk e dinë. Rezultatet mund të kërkojnë përmirësimin e mjedisit akademik dhe rritjen e bashkëpunimit mes pedagogëve.




**Figura 4. Jam i kënaqur me bashkëpunimin me kolegët**

5. Pyetjes, sa pedagogu është i kënaqur me eprorin, 60% shprehen plotësisht dakord, 26.6% shprehen pjesërisht dakord dhe vetëm 3,3% nuk e dinë.

Ky rezultat tregon kulturë drejtimi e cila ndihmon në rritjen e imazhit të institucionit dhe të cilësisë së punës.




**Figura 5. Jam i kënaqur me eprorin tim**

6. Pyetjes, sa pedagogu është i kënaqur me mbështetjen që merr nga departamenti, 70% e pedagogëve shprehen plotësisht dakord, 16.6% pjesërisht dakord, ndërsa 6.6% shprehen se nuk e dinë.

Ky është një rezultat optimist, pasi departamenti krijon klimën e favorshme për zhvillimin akademik të stafit.




**Figura 6. Jam i kënaqur me mbështetjen që marr nga departamenti**

7. Pyetjes, sa pedagogu është i kënaqur me organizimin e procesit mësimor, 53.3% shprehen plotësisht dakord, 43.3% pjesërisht dakord dhe vetëm 3,3% pjesërisht kundër.

Përmirësimi i procesit mësimor është një hallkë themelore e mbarëvajtjes së institucionit dhe aktivitetit akademik të pedagogëve.




**Figura 7. Jam i kënaqur me organizimin e procesit mësimor**

8. Pyetjes, sa pedagogu është i kënaqur me ndërveprimin me studentët, 83.3% shprehen plotësisht dakord dhe pjesa tjetër pjesërisht dakord.

Ndërveprimi pozitiv i pedagogëve me studentët është tregues i një mjedisi bashkëpunues, i cili mundëson zhvillimin profesional të studentit, nxit debatin dhe mendimin krijues.




**Figura 8. Jam i kënaqur me ndërveprimin me studentët**

9. Pyetjes, sa pedagogu është i kënaqur me ecurinë në karrierë, 66.6% shprehen plotësisht dakord, 26.6% shprehen pjesërisht dakord dhe vetëm 3.3% pjesërisht kundër. Ky rezultat është optimist, pasi pedagogët vlerësojnë pozitivisht zhvillimin e karrierës së tyre akademike.




**Figura 9. A jam i kënaqur me ecurinë në karrierë?**

10. Pyetjes, sa pedagogu është i kënaqur me pagën, 16.6% shprehen plotësisht dakord, 56.6% shprehen pjesërisht dakord, 10% plotësisht kundër, 10% pjesërisht kundër dhe vetëm 3.3% nuk e dinë.




**Figura 10. Jam i kënaqur me pagën**

11. Pyetjes, sa pedagogu është i kënaqur me qëndrueshmërinë e vendit të punës, 50% shprehen plotësisht dakord, 36.6% shprehen pjesërisht dakord, 3,3% pjesërisht kundër, 10% pjesërisht kundër dhe vetëm 10% nuk e dinë.




**Figura 11. Jam i kënaqur me qëndrueshmërinë e vendit të punës**

12. Pyetjes, sa pedagogu është i kënaqur me atmosferën e përgjithshme në departament, 67% shprehen plotësisht dakord, 23% shprehen pjesërisht dakord, 7% pjesërisht kundër dhe vetëm 3% nuk e dinë.
Rezultati tregon se pedagogët zhvillojnë aktivitetin akademik në një mjedis dhe atmosferë miqësore dhe kjo ndikon pozitivisht në mbarëvajtjen e departamentit.

REPUBLIKA E SHQIPERISË UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI




**Figura 12. Jam i kënaqur me atmosferën e përgjithshme në departament**

13. Ecuria ndërvepruese në vendimmarrjen brenda një departamenti shfaqet si shprehje e një bashkëpunimi që rrit cilësinë e ndërveprimit mes kolegëve.
Pyetjes, sa pedagogu është i kënaqur me përfshirjen në vendimmarrjen e departamentit, 56.6% shprehen plotësisht dakord, 26.6% pjesërisht dakord, 10% nuk e dinë dhe 3.3% prej tyre janë pjesërisht kundër.




**Figura 13. Jam i kënaqur me përfshirjen time në vendimmarrjet e departamentit**

14. Pyetjes, sa pedagogu është i kënaqur me sasinë e kohës që kanë në dispozicion për t'ia kushtuar familjes dhe vetes, 56.6% shprehen plotësisht dakord, 30% pjesërisht dakord, 6.6% nuk e dinë dhe 6.6% prej tyre janë pjesërisht kundër.

Rezultati tregon se pedagogët janë të kënaqur me kohën që i kushtojnë vetes dhe familjeve të tyre.




**Figura 14. Jam i kënaqur me sasinë e kohës që kam në dispozicion për vete dhe familjen**

Nga rezultatet e pyetësorit të zhvilluar me personelin akademik, *Zyra e Sigurimit të Cilësisë*, **parashtron rekomandimet e mëposhtme**:

- ***Nevojë për përmirësim të raportit midis mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe veprimtarive ekstrakurrikulare***;
- ***Më shumë nxitje e mbështetje për karrierën personale të pedagogëve si edhe për gjetjen e alternativave të reja për nxitjen intelektuale të tyre***;
- ***Përmirësim të vazhdueshëm të mjedisit akademik dhe rritjes së bashkëpunimit mes pedagogëve***.

Në pyetjen e hapur "***Përmendni disa faktorë që mund të përmirësojnë motivimin tuaj në punë***", personeli akademik ka cituar disa **rekomandime si më poshtë**:

- Aktivitete me përfshirje më të madhe të kolegëve dhe vizita në terren për njohjen e territorit;
- Blerja e softeware-ve të nevojshëm me licencë;
- Mundësi për trajnime, financime për projekte individuale ose në grup. Stimulime për studentët;

- Futja në sistem elektronik e raportimeve drejt organeve eprore;
- Shkurtimi i sezonit të provimeve që jep mundësi për më shumë kohë në punë kërkimore si dhe studentëve për të punuar në sezonin e verës pranë bizneseve;
- Autonomia financiare në njësitë kryesore do të motivonte më shumë për projekte dhe për qëndrueshmëri marrëdhëniesh me universitet e huaja e vendase;
- Sigurimi nga USH i mundësisë për shfrytëzim të data basëve të INSTAT, WTO, WTTO, do të krijonte mundësi për punë kërkimore bazuar në të dhëna;
- Përmirësim i infrastrukturës mësimdhënëse e kërkimore shkencore, pajisja me laboratorë moderne për zhvillimin e aktivitetit kërkimor por edhe të praktikave për studentët;
- Exchange mësimdhënie me projekte të ndryshme, përfshirje më e gjerë në Projekte të universitetit;
- Ulja e ngarkesës në auditor, rregullim i raportit mësimdhënie - kërkim shkencor, rritje e fondeve për kërkimin shkencor;
- Më shumë vlerësim ndaj veprimtarisë krijuese dhe botuese, duke mbështetur financiarisht aktivitetin kërkimor të stafit akademik;
- Prezantime dhe trajnime nga profesorë të huaj;
- Ekspeditat në dispozicion të studentëve, motivojnë studentët dhe njëkohësisht kënaqësinë në auditor e cila është reciproke;
- Bashkëpunimet me departamentet e ngjashme si në nivel kombëtar ashtu dhe ndërkombëtar;
- Nevoja për më shumë transparencë lidhur me vendimmarrjet në struktura të ndryshme në universitet; më shumë hapësira për pjesëmarrje në projekte, për të gjithë stafin akademik në mënyrë të barabartë; krijimi i më shumë hapësirave për të marrë pjesë në vendimmarrje për të gjithë stafin akademik;
- Stimulimi i pedagogëve me rezultate më të mira në punën e tyre mësimore dhe shkencore; dhënie përparësi për kualifikim të stafit të ri në Universitetet Europiane.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI LUIGJ

Pyetësori i studentëve
(Mbi Programet e Studimit, Lëndën dhe Modulin)

Zyra e Sigurimit të Cilësisë në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" ka një rol të rëndësishëmnë mbikëqyrjen dhe sigurimin e të gjitha shërbimeve për arritjen e një standardi të lartë të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dheçdo veprimtarie tjetër akademike.
ZSC ndihmon në garantimin e programeve dhe kurrikulave të përditësuara, duke përmbushur njëherazi nevojat e studentëve dhe tregut të punës. Gjithashtu, monitoron dhe analizon pyetësorë të ndryshëm që kanë të bëjnë me performancën e stafit akademik dhe administrativ.
Referuar Vizionit dhe Misionit të ZSC, ajo bashkëpunon ngushtë me palët e interesit për sigurimin e një arsimimi cilësor, inkurajimin e përfshirjes së teknologjisë, përmirësimin e vazhdueshëm të aktivitetit të saj, ofrimin e udhëzimeve për standartet e cilësisë në IAL, trajnimin e stafit për zbatimin e këtyre standardeve dhe mbikëqyrjene proceseve të vlerësimit dhe akreditimit.
ZSC kontribuon për një mjedis akademik që nxit përgjegjësinë sociale, për zhvillimine qëndrueshëm dhe rritjen ereputacionit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Pyetësori është një mjet thelbësor për të vlerësuar dhe përmirësuar cilësinë e procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor. Disa pika të veçanta të rëndësisë së këtyre pyetësorëve:
***Feedback* i drejtpërdrejtë**: Pyetësorët ofrojnë një platformë që studentët të shprehin mendimet dhe përvojat e tyre në lidhje me kurrikulat, mësimdhënien, burimet dhe shërbimet mbështetëse. Kjo është thelbësore për të kuptuar performancën e universitetit nga studentët si dhe për të kuptuar perspektivën e tyre.
**Identifikimi i problemeve**: Përmes pyetësorëve, zyra mund të identifikojë sfidat dhe problemet që ndikojnë në përvojën e studentëve. Kjo mund

të përfshijë çështje si cilësia në mësimdhënie, hyrjen në burime, apo mbështetja për zhvillim profesional.
**Bazë për përmirësim**: Rezultatet e pyetësorëve mund të përdoren si bazë për të ndërmarrë veprime korrigjuese dhe përmirësuese. Zbatimi i ndryshimeve bazuar në këtë *feedback* mundëson reagimin e universitetit ndaj nevojave dhe shqetësimeve të studentëve.
**Angazhimi i studentëve**: Pyetësorët ndihmojnë në krijimin e një kulture angazhuese të studentëve në procesin e menaxhimit të cilësisë. Duke u dhënë studentëve një zë në këtë proces, ata ndihen më të përfshirë dhe të vlerësuar.
**Transparenca dhe llogaridhënia**: Publikimi dhe diskutimi i rezultateve të pyetësorëve promovon transparencën dhe llogaridhënien, duke dëshmuar përkushtimin e universitetit për të punuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm.
**Rritja e Standardeve**: ZSC analizon dhe përdor informacionin e mbledhur në ndihmë të rritjes së standardeve të arsimimit, duke siguruar që programet dhe shërbimet përmbushin ose tejkalojnë pritjet e akredituesve dhe palëve të tjera të interesit.
Së fundmi, pyetësorët janë një instrument shumë i rëndësishëm për të matur dhe ndikuar në cilësinë e edukimit që studentët marrin dhe për të ndihmuar në krijimin e një mjedisi akademik që mbështet zhvillimin e tyre intelektual, profesional dhe personal.
Realizimi i pyetësorëve me studentët e sapo diplomuar është një praktikë e rëndësishme për Zyrën e Sigurimit të Cilësisë në një IAL. Ky lloj vlerësimi ndihmon në të kuptuarit e efektivitetit të programeve të studimit dhe përgatitjen e studentëve për tregun e punës.
Me anë të këtyre pyetësorëve arrihet:
**Vlerësimi i rezultateve të të nxënit**: Studentët e sapo diplomuar mund të ofrojnë një pasqyrë të saktë të suksesit të programit në lidhje me pritshmëritë e tyre akademike dhe profesionale. Ata mund të reflektojnë në mënyrë kritike mbi cilësinë e mësimdhënies dhe programit të studimit.
**Lidhja me tregun e punës**: Të diplomuarit janë në gjendje të bëjnë vlerësimet e duhura në lidhje me shkallën e përputhmërisë të studimeve të kryera me tregun e punës. *Feedback-* u që merret mund të tregojë nëse ka hapësirë për përmirësim për të përgatitur më mirë studentët për sfidat e tregut të punës.
**Zbulimi i anëve të dobëta dhe të forta të programit**: Pyetësorët mund të zbulojnë edhe anë të forta e të dobëta të specifikave të programit të studimit që nuk janë të dukshme gjatë periudhës së studimeve. Për shembull, një i diplomuar mund të theksojë mungesën e aftësive praktike ose të njohurive specifike të cilat mund të ndikojnë në karrierën e tyre.
**Përmirësimi i kurrikulës**: Rezultatet e pyetësorëve mund të përdoren për të përmirësuar kurrikulën e programeve ekzistuese dhe për të zhvilluar programe të reja që i përgjigjen ndryshimeve në tregun e punës dhe në teknologji.
**Strategjia dhe planifikimi institucional**: Informacioni i mbledhur mund të përdoret për të ndihmuar në strategjinë e përgjithshme dhe planifikimin institucional, duke u dhënë autoriteteve drejtuese të universitetit të dhëna të bazuara në fakte, për të marrë vendime të informuara.
**Krahasim dhe konkurrencë**: Universitetet mund të përdorin gjithashtu *feedback*-un nga të diplomuarit për të krahasuar programet e tyre me ato të institucioneve të tjera dhe për të identifikuar fusha ku mund të konkurrojnë ose të bëjnë dallimin.
**Promovimi i përgjegjshmërisë dhe transparencës**: Duke kërkuar mendime nga diplomuarit, universiteti tregon përkushtim për transparencë dhe llogaridhënie.
Pyetësori përmban një sërë pohimesh ku studentët vlerësojnë aspekte të ndryshme të programit të tyre akademik, nga zhvillimi i njohurive dhe kompetencave të tyre, deri te cilësia e mësimdhënies dhe infrastruktura e institucionit. Studentëve u është kërkuar të japin përgjigjet e tyre në një shkallë që varion nga "Plotësisht dakord" deri te "Plotësisht kundër".
Përmbajtja e pyetësorit merr në konsideratë faktorë si: cilësinë e programit të studimit, metodat e mësimdhënies, mbështetjen e inovacionit dhe kërkimeve shkencore, kushtet fizike dhe mbështetjen teknologjike që ofron universiteti, si dhe shërbimet e mbështetjes për studentët, përfshirë këshillimin e karrierës dhe trajtimin e ankimimeve.
Pyetësori është i rëndësishëm për universitetin për të marrë *feedback* të detajuar nga studentët mbi efektivitetin dhe cilësinë e formimit universitar. Rezultatet mund të përdoren për të identifikuar pikat e forta dhe ato që kërkojnë përmirësim në programet e studimit, si dhe për të ndjekur performancën e universitetit në realizimin e objektivave të strategjisë institucionale.

PYETËSOR LIDHUR ME PROGRAMIN E STUDIMIT
Të nderuar studentë!
Ky pyetësor ka për qëllim të marrë opinionin tuaj lidhur me aspektet kryesore të punës për programin tuaj të studimit që sapo përfunduat. Pyetësori synon marrjen e informacionit për të gjithë programin e studimit në tërësi. Pyetësori është anonim dhe të dhënat do të merren në konsideratë për përmirësimin e mëtejshëm të punës. Ju faleminderit!
Programi i studimit___________

| | POHIMI | Plotësisht dakord | Dakord | Nuk e di | Kundër | Plotësisht kundër |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Programi i studimit më ka zhvilluar njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara të fushës. | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 2 | Përmbajtja e programit të studimit më ka garantuar përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave të duhura për tregun e punës. | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Struktura e programit, lëndët, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit. | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 4 | Veprimtaritë formuese kanë mundësuar arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet, vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe punësim në përfundim të studimeve. | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 5 | Pedagogët kanë pasur nivelin e duhur të kualifikimit akademik. | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 6 | Pedagogët kanë përdorur metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, kanë nxitur te studentët mendimin krijues, kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 7 | Pedagogët kanë krijuar klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore e shkencore dhe i kanë mbështetur ato. | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| | **POHIMI** | Plotësisht dakord | Dakord | Nuk e di | Kundër | Plotësisht kundër |
| 8 | Universiteti ka siguruar kushtet e nevojshme për zhvillimin dhe mbikqyrjen e praktikës profesionale. | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 9 | Universiteti ka siguruar kushtet e nevojshme për punimin e diplomës apo për orientimin për provimin e diplomës. | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 10 | Procesi mësimor e shkencor është realizuar në auditore të mjaftueshme dhe cilësore, të pastra dhe të mirëmbajtura rregullisht. | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 11 | Gjatë orëve mësimore janë shfrytëzuar sisteme të ndryshme informatike dhe infrastrukturë e konsoliduar teknologjike. | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 12 | Biblioteka e Universitetit ka garantuar numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit si dhe literaturë elektronike, e cila më ka garantuar marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme. | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 13 | Zyra e këshillimit të karrierës më ka asistuar për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 14 | Zyra e këshillimit të karrierës më ka asistuar për çështje që kanë të bëjnë me orientimin në tregun e punës. | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 15 | Institucioni ka garantuar mundësinë e trajtimit të ankimimeve të studentëve. | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |
| 16 | Sekretaria mësimore ka qenë përherë në dispozicion të studentëve. | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ | ☐ |

**Më poshtë analiza e pyetjeve të pyetësorit:**

**Fjalët kyçe për çdo pohim të cilat janë përdorur në grafikët e mëposhtëm**:
Zhvillim aftësish
Përftimi i dijeve dhe aftësive
Strukturë e programit
Veprimtari formuese
Kualifikim akademik
Metodat e mësimdhënies
Klima e mësimdhënie- mësimnxënies
Kushtet e zhvillimit të praktikës
Kushtet për provën finale
Infrastruktura për realizimin e procesit mësimor
Infrastruktura teknologjike
Literatura mbështetëse e BUSH
Këshillim për Studime nga ZKK
Orientim në punë nga ZKK
Trajtimi i ankimimeve
Disponibiliteti i sekretarisë

**Bachelor në "Drejtësi"**
Në vlerësimin e programit të studimit për Bachelor në "Drejtësi", 55 studentë të diplomuar,janë shprehur në mënyrë pozitive për shumicën e pikave të pyetësorit. Ja si paraqiten përqindjet e përgjigjeve për secilën pikë:




*Qartësisht, studentët kanë një vlerësim shumë pozitiv për programin e tyre të studimeve, me përqindje të larta të shkallës "plotësisht dakord" në shumicën e pikave. Sipas këndvështrimit të studentëve, është e qartë që këmi të bëjmë më një program brenda të gjitha standardeve të cilësisë.*

**Master i Shkencave në "E Drejta Kushtetuese dhe Administrative"**
Në vlerësimin e programit të studimit për Master në "E drejta kushtetuese dhe administrative", 31 studentë, përqindjet e përgjigjeve të studentëve për secilën pikë të pyetësorit janë si më poshtë:




*Rezultatet tregojnë një vlerësim të lartë nga ana e studentëve për shumë aspekte të programit të tyre, me përqindje shumë të larta të atyre që janë plotësisht dakord.*
*Këto të dhëna tregojnë një nivel të lartë të kënaqësisë në disa aspekte si: Kualifikim akademik, mësimdhenia interaktive, infrastruktura teknologjike, burimet bibliotekore, Këshillim për Studime nga ZKK, orientimi për punë, Disponibiliteti i sekretarisë, të dhëna të cilat flasin për një program studimi të kompletuar në të gjitha aspektet.*

**Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"**
Vlerësimi i programit të studimit për Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor", nga ana e studentëve, 18 të diplomuar, është si më poshtë:




*Përgjithësisht, ka një vlerësim të lartë për zhvillimin e avancuar, strukturën e përshtatshme dhe kualifikimin e pedagogëve, si dhe për mësimdhënien interaktive dhe klimën inovative. Ajo çfarë vërehet nga përgjigjet është që puna e stafit pedagogjik ka një reflektim shumë pozitiv te studentët.*

**Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"**
Vlerësimi i programit të studimit për Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" ku janë diplomuar 19 studentë, nga ana e tyre është si më poshtë:



*Ky vlerësim reflekton pranim të lartë në shumë aspekte të programit siç janë: zhvillimi i avancuar, mësimdhënia interaktive, kualifikimi i pedagogëve etj. Grafiku tregon sërish që Departamenti i Mësuesisë ka punuar me cilësi të lartë në të gjitha drejtimet që përbëjnë arsimimin e studentëve, parë nga këndvështrimi i të sapodiplomuarve.*

**Bachelor në "Edukim Fizik"**
Rezultatet e vlerësimit të programit të studimit për Bachelor në "Edukim Fizik" nga ana e studentëve, për 53 të diplomuar, janë si më poshtë:




*Në përgjithësi, vlerësimet janë pozitive: të zhvillimit të avancuar, kualifikimit të pedagogëve, dhe metodave interaktive të mësimdhënies, gjithashtu kategoritë e tjera kanë vlerësim të lartë me përqindje shumë të vogël mendimesh të përziera.*

**Bachelor në "Pedagogji Muzikore"**
Janë diplomuar gjithsej 9 studentë. Përgjigjet e studentëve për vlerësimin e programit të studimit për BA "Pedagogji Muzikore" janë si më poshtë:




*Ky vlerësim i detajuar tregon se studentët janë në përgjithësi mjaft të kënaqur me programin e studimit, veçanërisht në aspektet e zhvillimit të avancuar, kualifikimit të pedagogëve, orientimit për diplomë, këshillimit nga Zyra e Karrierës, trajtimit të ankimimeve, sekretarisë së përkushtuar.*

**Bachelor në "Pikturë Grafike"**
Janë diplomuar gjithsej 14 studentë. Analiza e rezultateve të pyetësorit për vlerësimin e programit nga ana e studentëve për BA në "Pikturë Grafike", si vijon:




*Nga këto të dhëna mund të themi se, përgjithësisht, studentët janë të kënaqur me programin e tyre të studimit, përveç ndonjë aspekti si praktikat profesionale që mendimet janë më të përziera.*

**Bachelor në "Psikologji"**
Rezultatet e vlerësimit të programit të studimit nga studentët, 22 studentë, për programin e BA në "Psikologji" janë si vijon:




*Këto të dhëna tregojnë një nivel të lartë të kënaqësisë në disa aspekte si: kualifikimi i pedagogëve, mësimdhenia interaktive, infrastruktura teknologjike, burimet bibliotekore, Këshillim për studime nga ZKK, orientimi për punë, Disponibiliteti i sekretarisë, të dhëna të cilat flasin për një program studimi të kompletuar kryesisht në të gjitha aspektet, por gjithashtu tregojnë edhe nevojën për përmirësim në struktukurën dhe në praktikën profesionale.*

**Bachelor në "Punë Sociale"**
Rezultatet e vlerësimit të programit të studimit nga studentët për programin BA në "Punë Sociale", 46 studentë të diplomuar, janë si vijon:




*Ky vlerësim reflekton përgjigjet e studentëve për çështje të ndryshme që lidhen me cilësinë e programit të studimit të tyre në fushën e "Punës Sociale". Ndonjë çështje si orientimi për punë, ka mendime më të përziera.*

**Master Profesional në "Shërbime Sociale"**

Për vlerësimin e programit të studimit Master Profesional në "Shërbime Sociale", studentët, 27 të diplomuar, kanë dhënë përgjigjet e mëposhtme:




*Ky vlerësim i detajuar tregon përgjithësi të kënaqshme të studentëve me programin e studimit për Master në "Punë Sociale", me një përqindje të lartë të dakordësisë plotësisht, gjë e cila tregon në përfundim se departamenti i Psikologjisë dhe Punës Sociale ka përmbushur me cilësi të lartë standardet e mësimdhëines dhe mësimnxënies.*

**Master Profesional në "Mësuesi në lëndët Edukim Fizik dhe Sporte"**
Analiza e rezultateve të pyetësorit për vlerësimin e programit të studimit nga ana e studentëve, 26 studentë të diplomuar, për MP në "Mwsuesi në lëndët Edukim fizik dhe sporte".




*Ky vlerësim i detajuar tregon një pranim të gjerë të programit dhe mënyrës si është trajtuar e përcjellë ai nga stafi akademik dhe ndihmës akademik te studentët e sapodiplomuar. Departamenti ka plotësuar kryesisht të gjitha standardet e cilësisë.*

**Master shkencor në "Psikologji Klinike"**
Nga të dhënat e pyetësorit për vlerësimin e programit të studimit nga ana e studentëve, 8 studentë të diplomuar për programin e Msc në "Psikologji Klinike", analiza tregon:




**Master Profesional në "Mësuesi për Arsimin Fillor"**
Bazuar në të dhënat e pyetësorit për vlerësimin e programit të studimit nga ana e studentëve, 30 studentë të diplomuar, në programin Master Profesional në "Mësuesi për Arsimin Fillor", këto janë përqindjet e përgjigjeve:




*Këto të dhëna tregojnë një vlerësim shumë pozitiv nga studentët për programin e tyre. Siç shihet trendi në të gjithë fakultetin, edhe në këtë program studimi, kryesojnë çështjet si zhvillimi i avancuar i programit, përmbajtja e plotë, struktura e përshtatshme, mësimdhënia interaktive.*

**Master i Shkencave në "Psikologji Organizative"**

Analiza e rezultateve të një pyetësori për vlerësimin e programit të studimit nga ana e studentëve për Msc në "Psikologji Organizative", ku janë diplomuar 10 studentë. Rezultatet janë si më poshtë:




*Nga rezultatet e mësipërme vihet re se studentët shprehen disi të ndarë në mendime sa i përket praktikave profesionale në këtë program studimi dhe mund të ketë vend për përmirësim. Sa i përket fushave të tjera, parë nga këndvështrimi i studentëve të sapodiplomuar, i plotësojnë me cilësi të lartë standardet e programit.*

**Bachelor në "Administrim- Biznes"**

Rezultatet e pyetësorit të vlerësimit të programit të studimit për Bachelor në "Administrim Biznes" ku u diplomuan 48 studentë.




*Në përgjithësi, studentët kanë vlerësim pozitiv për programin e studimit Administrim- Biznes, me një numër të lartë të studentëve që janë plotësisht të kënaqur në shumicën e kategorive, gjë e cila flet qartë për cilësinë e lartë të punës nga departamenti. Megjithatë, ka ndonjë hapësirë për përmirësim si trajtimi i ankimimeve.*

**Master i Shkencave në "Administrim- Biznes"**

Rezultatet e pyetësorit të vlerësimit të programit të studimit për Masterin e Shkencave në "Administrim Biznes". U diplomuan gjithsej 12 studentë.




*Rezultatet tregojnë përqindjen e përgjigjeve të studentëve në lidhje me aspektet e ndryshme të programit. Ja si interpretohen të dhënat: Në përgjithësi, përqindjet tregojnë kënaqësi nga studentët me programin e studimit, por ka disa anë mbështetëse si biblioteka, këshillimi i karrierës, trajtimi i ankimimeve që mund të përmirësohen akoma.*

**Bachelor në "Financë- Kontabilitet"**

Rezultatet nga pyetësori për programin Bachelor në "Financë- Kontabilitet" me 83 të diplomuar tregojnë një vlerësim të përgjithshëm nga studentët që kanë marrë pjesë në këtë anketim. Ja si qëndron analiza sipas përgjigjeve:




*Vlerësimet e studentëve tregojnë pranim mëse të kënaqshëm të programit të studimit në "Financë- Kontabilitet", me një përqindje të lartë të studentëve që janë plotësisht të kënaqur në shumicën e aspekteve të programit. Megjithatë, ka aspekte të caktuara, si biblioteka e USH- së, këshillimi i karrierës, trajtimi i ankimimeve dhe Disponibiliteti i sekretarisë që kanë vend për përmirësim.*

**Master i Shkencave në "Kontabilitet"**

Rezultatet e pyetësorit për programin e Masterit të Shkencave në "Kontabilitet" ku janë diplomuar 18 studentë, reflektojnë një vlerësim të detajuar nga ata. Ja si interpretohen të dhënat e mëposhtme.




